

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 shtator 2024 (e enjte), me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 korrik 2024.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – buxhetit për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024
4. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2023
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024
6. Shqyrtimi i nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomunal për bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës për rregullimin e memorialit të dëshmorit Xhevat Jusufi
7. Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrije – shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
11. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITËR

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi  Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 13.09.2024

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2024 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Propozim – buxhetit për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të vjen në një format tjetër dhe të dihet se cilat projekte janë realizuar , cilat janë inicuar dhe cilat nuk kanë filluar fare dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
3. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2023.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
5. Shqyrtimi i nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomunal për bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës për rregullimin e memorialit të dëshmorit Xhevat Jusufi.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
7. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje – shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E VII E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 25 KORRIK, 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:23**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Alban Bajrami, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Jeton Gjaka, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mek Selaci, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviç, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mungoi: Nurie Halili.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- në fillim të mbledhjes njoftoi kuvendin për materialet e pikave shtesë, që do të trajtohen për shqyrtim në rendin e ditës.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës, pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi se propozon që të tërhiqen nga rendi i ditës dy pika dhe atë pika 11 në renditje, Propozim-vendimi lidhur dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në fshatin Lumadh, si dhe pika tjetër propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Qyqavica. Arsyet për tërheqjen e këtyre pikave nga rendi i ditës është për fatin se me datën 22 korrik 2024 e kemi pranuar në adresën elektronike nga Prokuroria Speciale e Kosovës ku është kërkuar që përfaqësuesi i komunës të ballafaqohet me kontratën e nënshkruar për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në Parkun Industrial në Lumadh. Prandaj me qëllim që të spastrohet kjo çështje në tërësi, kërkoj që kjo pikë të largohet nga diskutimi dhe votimi në kuvend. Sa i përket “pikës” për Parkun Qyqavica, sot në ora 14:00 në cilësinë e anëtarit të komisionit ndërmintoror është i fuar në takim ku do të diskutohet çështja e

qirasë dhe ajo e përqindjes së përfitimit që komuna e Vushtrrisë kërkon dhe insiston ta ketë në këtë investim strategjik.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi: para më shumë se dy muajsh në këtë foltore e kemi ngritur si shqetësim draft-raportin e auditorit të jashtëm për Komunën e Vushtrrisë, por Kryetarin më shumë e shqetësonte se si ne opozita e kishim informatën mbi këtë raport se sa vet raporti. Sot, prap në këtë foltore, po vërtetohen ato që i kemi thënë në lidhje me raportin e Auditorit. Gjithsej 27-të të gjetura, ku prej tyre 18-të janë të gjetura të përsëritura dhe 9 të gjetura të reja, pra lëre që nuk janë përmirësuar të gjeturat që komuna ka pasur edhe në vitet e kaluar, por sot kemi edhe 9 të gjetura të reja. Të dashur qytetarë të Vushtrrisë, në 24 vitet e fundit, ky është raporti më i keq që ka marrë ndonjëherë komuna e Vushtrrisë, duke na dëshmuar që edhe kjo qeverisje është qeverisja më e dobët që kemi pasur ndonjëherë. Në një intervistë televizive Kryetar, duke e cilësuar veten si trajner keni deklaruar se trajneri i mirë i ndërron shpesh lojtarët, mirëpo trajneri i mirë tregon edhe rezultate, e në rastin e juaj rezultatet janë shumë të dobëta dhe kur rezultatet janë të dobëta duhet të ndërrohet edhe trajneri. Shkeljet në këtë raport kanë qenë aq serioze sa që nuk keni arritur ta largoni as edhe një të gjetur të vetme. Punëtorët të cilët kanë qenë në administratën komunale po transferohen në institucione tjera, ata që kanë mbetur i keni avancuar në pozita udhëheqëse si shefa të sektorëve të ndryshëm, ndërsa punësimet e reja i keni bërë në baza partiake dhe pa meritokraci, andaj po ju mungojnë rezultatet. E keni plotë gojën Diasporë dhe nuk keni bërë asgjë që diaspora t'i shijoi ato pak ditë në vendlindjen e tyre. Nëse kaloni në shesh e shihni se e keni gati të pamundur që edhe të ecni në të, e keni bllokuar sheshin kryetar, e kemi parasysh që në një pjesë të sheshit janë duke u kryer punime, por edhe atë pjesën e lirë që është dashtë ta shfrytëzojnë qytetarët e keni bllokuar. Për me shumë se një muaj, ka rrjedhje të ujit të pijshëm në shesh, në këtë vapë qytetarët kanë problem për ujë të pijshëm ndërsa uji i pijshëm rrjedh në shesh. I pastronit rrugët edhe atëherë kur kishte reshje shiu, ndërsa sot në këto ditë të nxehta vere rrugët nuk pastrohen. Rrugët i keni bërë projekte tri vjeçare, duke mos përfunduar asnjërën, e kuptojmë që këto rrugë keni dëshirë ti përuoni në vitin e ardhshëm, sepse është vit zgjedhor, por kjo gjendje është bërë e pa përballeshme për qytetarët. Në fund tha se, katandisja që e ka kapluar Qytetin e Vushtrrisë ka bërë që edhe në fshatrat më të afërta kolona shkakton vonesa deri në një orë, për shkak të demolimit të rrugëve.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi se foltorja e kuvendit është vendi më ideal që të shfrytëzohet nga ana e kryetarit të komunës për të iu kërkuar falje qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë për të gjitha këto përjetime të këqija që janë duke i përjetuar sidomos këtë periudhën e fundit. Kjo faktohet duke filluar nga sheshit i qytetit, ku kryetari e ka prezantuar si mega projekt, ndërsa duhet kërkuar falje qytetarëve për gjendjen kaotike që është krijuar në atë shesh. Një qeverisje që vjen pikërisht nga partia aktuale në pushtet, që para dhjetë viteve kishte investuar milion para në atë shesh, pas dhjetë viteve po e njëjta parti dhe qeverisje investon kaq shumë para për një shesh i cili është dashur të jetë i përfunduar, në ndërkohë që të gjitha ato biznese që shtrihen përgjatë këtij sheshi kanë humbej katstrofale biznese si rezultat i keq-qeverisjes aktuale komunale. Tutje shtoj se sheshet prej se ekzistojnë nga Greqia antike e deri me sot e kanë kuptimin, që të gjitha pjesët e qytetit e kanë një qasje bashkëdyzim dhe përbashkohen në një shesh. Qeverisja e kaluar e patë bërë sheshin me disa vazo të betonit që i ngjasonin varrezave të faraonëve, ndërsa tani sheshi është duke u bërë në stilin kinez në stilin e murit kinez, ku qyteti ndahet me mure të betonit. Çfarë kuptimi ka sheshi që e ndan qytetin me mure të larta të betonit kur ai është për qasje të lehtë për të gjithë qytetarët. A ndoshta mos është betoni që po paguhet më mirë për qeverinë apo cila është arsyeja?! – Gjithandëj qytetit kemi kaos infrastrukturor, sepse nuk ka rrugë që nuk është prerë asfalti dhe ato nuk kthehen në gjendje të

mëparëshme nga ana e operatorëve ekonomikë. Kemi dëmtim të kanalizimeve dhe përgjithësisht qytetit është shndërruar në një kaos urbanistik. Më pas ngriti shqetësimin se te shtëpia e tij kanalizimi është dal mbi sipërfaqe dhe aty gjendet shkolla dhe një lagje e tërë ku ka rrezik për shfaqej të ndonjë epidemie, por askush nuk merret me këtë çështje. Tregu i prodhueseve vendor është prezantuar nga qeverisja aktuale si mega-projekt si është situata sot kur do të përfundoi ai treg, sepse të njëjtit i është ndërruar lokacioni me dhjetëra herë dhe sot akoma prodhuesi i Vushtrrisë nuk ka zgjidhje se ku do ta shes produktin e tij. Është premtuar plan special për arsimin, cila është gjendja në arsim këtë më së miri na tregon gjendja nga raporti i auditorit me të cilin kryetari është pajtuar. Kemi një politizim të skajshëm të arsimit, keqpërdorim të procedurave të rekrutimit duke iu dhënë apriori përgjigjet kandidatëve të preferuar. Në konkurset ku kërkohen inxhinierë të tekstilit dhe pranohen dizajnerë të artit, në kundërshtim me normativën arsimore. Subvencionimi i OJQ-ve është bërë në kundërshtim me rregulloren e Ministrisë së Financave dhe atë komunale. Mashtrimi i punëtorëve të komunës për shujta, është i pa precedent, sepse kjo çështje nuk është zgjidhur dhe do të jetë vështirë e realizueshme, për shkak të problemeve juridike-mungesës së bazës ligjore. Mungesa e vullnetit për rritjen e subvencioneve për fëmijët e porsalindur, kjo për faktin se edhe komuna më të vogla dhe me buxhet shumë më të limituar janë duke i subvencionuar fëmijët e porsalindur, sepse Komunës dhe udhëheqjes komunale të Vushtrrisë po i mungon vullneti për të zbatuar edhe vendimin paraprak për subvencionim të këtyre fëmijëve me 120 €.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se në këtë seancë të kuvendit është duke munguar Drejtoresha e Drejtorisë së Diasporës, edhe pse këta të fundit i kemi shumë prezent këta muaj. Ajo çka është problematike është fakti se këtë vit nuk kemi vendim për shfrytëzimin e oborreve të shkollave si parkingje për mërgimtarët. Kërkoj që sa më parë të merret ky vendim për lejimin e shfrytëzimit të këtyre parkingjeve.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-ngriti shqetësimin e qytetarëve që po shkaktohet si rezultat i punimeve në rrugët nga hyrja në Vushtri në drejtim të fshatit Bukosh, dhe përsërit pyetjen e saj se kur pritet përfundimi i këtij projekti në këtë rrugë sepse e njëjta është duke iu bërë shumë dëme qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-në adresimin e tij para kuvendit paraqiti sqarime specifike në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit, ku theksoi se çështja e raportit të auditorit të përgjithshëm është pikë e rendit të ditës, i cili do të trajtohet gjerë e gjatë në këtë seancë plenare. Ai potencoi se pika qendrore në kualifikimin e raportit është pagesa e mjeteve për mësimdhënësit nga kategoria kapitale në kategorinë e pagave, pagesa të realizuara përmes vendimeve gjyqësore. Kjo ka ndodhur në zbatimin e kontratës kolektive të arsimit, e që mësimdhënësit kanë pasur të drejt në realizimin e të drejtave të tyre. Në këtë kontekst vlerësoi se janë bërë dy dëme kolosale, në njërin anë ministria e ka goditur financiarisht komunën, ndërsa në anë tjetër mësimdhënësit janë dëmtuar nga avokatë me 10% të fitimit. Lidhur me shfrytëzimin e oborreve të shollave për mërgimtarët tanë si parkingje, një vendim i tillë është marr dhe i njëjti është publik. Lidhur me projektin për ndërtimin e sheshit të qytetit, ri-potencoi se qëndron prapa asaj se është një projekt i madh dhe i njëjti është duke u zhvilluar sipas dinamikës. Sa i përket punësimeve sipas vijës politike dhe partiake, theksoj se të gjithë e dinë se nuk është ashtu si po pretendohet sepse një zyrtar që është punësuar në zyrën ligjore të komunës është mikeshë e ish kryetarit të Komunës së Vushtrrisë. Kontrata tre vjeçare për rr. "Drenica" që është një arterie e fuqishme që e zbrazë qytetin, ceku se, është sipas dinamikës dhe standardeve dhe mendon se nga fundi i korrikut do jepet shtresa e parë e asfaltit kësaj rruge. Pastaj shtoi se kjo rrugë bashkë me rrugën nga Pestova në Druar parqet një kompletim të mozaikut të infrastrukturës në shkarkimin e qytetit me rrugë alternative. Më tej,

përpos rrugëve kryesore si ajo për fshatin Begaj, mandej rruga Lumni Surdulli dhe Avni Saraçi, që janë arterie kryesore, është duke shkuar sipas dinamikës edhe projekti Tregu i Qytetit për prodhuesit vendor, ku pjesa më e ndjeshme ajo e parkingut nëntokësor është përfunduar. Te shujtat e punëtorëve të komunës, ka pasur vullnet të plotë që kjo të realizohet, por që një vendim për këtë çështje është kthyer mbrapsht nga ana e MAPL-së.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, kryetari i komunës shfaqti vetëm anën politike, por nuk u përgjigj në asnjërin nga temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit dhe shtoi se sikur përmbaruesi privat të mos i kishte marr mjetet nga komuna, Komuna dhe qeveria komunale nuk do të kishte se çfarë të prezantonte para qytetarëve sepse mjetet buxhetore të komunës do të shkonin në deficit, dhe në këtë formë po tentohet të mbulohen dështimet e qeverisë komunale që kanë ndodhur në çdo fushë. Pastaj vlerësoi se fakti se raporti i auditorit të përgjithshëm është dërguar bashkë me raportin për të hyrat dhe shpenzimet kjo tregon më së miri se gjërat dhe të gjeturat po tentohen të fshihen.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se përgjigjet e kryetarit janë sa për ta amortizuar situatën, por qytetarët e kanë të qartë, se kur bëhet fjalë për sheshin që po quhet mega-projekt, ai po bëhet pa u bërë pranimi teknik, kur ai është ndërtuar për herën e parë dhe duhet bërë të ditur publikisht se ai shesh është bërë keq dhe tani po shpresojmë se do të bëhet mirë edhe pse pak ka shpresë dhe dihet se janë investuar miliona euro të taksave të qytetarëve. Ai kërkoi nga kryetari i komunës një sqarim profesional e përmbajtësor lidhur me këtë çështje.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-paraqiti sqarime lidhur me çështjen e kanalizimit në fshatin Akrahticë, ku ceku se pasi është kontraktuar këto punë, do të kemi projekte të bëra për së mbari dhe ato do rezistojnë në kohë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me rendin e ditës sqaroi para kuvendit se ka përcjellë një email te kryesuesja dhe MAPL-ja, ku ka shprehur qëndrimin e tij mospajtues për shkak se rendi i ditës ka bartur element të paligjshëm që i ka bërë kryesuesja e kuvendit dhe për më tepër është bërë praktikë e minimizimit të rolit të Komitetit për Politikë dhe Financa, rol të cilin ia ka dhënë ligji, po ashtu po tentohet të devalvohet puna dhe roli i kuvendit të komunës. Koj dëshmohet më së miri se në komitet, shqyrtohen 5 apo 6 pika, ndërsa në të njëjtën ditë na vjen rendi i ditës për kuvend me 14 pika të rendit të ditës, andaj kjo është e papranueshme. Në këtë kontekst shtoi dhe deklaroi duke kërkuar mirëkuptimin e të gjithëve, që të ndërpritet kjo praktikë e paligjshme dhe të gjitha pikat që nuk kanë kaluar nëpër Komitetin për Politikë dhe Financa të hiqen nga rendi i ditës. Në fund tha se kjo praktikë po ekspozon kuvendin në situata që të merren vendime të kundërligjshme sidomos për ato çështje që lidhen me pronën komunale dhe kështu po tentohet të realizohen pazare të ndryshme mes partisë që është në pushtet dhe partive tjera që i për bashkojnë këto pazare.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-deklaroi se parafolësi i tij e ka plotësisht gabim kur deklaroi se në kuvend mund të shqyrtohen vetëm pikat të cilat kalojnë në Komitetin për Politikë dhe Financa, sepse ligji ia njeht secilit anëtarë të kuvendit që të bëj propozim për futje në rendin e ditës dhe aprovim. Për më tepër, neni 36 i rregullores së kuvendit është decidiv ku njihet e drejta e secilit anëtar të kuvendit që të propozoi pika shtesë dhe të bëj propozime tjera për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës. Ndërsa edhe për pikat tjera ligji i ka dhënë të drejtë kryetarit të komunës që të bëj propozime për pikat tjera që janë në interes të përgjithshëm.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-duke ju përgjigjur anëtarit të kuvendit Bekim Zabergja, ceku se ai duhet ta kuptoj dhe dalloj anëtarin e kuvendit nga ekzekutivi, sepse ligji ia ka njohur të drejtën anëtarit të kuvendit që të bëj pika shtesë, por jo ekzekutivit komunal dhe këtu ka një dallim substancial.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-deklaroi se disa nga pikat e rendit të ditës i kërkojnë 2/3 e votave të kuvendit dhe për këto pika shprehu vullnetin e tij që të ketë një konsensus, sepse është interes publik i këtyre kërkesave dhe shtoi se asgjë nuk prishë punë që pikat 4 dhe 5 të kthehen për shqyrtim në Komitetin për Politikë dhe Financa, ashtu që ta marrin vizën nga ana e komitetit dhe të ecim tutje.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-vlerësoi se pika 4 dhe 5 të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e lapidarëve, nuk duhet të hiqen nga rendi i ditës, për faktin se të njëjta më herët kanë kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, andaj kërkoj nga të gjithë anëtarët e kuvendit që edhe për hir të respektit ndaj anëtarit të kuvendit z.Ali Januzi këto propozime për lapidar të aprovohen sot. Lidhur me këto propozime ai gjithëherë do të votoj pro.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se, pikat të cilat nuk kanë kaluar në komitetin për Politikë dhe Financa nuk duhet proceduar tutje dhe të cilat nuk i kanë i përmbushur kriteret ligjore, ndërsa propozimi për ndërtimin e lapidarit duhet të procedohet sepse kjo çështje më herët ka kaluar dhe shqyrtuar në KPF.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, pika lidhur me ndërtimin e lapidareve nuk duhet të hiqen nga rendi i ditës dhe kërkoj edhe nga grupi kuvendar i LVV-së që këto pika të përkrahen nga ana e tyre.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se, pikat lidhur me lapidaret kanë kaluar në KPF edhe më herët dhe të njëjtat do të përkrahen nga ana e LVV-së, por shqetësim paraqet pika e 8 e rendit të ditës sa i përket komisionit për dhënien e pronës në shfrytëzim e cila ka ardhur jashtë shqyrtimi të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku një anëtar i cili tani ka dhënë dorëheqje, ka marr pjesë në dy komisione dhe ka marr vendime të kundërligjshme dhe ka qenë në kundërshtim me konfliktin e interesit. Lidhur me këtë çështje së pari duhet të sillen vendimet e këtij komisioni që janë marr në konflikt të interesit për t'i anuluar e më pas duhet të procedohet propozim për zëvendësimin e këtij anëtari të këtij komisioni.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, anëtarët e grupit të LVV-së nuk janë duke i kuptuar çështjet, sepse grupi kuvendar i LDK-së është “pro” që çështjet që kanë të bëjnë me dhënien e pronës në shfrytëzim të hiqen nga rendi i ditës dhe këtë e potencoj nga fillimi. Ndërsa sa i përket lapidarëve janë “pro” që futen në rendin e ditës për aprovim.

Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit-sqaroi se, ai ka qenë anëtar i komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtre të pronës komunale, nga i cili komision ka dhënë dorëheqje, ndërsa nuk ka qenë asnjëherë anëtar i komisionit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë kur edhe janë bërë aktivitete për dhënien e pronës në shfrytëzim e që ai nuk ka qenë pjesë e komisionit as që ka marr ndonjë vendim. Më tej sqaroi se ka qenë anëtar i Komisionit për ankesa lidhur me pronën dhe këtë detyrë e ka ushtruar konform legjislacionit në fuqi.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-sqaroi se, anëtari i komisionit z. Kushtrim Hysen, në takimin e dytë dhe pas dy ore debat dhe shqyrtim të pikave të rendit të ditës dhe kur ai ia kishte tërhequr vërejtjen se është në konflikt të interesit tek atëherë z. Hyseni ka bërë një shkrësë të dorëhiqet nga komisioni. Ndërsa lidhur me çështjen e lapidarëve, grupi kuvendar i LVV-së i përkrah plotësisht. Tutje shtoi se kërkesat apo dokumentacioni për dy lapidarët si ai në fshatin Shallic dhe Dumnicë e Poshtome nuk janë të proceduara sipas kriterëve që do të duhej të ishin. Kërkesa e fshatit Shallic nuk është e nënshkruar nga kryetari dhe këshilli lokal i fshatit.

Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit-duke iu përgjigjur parafolësit të tij sqaroi se është e vërtet që janë mbajtur dy mbledhje me datat 25 dhe 28 qershor 2024, por ai dorëheqjen e ka paraqitur më datën 19 qershor 2024. Ai z. Ymer Haradinaj nuk e njeh ligjin dhe flet me hamendësime dhe

atë çfarë dëgjon në kafehanetë e qytetit, dhe në të dy mbledhjet ai nuk ka pasur kurrfarë vërejtjesh që konstatohen në proces.

Remzi Ahmeti, drejtor për Pronës- deklaroi duke sqaruar se, anëtari i komisionit z. Kushtrim Hyseni, nuk ka bërë kurrfarë shkelje ligjore, sepse para se të filloi mbledhja e komisionit ai ka paraqitur dorëheqjen e tij dhe të gjitha proceduar janë zbatuar konform ligjit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-kërkoi unitet për sa i përket caktimit të lokacioneve për këta lapidar, dhe shtoi se këto lokacione janë në fshatrat ku kanë bërë rezistencën kundër armikut dhe këta lapidarë po ndërtohen në qytet. Pastaj vlerësoi se Adem Voca vërtetë është specifik sepse është legjendë në vetvetën e tij dhe se e tërë familja e tij është flijuar për atdhe dhe komb. Ai është sakrifikuar për ne të gjithë që sot të mbajmë të lirë këtë mbledhje të kuvendit, kërkoj që të gjithë të jenë unik për votimin e këtij lapidari dhe nderimit për dëshmorët.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-duke iu referuar raportit të auditorit, ku është konstatuar se për pozitën e punës edukatore për parashkollor, testi me shkrim nuk ishte nënshkruar nga kandidatja fituese, gjithashtu përgjigjet e pyetjeve teorike në testim me shkrim të kandidatës ishin identike me shabllonin e përgjigjeve të testit me shkrim që kishte përgatitur komisioni për praninë dhe kjo lë të kuptoj se përgjigjet e testit me shkrim ishin kopjuar. Kjo çështje duhet me urgjencë të trajtohet nga organet e hetuesitë dhe me që është i pranishëm edhe komandanti i policës ai duhet të iniciojë ndonjë hetim, sepse kemi të bëjmë me një veprë të rënd penale. Ai pyeti kryetarin e komunës se çfarë profili të mësuesit jeni duke ndërtuar, kur pësohen persona me teste të kopjuara. Përpos që duhet të fillojnë hetimet, ai propozoi që të formohet një komision për verifikimin e konkurseve në fushën e arsimit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-duke iu kthyer sërish çështjes së zëvendësimit të anëtarit të komisionit për pronë, shtoi se, dorëheqja përmes adresës elektronik, mund të jetë i dyshimit, por edhe nëse nuk është kështu, pyeti se përse propozimi për ndryshim dhe plotësimin e këtij komisioni nuk erdhi në muajin qershor por pikërisht tani. Më tej vazhdoi duke pyetur se cili është fati i atyre vendimeve që ai komision ka marr, sepse kjo çështje është tentuar të mbahet jashtë publike edhe pse të gjithë qytetarët e dinjë se çfarë po ndodh me pronat te lokacioni stacioni i vjetër i autobusëve.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se, nëse z. Ali Januzi, flet pak më gjatë atëherë duhet toleruar dhe shtoi se, asnjëherë ai nuk do ta përdorë apo keqpërdorë foltoren e kuvendit për ta goditur ndonjë njeri dhe as kundërshtarët e tij politik. Ai asnjëherë nuk deklaroi për diçka që nuk di dhe apeloj që të gjithë të kemi një minimum edukate në deklaratimet publike sepse jemi para qytetarëve. Apeloj të ruhet dhe të ndiqet fryma e unitetit dhe bashkëpunimit. Te kryesuesja e kuvendit apeloj që ta respektoj rregulloren e punës së kuvendit duke e respektuar kohën e diktimit. Lidhur me raportin e auditorit dhe të gjeturat në të, ceku se i njëjti le të dërgohet te prokurori, siç është dërguar edhe më herët që iu ka dështuar sepse asgjë nuk ka për tu fshehur se ata nuk po dinë se ku ti kapen për faktin se nuk ka asnjë shkelje. Lidhur me çështjen e testit në arsim shtroj se çështjen se cila është në përfundim sepse kandidatja i ka ditur përgjigjet dhe në këtë rast ka mundur të jet edhe znj. Fatmire Cecelia.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, çështja e ngritjes së komisioneve hetimore siç është ai për shëndetësi dhe për prona është jashtë mandatit tonë dhe jemi duke rrëshqitur në marrjen e kompetencave si të ishim në rolin e prokurorit apo të gjykatësit, kompetenca që nuk na takojnë. Prandaj komisioni hetimor për arsim le të ngritet, por dijeni se jeni në kundërshtim me ligjin. Me që janë formuar komisione të tilla edhe më herët le të formohet edhe ky komision dhe si grup i LDK-së e përkrahim këtë komision.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha, aspak nuk i pengon ngritja e komisionit hetimor, por nëse ka të gjetura atëherë merrni ato dhe dërgoni te organet e hetuesisë dhe prokurorisë. Nëse është

konstatuar shkelje në ato teste atëherë le të merret ajo lëndë e cila është publike dhe të dërgohet te prokuroria, por mos të tentohet në këto forma të goditen njerëzit dhe të tentohet të krijohen insinuata.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se, raporti i auditorit është publik dhe nëse ka shkelej atëherë duhet të iniciohet procedura hetimore. Nëse shkohet me formim të komisionit atëherë ne sikur po i marrim kompetencat e organeve të drejtësisë.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së-duke ju referuar raportit të auditorit, ku ceket se testi nuk ishte i nënshkruar nga kandidatja fituese, ceku se kjo përgjegjësi bie tërësisht mbi kandidaten që ka qenë fituese. Tutje sqaroi se me të gjeturat në raportin e auditorit kryetari i komunës ka nënshkruar një letër për pranimin e këtij raporti në mënyrë formale, por nuk ka mundur të merret në mënyrë meritore me këto çështje për shkak të problemeve shëndetësore që ka pasur në atë kohë, që është ballafaquar me dy operacione. Në këtë kontekst ai vlerësoi duke sqaruar se, vitin e kaluar kryetari i komunës e kishte sfiduar auditorin duke e ballafaquar me fakte lidhur me raportin e tij.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, të tjerat abstenim, aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 qershor 2024.
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2024.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin “Adem Voca” në fshatin Pasomë.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pllakës përkujtimore për z. Milaim Fejzullahu, ish-komandant i Policisë së Kosovës.
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2024.
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr.02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të komunës për periudhën janar-qershor 2024.
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Vjetor Financiar dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore.
12. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. “Përparimi” SH.A për vitin 2023.
13. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e mbështetjes financiare për Klubin e Hendbollit “Samadrexha” F.
14. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë mbajtur më datë 27 qershor 2024.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 27 vota “për”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 qershor 2024.

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2024.

Reshat Kovaçi, komandant i Stacionit Policor në Vushtri-në adresimin e tij para kuvendit, në lidhje me deklaratimet e anëtarit të kuvendit z. Refik Maloku, ceku se të gjithë ata që kanë informata se ndokush ka konsumuar elemente të veprës penale duhet të prezantojnë në stacionin policor, ndërsa lidhur me deklaratimet e anëtarit të kuvendit, njoftoj se profesor Refik Maloku, do të kontaktohet nga zyrtarët policor për ti marr informatat e tij për pretendimet e tij për kryerjen e ndonjë vepre penale nga ana e ndonjë zyrtari komunal.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pasi e falënderoi togerin z. Kovaçi dhe policinë në përgjithësi për bashkëpunimi dhe ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët, ceku se, i vjen shumë keq që togeri rastisë të prezantoi në një seancë të kuvendit ku abuzohet fjala e lirë dhe demokracia. Tutje vlerësoi se siguria e demokracisë në këtë kuvend është e rrezikuar kaheerë, për faktin se kryesuesja e kuvendit sigurisht e dirigjuar, kokë në veti e në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisjes Lokale, me statutin e komunës dhe rregulloren e punës së kuvendit, nuk e qet në votim propozimin për futje në rendin e ditës, themelimin e komisionit për verifikimin e të gjeturave të auditorit të përgjithshëm krejt kjo qëllimshëm dhe po ashtu nuk e hedh në votim propozimin e tij për largimin nga rendi i ditës të pikës që ka të bëjë me plotësim-ndryshimin e komisionit për dhënin në shfrytëzim të pronave. Nëse MAPL i shikojnë dhe dëgjojnë këto incizime të kësaj seance të kuvendit, duhet ti ndezin alarmet për mënyrën e udhëheqjes së kuvendit, sepse këta na flasin për madhështinë e memorialëve, ndërsa i mbushin kutitë e votimet me vota për peronat që nuk janë në sallën e mbledhje janë pikërisht këta të njëjtit, që i nderojnë dëshmoret duke u rrëfyer para prokurorisë për votimet për persona jo prezent, dhe sigurisht se edhe ky rast është për tu trajtuar nga ana e policisë. Në krejt këtë histori kanë qenë të përfshirë kryesuesja e kuvendit, nënkryetari i komunës dhe anëtarët e kuvendit nga partia në pushtet, kokë e kryer kanë qenë të implikuar dhe këtë nuk do ta harrojmë asnjë herë deri në një epilog gjyqësor. Si grup kuvendar shprehim mos pajtimin e plotë më mënyrën e udhëheqjes së kuvendit, sepse nuk është duke u udhëhequr në mënyrë demokratike dhe nuk ka të bëjë me mbarëvajtje të mbarë të punës së kuvendit. Anëtarët e kuvendit vinë në seancë të kuvendit, sepse këtë mision e kanë marr nga ana e qytetarëve dhe nuk janë këtu as për interesa të kryetarit të komunës, as për kryesuesen e kuvendit dhe për asnjë individ tjetër sepse kuvend i takon anëtarëve të tij.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme.

Në vazhdim, pas propozimeve të bëra kuvendi me vota unanime themeloj Komisionin Kuvendar për mbarëvajtjen e procesit të votimit lidhur me pikata 3, 4 dhe 5 në përbërjen si në vijim:

- 1.Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit PDK;**
- 2.Bujar Pllana, anëtar i kuvendit LDK;**
- 3.Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit LVV.**

Pas verifikimit dhe konstatimit nga ana e komisionit se fletëvotimet janë në rregull, filloj procesi i votimit të fshehët për pikën 3 të rendit të ditës Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme.

Pas përfundimit të votimit dhe numrit të votave nga ana e komisionit, kryesuesja e kuvendit konstatoj se me 27 vota “për” 1 votë “kundër” dhe 2 vota “abstenim” kuvendit vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtim të lapidarit për të rënë për Liri nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Vushtrrisë, kundër pushtesit serb, para, gjatë dhe pas luftës së dytë botërore.

2. Ndërtimi i lapidarit do të bëhet në parcelën kadastrale P-70202026-00704-0, në sipërfaqe prej 450 m², vendi i quajtur “Shpoti”, dhe në pjesë të parcelës kadastrale P-70202026-00703-0 në sipërfaqe prej 1500 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3283 m², vendi i quajtur “Shpati Gazhjan”, Zona Kadastrale Dumnicë e Poshtme, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë që do të bëjnë shenjëzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi si dhe regjistrimin në RDPP dhe dokumentet tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Financimi i realizimit të këtij projekti do të bëhet nga komuniteti i fshatit Dumnicë e Poshtme. Këshilli i këtij fshati do të siguroj listën e emrave të cilët do të shkruhen në lapidar.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa e përfaqësuesve të fshatit Dumnicë e Poshtme, Lista me nënshkrime, Lista e emrave të cilët do të shkruhen në lapidar dhe certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.

6. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin “Adem Voca” në fshatin Pasomë.

Pas verifikimit dhe konstatimit nga ana e komisionit se fletëvotimet janë në rregull, filloj procesi i votimit të fshehët për pikën 4 të rendit të ditës Propozim-vendimi caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin “Adem Voca” në fshatin Pasomë.

Pas përfundimit të votimit dhe numrit të votave nga ana e komisionit, kryesuesja e kuvendit konstatoj se me 24 vota “për”, 5 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim”, kuvendi vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 m², me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të patundshmërisë të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, kurse me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destinimit (kulturës) së kësaj parcele në elaboratin kadastral.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pllakës përkujtimore për z. Milaim Fejzullahu, ish-komandant i Policisë së Kosovës.

Pas verifikimit dhe konstatimit nga ana e komisionit se fletëvotimet janë në rregull, filloj procesi i votimit të fshehët për pikën 5 të rendit të ditës Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pllakës përkujtimore për z. Milaim Fejzullahu, ish-komandant i Policisë së Kosovës.

Pas përfundimit të votimit dhe numrit të votave nga ana e komisionit, kryesuesja e kuvendit konstatoj se me 28 vota “për”, 1 votë “kundër” dhe 1 votë “abstenim”, kuvendit vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e pllakës përkujtimore për ish-komandantin e UÇK-së dhe Komandantin e Policisë së Kosovës z.Milaim Fejzullahu në fshatin Shalë/Shallc, në parcelën kadastrale P-70202069-00341-0 në sipërfaqe prej 959 m², me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Shalë/Shallc, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Aprovohet peticioni i banorëve të fshatit Shalë/Shallc, me Nr.02-104/02-17682/24 i datës 22.04.2024 i parashtruar në emër të z.Sabri Fejzullahu, me të cilin është kërkuar rregullimi i një paraku në fshatin Shallc dhe vënia e pllakës përkujtimore për ish-komandantin e UÇK-së dhe Komandantin e Policës së Kosovës z.Milaim Fejzullahu.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që do të bëjnë shenjëzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi si dhe regjistrimin në RDPP dhe dokumentet tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa e përfaqësueseve të fshatit Shallc, certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.

5. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2024.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se vendimet e kuvendit janë obliguese për zbatim nga kryetari i komunës dhe ekzekutivi komunale, për deri sa ato janë në fuqi dhe kuvendi nuk vepron ndryshe me një vendim tjetër për shfuqizim apo për anulim. Më tej ngri shqetësimin për mos zbatimin e një vendimi për sa i përket emërimit të Teatrit të Qytetit me emrin e Artistit <Adem Mikullofci>, si grup i LVV-së me financa vetanake e kanë vendosur një pllakë më emrin e teatrit të qytetit në ballë të këtij institucioni, dhe sipas informatave jo zyrtare ajo pllakë është larguar nga era dhe tashmë edhe kjo përgjigje jo zyrtare nuk i plotëson kushtet për të qenë e vërtetë, kjo për faktin se qeveris Idrizi, nuk i kanë mjaftuar 3 vite qeverisje për të vendosur këtë pllakë sipas vendimit të kuvendit, dhe krejt kjo po ndodh për shkak të inateve politike dhe kjo është e turpshme, se si po provohet të përdhohet emri i një figure të madhe të Kombit tonë vetëm e vetëm pse i ka takuar një subjekti të caktuar politikë.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e tij dhe të qytetarëve për kanalizimin në fshatin Stanoc i Epërm që vjen nga fshati Breznicë në drejtim të lumit “Llap” e që ai kanalizim ka defekt dhe si pasojë e kësaj po kundërmon me një erë jashtëzakonisht të rëndë dhe po kanos me shkakimin e ndonjë epidemie për banorët lokal. Defekti më i madh i këtij kanalizimi është tek lagjet Bllacaj, Maloku dhe Haradinaj aty ne lagjet që gravitojnë shumë banorë. Kërkoj nga kryetari i komunës dhe drejtorja kompetente që të ndërmarrin veprimet e menjëhershme, duke lidhur një memorandum bashkëpunimi me Komunën e Obiliqit sepse ky kanalizim vjen nga fshati Breznicë që është në Komunën e Obiliqit, dhe të dyja këto komuna janë të obliguara që të bëjnë rregullimin dhe sanimin e këtij problemi. Po ashtu, përsërit kërkesën e tij për nevojën urgjente për eliminimin e një deponie të mbeturinave në fshatin Stanoc i Epërm, sepse e njëjta po shkakton pengesa për fermerët për t’i punuar tokat e tyre. Kërkoj që urgjentisht të merren masat adekuata nga organet kompetente, për eliminimin e kësaj deponie.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-ngrit dhe përsërit shqetësimin e tij të kamotshëm për një deponi ilegale në fshatin Pasomë dhe për dëmtimin e rrugës në këtë fshatë nga një operator ekonomike, kërkoj të merren masa të menjëhershme duke ndaluar së gjuajturi mbeturina në atë zonë, sepse jetesa e atyre banorëve lokal është bërë e padurueshme. Më tej ngrit çështje e tharjes së drunjtëve dekorativ dhe luleve që po mbjellën në qytet si rezultat i thatësirave fatale, mos kujdesit dhe mos ujitjes nga ana e autoriteteve komunale.

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se z.Kushtrim Hyseni është zgjedhur anëtar i komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në mbledhjen e kuvendit të muajit mars 2024. Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale konkretisht neni 18 përcakton: Kuvendi i Komunës formon Komisionin e Ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve. Andaj z.Kushtrim Hyseni, ka qenë anëtar edhe i komisionit për shqyrtimin

e ankesave lidhur me pronën komunale dhe kësisoj ai ka vepruar në konflikt të interesit duke qenë pjesë e dy komisioneve. Në këtë kontekst pyeti anëtarin e komisionit t cekur më lartë sa ka mbajtur ndonjë mbledhje dhe a ka marr ndonjë vendim Komisioni për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, duke ditur se ai ka qenë në konflikt të interesit. Ai kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme derisa ti kemi informata e duhura dhe kjo çështje të sqarohet përfundimisht se anëtari i apostrofuari ka vepruar në konflikt të interesit duke qenë pjesë e dy komisioneve.

Bekim Zabergja, anëtar i komisionit-tha se kuvendi ka vepruar gabimisht kur ka votuar që z. Kushtrim Hyseni të jetë pjesë e dy komisioneve, dhe shtoj se nuk ka kurrfarë pengesa tashmë sepse i apostrofuari para mbajtjes së takimeve ka dhënë dorëheqje nga Komisioni për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale. Andaj propozoi që të procedohet tutje me votim për ndryshimin dhe plotësimin e komisionit në fjalë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se pas sqarimeve që i morëm, nuk vend për diskutim sepse sheshazi po del se njëri nga anëtarë e atij komisioni z.Kushtrim Hyseni ka qenë në konflikt të interesit, prandaj bazuar në këto informata kërkoj që të sillen të gjitha dokumentet dhe vendimet që janë marr nga ai komision që ka vepruar në konflikt të interesit. Duke marr për bazë se komisionit ka qenë në përbërje jo të plotë edhe vendimet nuk mund të jenë të vlefshme, andaj kësisoj ata si grup kuvendar nuk e mbështesin këtë pikë të rendit të ditës.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se defekti i këtij kuvendi është se ka formuar disa komisione dhe ato akoma nuk kanë ndërmarr asnjë përgjegjësi. Në mbledhjen kur është votuar ky komision atë ditë ka pasur shkelej, sepse atë ditë nuk është dashur të aprovohet vendimi për formimin e komisionit për ankesa lidhur me pronën, sepse ky vendim ka qenë i paligjshëm përderisa anëtari i kuvendit ka qenë pjesë e një komisioni tjetër që lidhet me dhënien e pronës në shfrytëzim. Më tej shtoj se askujt nuk i lejohet të zgjedhë se në cilin komision dëshiron të qëndroj, krejt kjo për interesa të individëve të caktuar. Pastaj ai vlerësoi dhe konstatoi se vendimi i parë ku është zgjedhur z.Hyseni anëtar është i ligjshëm sepse ka marr aprovimin e MAPL-së, ndërsa vendimi i dytë për shqyrtimin e ankesave është i paligjshëm dhe si i tillë duhet të anulohet.

Kushtim Hyseni, anëtar i kuvendit-sqaroi se ka qenë anëtarë i komisionit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër, komision ky i cili akoma nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet, nuk ka mbajtur ndonjë mbledhje, dhe as që bëhet fjalë për shpalljen e ndonjë procedure për dhënin e pronës në shfrytëzim dhe marrjen e ndonjë vendimi. Më tej shtoj se nga ky komision ka dhënë dorëheqje me datën 19 qershor 2024, ndërsa mbledhjet e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim janë mbajtur më 25 përkatësisht 28 qershor 2024 që i bie se dorëheqje ka dhënë 6 përkatësisht 9 ditë para mbajtjes së mbledhjeve të komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim, në këtë kuptim nuk bëhet fjalë për kurrfarë konflikti të interesit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se atë që e deklaroi në fillim në mbledhje po vërtetohet se ky rend dite është dizajnuar asi soj që po ndodh ajo se çfarë po ndodh aktualisht, ku renditja e pikave të rendit të ditës, që ndryshojnë nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, ashtu që pikat e rëndësishme siç anë raportit i auditorit, ai i shpenzimeve buxhetore dhe raportit i Ndërmarrjes “Përparimi” janë zhvendosur më poshtë për ta larguar vëmendjen e anëtarëve të kuvendit. Prandaj duke pasur parasysh këto rrethana kërkoj që kjo mbledhje të ndërpritet dhe të vazhdohet për një ditë tjetër kur prezent do të jetë edhe kryetari i komunës për raportuar para kuvendit. Lidhur me pikën 8 propozimi për plotësimin e komisionit për ankesa lidhur me pronën komunale, vlerësoi se konfliktit i interesit ka ndodhur në vendimin dhe komisionin e dytë atë për shqyrtimin e ankesave lidhur me pronën komunale, dhe personi i cili po deklarohet se ka dhënë

dorëheqje nuk mundet të zgjedhe se në cilin komision dëshiron të qëndroj dhe në cilin do jap dorëheqje, sepse ai dorëheqjen duhet ta bëj nga komisioni i cili është i paligjshëm dhe aty ku ka rënë në konflikt të interesit. Dhe z. Hyseni është ndeshur në konflikt të interesit atëherë kur është bërë pjesë e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me pronën komunale.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se sikur disa anëtarë të kuvendit nuk janë duke e kuptuar se çfarë është konflikti i interesit, sepse konflikti i interesit nënkupton kur ndokush ankohet se peroni i caktuar ka pasur interesa të caktuara në një vendimmarrje. Në rastin konkret konsideron se nuk ka kurrfarë konflikti të interesit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, në këtë rast kryesuesja e kuvendit konstatoj se: Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nuk aprovohet.

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr.02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Ilirjana Azemi, zyrtare në DUMM-paraqiti sqarime hyrës lidhur me draft-rregulloren në fjalë duke shuar se plotësim-ndryshimi i kësaj rregulloreje ka ardhur si rezultat i kërkesave të drejtorive komunale dhe sipas nevojave të kohës.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se kjo rregullore është aprovuar në muajin dhjetor 2023, dhe kjo tregon më së mirë se nuk kemi hartuar një rregullore të mirëfilltë sepse pas 6 muajsh ajo është sjellë serish për ndryshim dhe plotësim. Më tej shtoj se është mirë që janë ndryshuar dhe lehtësuar tarifat sa i përket sportit dhe kulturës. Mandej pyet se sa është duke u zbatuar rregullorja aktuale për taksat për dhënie të pronës në shfrytëzim, kur dihet fakti se në bazë të një raporti del se ka qindra mira euro borxhe ndaj komunës si nga bizneset ashtu edhe nga qiramarrësit tjerë për shfrytëzimin e pronës komunale.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se kur bëhen plotësim-ndryshimet e rregulloreve komunale është obligim ligjor që të zhvillohen debatet publike, nga grupe interesi dhe qytetar të cilët preken në sferën e interesit nga ai akt apo ajo rregullore. Mirëpo në rastin konkret për këtë rregullore nuk ka pasur një target-grup i cili do të ishte adekuat me këtë rregullore. Në listën e pjesëmarrësve për dëgjimin publik për këtë rregullore shihet se janë pastruesit e komunës dhe punëtorët e administratës komunale. Prandaj në vend se për këtë rregullore të ftohen sportistët, bizneset dhe grup tjera që do të mund të jepnin mendimin e tyre të vlefshëm, hartuesi i kësaj rregulloreje inskenon situata gjoja se dikush ka marr pjesë në takim, ndërsa realiteti është krejt tjetër fare.

Ilirjana Azemi, zyrtare në DUMM-sqaroi duke u përgjigjur se për tarifat lidhur me pronën komunale, zbatohet një ligj tjetër Ligji për Dhënie në Shfrytëzim si dhe rregullorja përkatës, rregullorja për taksat dhe tarifa nuk bie në këtë domen të aplikimit të taksave. Po ashtu njoftoi se në rregullore duhet të futet edhe taksat për certifikatën për zotësinë e veprimit për funksionarët e ndryshëm publik, taksë në vlerë prej 10 €.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për”, të tjerët nuk morën pjesë në votim, aprovoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr.02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të komunës për periudhën janar-qershor 2024.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se ky raport është hartuar në mënyrë tepër jo profesionale, dhe shtoj se cilësia e një raporti matet me aplikimin e metodave krahasimore. Në rastin konkret nuk kemi një krahasim me vitin e kaluar sa i përket kategorive investime kapitale, subvencione, mallra dhe shërbime dhe për kategoritë tjera ekonomike. Në këtë kontekst shprehu dyshimin se kjo është bërë me qëllim për faktin se të hyrat për këtë periudhë janë më të ulëta, ndërsa shpenzimet janë rritur krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në fund tha se grupi kuvendar i LDK-së një raport të tillë nuk mund ta përkrahë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ky raport pasqyron një performancë tejet të dobët të qeverisjes komunale të cilën e kemi pasur në vazhdimësi në kuptimin e shpenzimit të buxhetit, sidomos tek investimet kapitale. Ai deklaroi se ky raport nuk mund të merret seriozisht si i tillë është një përpjekje për ti vu në lajthitje anëtarët e kuvendit, andaj me keqardhje nuk meriton të merremi fare me të.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se në bazë të raportit del se shpenzimet e pastrimit janë rritur nga 7500 € sa kanë qenë vitin e kaluar, këtë vit 19,500 €, dhe kjo dihet sepse cili operator ekonomik e ka marr tenderin për pastrim. Pastaj pyeti se ku kanë shkuar rreth 254,000.00€ për mirëmbajtjen e rrugëve kur dihet se rrugët e qytetit janë gjendje të katrahurës. Pastaj kemi rritje të shpenzimeve për sa i takon drekave zyrtare ku në vitin e kaluar ishin 16,000.00 € shpenzime për këtë destinim ndërsa këtë vit rritja ka shkuar në 23,000.00 €. Më tej njoftoj qytetarët se Komuna e Vushtrisë për vitin 2024 ka paraparë të realizoj 238 projekte kapitale, ndërsa 180 prej tyre fare nuk kanë filluar ndërsa jeni në muajin e tetë të vitit 2024. Në fund ceku se kur të shikohet përqindja e shpenzimit të buxhetit del e lartë për shkak të përmbarimit ndërsa mungojnë projektet që do të duhej të financoheshin nga taksat e qytetarëve.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të komunës për periudhën janar-qershor 2024, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Ai sqaroi se për këtë periudhë shkalla e shpenzimit dhe realizimit të buxhetit është e kënaqshme në masën rreth 90%, dhe atë në gjitha kategoritë ekonomike.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-vlerësoi se drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, me mjeshtri ka paraqitur në tabela shpenzimin e buxhetit. Ne e dimë se buxheti i komunës aprovohet për një vit kalendarik, ndërsa në bazë të dhënave që i parashtrij drejtori shpenzimi i buxhetit i ofrohet masës 100%, por realiteti i shpenzimit të buxhetit është rreth 33 %. Ajo çfarë është shqetësuese është fakti se janë rreth 184 projekte me shumën zero, që nuk kanë filluar fare, ndërsa janë 37 projekte me shuma simbolike si p.sh. ndërtimi i Sheshit “Hasan Prishtina” vlera 37 €. Dhe për këtë ceku se çfarë gabimesh kanë mundur të rrjedhin.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se është bërë rutinë që të kemi përsëritje të gabimeve teknike, dhe edhe ky raport i referohet vitit 2023, ndërsa raporti është për periudhën janar-qershor 2024. Kjo gabime tregojnë se jeni duke punuar nënë presion të lartë se po keni edhe punë tjera për bërë përpos punës që paguheni nga taksat e qytetarëve. Tutje shtoj se raporti konstaton se janë shpenzuar goxha do mjete financiare por janë kryer pak projekte, projektet nuk janë kryer sepse mjetet i kanë marr përmbaruesit privat. Duke ju referuar diskutimit të kryetarit të komunës, për

dëmet nga Kontrata Kolektive që i ka shkaktuar Ministria e Arsimit, ceku se kjo kontratë është nënshkruar në vitin 2017 pak para fillimit të fushatës elektorale, dhe nuk ka të bëjë fare me ministrinë aktuale. Më tej duke u bazuar në raport ceku disa projekte që kanë shuma tejet simbolike si p.sh. Riparimi i Shkollës Krasniqe e Poshtme shuma e projektit 1 €, fondi me bashkëfinancim me kubëz vlera 2 €, rregullimi i trotuareve Vushtrri-Stanoc Smrekonicë 0.25 €, rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara në Vushtrri 0.99 €, ngritja e serave 2 €, ndërtimi i parkuar në Stanoc 0.53 €, rregullimi i nyjeve sanitare në Vushtrri 63 €, rregullimi i Palestrës Sportive “Jeton Tërstena” 0.75€. **Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi** se shumatat dhe vlerat simbolike, në projektet kapitale, kanë mbetur si rezultat që janë marr mjete financiare për shkak të inflacionit të pagave, dhe mjetet nga departamenti i thesarit janë marr tani ato shuma kanë mbetur kur është bërë ridestiniimi i mjeteve.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 12 vota “për”, 13 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim”, nuk e aprovoj raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të komunës, për periudhën janar-qershor 2024.

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Vjetor Financiar dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se për tu fshehur të gjeturat në raportin e auditorit të përgjithshëm ai është futur bashkërisht me raportin e përgjithshëm financiar. Tutje shtoj dhe vlerësoi se raporti i auditorit është një ndër pikat më rëndësishme për komunën dhe mos të jetë kryetari i komunës prezent kjo është jo serioze, kjo për faktin se para disa mbledhjeve kryesuesja e kuvendit e kishte shtyrë mbledhjen pikërisht për shkak të mungesës së kryetarit në mbledhjen e kuvendit. Kryetari i komunës ka zgjedhur që të ikë nga debati, dhe për mos tu ballafaquar me të gjeturat e auditorit të përgjithshëm, mirëpo kjo nuk ka rëndësi sepse qytetarët janë duke e ditur se çfarë po ndodhë me qeverisjen aktuale të komunës. Qytetarë duhet ta dinë se nga 18 të gjetura apo rekomandime, që kanë qenë nga viti i kaluar tani janë shtuar edhe 9 tjera, d.m.th. si komunë kemi dështuar në adresimin e rekomandimeve dhe për më keq është shtuar numri i rekomandimeve nga ana e auditorit të përgjithshëm. Për secilën prej këtyre të gjeturave janë duke u marr organet e rendit, ndërsa për secilën prej tyre do të debatohet atëherë kur do të jetë i pranishëm kryetari i komunës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se raporti i auditorit do të duhej të ishte ndër pikat më të rëndësishmet në këtë, kuvend por siç po shihet nuk ka gatishmëri për debat sepse ka shmangie dhe ike nga debati. Tutje vlerësoi se shpreson se kryetari bashkë me ata drejtor që janë fascinuar se si kryetari iu ka përgjigjur auditorëve po në fund janë pajtuar më të gjeturat kanë për të shkuar në një vend tjetër për tu rrëfyer sepse raporti është i kualifikuar, dhe për më tepër ai listoj disa nga të gjeturat e auditorit të përgjithshëm për Komunën e Vushtrrisë. Zyra Kombëtare e Auditimit në Komunën e Vushtrrisë ka identifikuar se: në fushën e arsimit për pozitën e punës edukatore parashkollë testi me shkrim nuk ishte nënshkruar nga kandidatja fituese gjithashtu përgjigjet në testin me shkrim ishin identike me shabllonin e testi me shkrim që kishte përgatitur komisioni për pranim dhe kjo lenë të kuptoj se përgjigjet me shkrim të jenë të kopjuara. Për pozitën në lëndën e tekstilit në konkurs ishte kërkuar që kandidati/ja të kishte përgatitje shkollë bacheloret i dizajnit dhe drejtimi konfeksion, ndërsa kandidatja e pranuar kishte përgatitje shkollë bacheloret i dizajnit dhe modës, për këtë pyeti kryetarin e komunës se a bëhet fjalë për një mësimdhënëse me të cilën shëtiste rrugëve të Tiranës duke ia mbuluar edhe shpenzimet, fotografit e tyre dukshin bukur, por shkeljet janë flagrante. Në fushën e shëndetësisë auditori ka gjetur se njëra nga organizata

përfituese të fondeve të komunës në vlerë prej 13,500 € nuk kishte ofruar fare raport të shpenzimit të mjeteve, as raport financiar as raport narrativ edhe pse kjo gjë është obligim ligjor, mos dorëzimi i këtij raporti deshifron se kemi elemente të qarta të veprës penale. Po ashtu auditori ka gjetur vonesa, shkelej dhe tejkallim të afateve tek projekti rregullimi i zyrave të administratës së QKMF-së dhe rregullimi i oborrit të QKMF-së. Në fushën e kulturës auditori ka identifikuar në katër raste të subvencionimit të projekteve të DKRS në vlerë 18,000.00 € komisioni nuk ka përdorur formularët standard të vlerësimit siç kërkohet rregulloren bazë, kjo me falë tjera i bie se komisioni i ka ndarë mjete pa kurrfarë kriteri dhe pa formularë standard, ndërkohë akoma më keq tek projekti “ndërtojmë vetëdijen dhe zgjohemi kundër drogave” në vlerën prej 2500 € për pos që mungon formulari i vlerësimit përfituesi në këtë rast OJQ-ja kishte aplikuar dy ditë pas mbylljes së afatit, në këtë rast shtohet pyetja se si ka mundësi që dikujt ti ndahen para nga fondi publik pa konkurruar fare. Mandej auditori ka gjetur gjëra mjaft pikante edhe për sa i përket pronave publike në Komunën e Vushtrrisë, në tri raste të identifikuar shuma totale e borxheve të qirave ndaj Komunës së Vushtrrisë që nuk është pagur nga kontraktorët është 66,670 €, imagjinon të nderuar qytetar njerëzit shfrytëzojnë pronën e komunës dhe nuk i paguajnë asaj asnjë cent. Të nderuar qytetar të Komunës së Vushtrrisë, komuna jonë nuk kishte mundur të kishte një raport kaq të keq të nxjerr nga auditori i përgjithshëm, prandaj përsërit duke ftuar organet e drejtësisë që të merren me këto raste që janë shkelje flagrante, e me të gjitha këto shkelje menaxhementi i komunës është pajtuar.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se bazuar në raportet e auditimit, Komuna e Vushtrrisë ndodhet në një pozicion jashtëzakonisht negativ menjëherë pas Komunës së Prishtinës. Auditori i përgjithshëm ka gjetur se ka pasur pagesa të parregullta për furnizimime dhe punë në projektet kapitale, mungesa e projekteve detale ekzekutive për kontratat e punëve, parregullsi në procedurat e prokurimit publik, mos vazhdimi i sigurisë së ekzistimit për kohëzgjatjen e kontratës dhe mos ofrimi i garancionit bankarë për kualitetin e punimeve, mos pagesa e qirave mujore nga shfrytëzuesit e pronave publike, tejkallim i vlerave të kontratave për punë publike dhe furnizime nga vlerat e buxhetuara, parregullsi gjatë zbritjeve nga baza tatimore për pronat me banim parësor dhe nivel i ulët i inkasimit të hyrave nga pronat e paluajtshme, tejkallim të vlerës së planifikuar të shpenzimeve të kontrata me çmime të peshuara, parregullsi në procesin e vlerësimit dhe pranimit të aplikacioneve për subvencionim dhe mos përmbushje të kriterëve për fermerët, mos pagesa me kohë e obligimeve për kontraktuesit. Një tjetër gjetje e auditorit është edhe tek blerja e makinerisë, ku Komuna e Vushtrrisë ka blerë një autocisternë zjarrfikëse e përdorur e vjetër e viti 1995 në vlerë financiare prej 69,468.00 €, ndërsa në dosjen e tenderit ishte përcaktuar se viti i prodhimit nuk duhet të ishte më i vjetër se viti 1993. Komuna ka blerë automjet 28 vite të vjetër, në këtë rast komuna nuk ka respektuar udhëzimin administrativ nr.08/2019, që lejon përdorimin e automjeteve të vjetra deri në 15 vite. Kontrata për ndërtimin e fushave sportive dhe rrethojave në shkollë në vlerë prej 31, 498.00€, ishte realizuar me 45 ditë vonesë, ndërsa pranimit teknik nga ana e komisionit ishte bërë me 85 ditë vonesë. Kontrata për asfaltimin e rrugëve Vesekoc-Sllakoc në vlerë prej 110.000.00 € e nënshkruar me datë 08.11.2022 duhet të përfundonte brenda 60 ditëve, ndërsa projekti kishte përfunduar në muajin qershor 2023. Kontrata për projektin me kubza betoni në rrugën “Fehmi/Tahir/Istrefi” në vlerë 93,300 €, e nënshkruar më datën 06.07.2023, duhet të përfundonte brenda 65 dite, punimet nuk janë përfunduar brenda afatit për shkak të planifikimeve jo adekuate dhe nevojës për aneks kontratë. Kontrata për rregullimin QKMF-së në vlerë 36.500.00 € e nënshkruar më datën 22.08.2022 duhet të përfundonte brenda 45 ditëve, situacioni i parë ishte përfunduar më 31.03.2023, ndërsa pagesa e dytë në fund të vitit 2023. Këto dhe shumë të gjetura tjera, për ne si kuvend e sidomos për qeverinë komunale dhe kryetarin e komunës duhet të jenë

brengosëse, andaj kërkoj nga përgjegjësit të marrin masa ndëshkuese, ashtu që buxheti të shpenzohet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe në të mirë të qytetarëve.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-përsërit të gjeturën e auditorit, ku ceket se testi i vlerësimit për pranim në punë nuk është e nënshkruar nga kandidatja e pranuar në punë në arsim, dhe a ka shkelje më të rënd se kjo, prandaj ai është i gatshëm të dëshmoj para organeve të drejtësisë dhe ata duhet të ftojnë përgjegjësit për ti marr përgjegjësit sipas ligjit.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-duke ju adresuar kuvendit, njoftoj dhe sqaroi se ky raport nuk aprovohet nga ana e kuvendit, dhe shtoj se raporti i auditorit është hartuar në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, dhe mund të thuhet se që nga viti 2002 është hera e dytë që Komuna e Vushtrrisë merr një raport të kualifikuar për pasqyrat financiare të komunës. Më tej shtoj se përkundër çështjeve të theksuara dhe opinionit të kualifikuar, në faqen 3 të raporti auditori ka konstatuar mes tjerash se pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023 paraqesin dhe prezantojnë një pamje të drejt të saktë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, sipas kontabiliteti dhe parimit të parasë së gatshme, dhe kjo është fundamentale për Komunën e Vushtrrisë. Auditori i ka parashtruar të gjeturat dhe i ka dhënë rekomandimet e tij, të cilat në bazë të planit do të adresohen për përmbushje. Ajo çka është tepër e rëndësishme është fakti se auditori në asnjë paragraf nuk ka konstatuar se ka pasur keq menaxhim, keqpërdorim dhe korrupsion në Komunën e Vushtrrisë. Ai ceku se numri prej 27 rekomandimeve të auditorit, ka qenë edhe në qeverisjen e kaluar dhe të njëjta nuk janë adresuar dhe një ndër to ka qenë edhe mos regjistrimit si aset objektit i Komunës së Vushtrrisë. Në fund tha se si rezultat i inflacionit të pagave nga kontrata kolektive e arsimit, ku janë marr mjetet nga kategoria investime kapitale ka ndikuar edhe opinionit i kualifikuar i auditorit.

Lorik Maxhuni, drejtor i DSHPS-së-duke ju referuar fushës së shëndetësisë, sqaroi se nga raporti i auditorit është konstatuar si e gjetur subvencionit për HANDIKOS-in, në vlerë 13,500 €, ku ka munguar raporti i kësaj organizate, njoftoj se është ftuar përfaqësuesi i kësaj organizate z.Isak Hyseni i cili e ka sjellë raportin, por që siç duket ai nuk ka qenë bindës për auditorin dhe e gjetura është konstatuar, ai njoftoj se në ardhmen do të kujdesim që gjëra të tilla të mos përsëriten. Ndërsa sa i përket kontratës për projektin për rregullimin e oborrit të QKMF-së njoftoj se ka bërë përpjekje që të komunikoj me operatorin ekonomik, por që ky i fundit në është përgjigjur asnjëherë. Zt. Ramiz Mliqi, ka qenë menaxher i kontratës dhe bashkë kemi komunikuar, ndërsa në ndërkohë operatori ekonomik ka vendosur disa ulëse të cilat të njëjta nuk i kemi pranuar është bërë pagesa e një situacioni për punët që kanë qenë të pranueshme, për punët tjera nuk është bërë pagesa e situacionit dhe ka mbetur si rekomandim që menaxheri i kontratës të kërkoj që kjo kontratë të ndërpritet, dhe beson se deri me tani kjo kontratë duhet të jetë shkëputur.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë për sqarimet korrekte dhe shtoj se Drejtoria e Shëndetësisë, ka pasur edhe ashtu shkelje me të pakta. Pastaj shtoj se drejtori z. Jashari, ka qasje të butë e të mirë, por gjendja nuk është e mirë, sepse opinionit i auditorit nuk ka ardhur si rezultat i keq klasifikimit për shkak të mjeteve që janë marr, sepse keq-klasifikim ka pasur edhe në të kaluarën në komunën tonë edhe në komunat tjera dhe për këtë komuna nuk mund të fajësohet, por opinionit i kualifikuar i auditorit, ka ardhur si rezultat i shkeljeve tjera masive -materiale që kanë ndodhur në Komunën e Vushtrrisë e që janë konstatuar në raport.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- vlerësoi se Drejtori i Financave, nuk duhet të marr mbi supet e tij krejt atë çka ka ndodhur, sepse ai nuk e mbanë atë përgjegjësi, ai apeloj të adresohen rekomandimet dhe raporti për vitin e ardhshëm të jetë i pakualifikuar.

12. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. “Përparimi” SH.A për vitin 2023.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se ky raport i ngjan më tepër një organogrami se sa një raport, sepse më tepër i referohet të dhënave përshkruese të strukturës organizative dhe numrit të të punësuarve. Në këtë kontekst shtoj dhe vlerësoi se Komisioni Komunal i Aksionarëve më e rëndësishme do të ishte të na prezantonte të hyrat dhe shpenzimet dhe financat të cilat i ka marr nga komuna, ku kësaj ndërmarrje Komuna e Vushtrisë i ka ndarë më shumë se një milion euro, dhe në këtë raport është dashur të ceket se çfarë është bërë me ato financa ku kanë shkuar ato mjetet, si ka funksionuar ndërmarrja me këto mjetet të ndara. Si grup politik i LDK-së, gjithëherë e kemi përkrahur këtë ndërmarrje kur ka qenë çështja për ndarjen e mjeteve nga ana e komunës për këtë ndërmarrje. Ai shtoj dhe kërkoj llogari se ku po shkojnë këto mjete, sepse tani kemi ankesa se as mbeturina nuk janë duke u pastrua mirë, prandaj grupi kuvendar i LDK-së këtë raport si të tillë nuk mund ta përkrahin me votë.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-për dallim nga parafolësi i tij, vlerësoi se ky raport është më i strukturuar se sa i kaluari, për shkak se i njëjti përmban të dhëna mjaft të vlefshme. Tutje ceku se në faqe 14 aty ku flitet për shpenzimet e ndërmarrjes në vlerë mbi 1 milion euro, mungon tabela se ka janë shpenzuar këto mjete dhe cilat kanë qenë politika zhvillimore të ndërmarrjes. Pastaj ceku se tek çështja ku theksohet se është kontraktuar një kompani katro për auditim të jashtëm, pyeti se kush e ka përzgjedhur këtë kompani. Kjo kompani përpos përshkrimit të veprimtarisë së saj, nuk ka dhënë ndonjë konstatim lidhur me të gjeturat dhe zhvillimin e afarizmit të ndërmarrjes “Përparimi” dhe pyeti se me cilat procedura të prokurimit është kontraktuar kjo kompani me procedura të komunës apo të Ndërmarrjes “Përparimi”.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ky raport që sot po shqyrtojmë do të kishte kuptim sikur Ndërmarrja “Përparimi” do të themelohej sot, po kjo ndërmarrje është themeluar para dy apo tre viteve. Kjo është kështu sepse në raport është përshkruar vetëm veprimtaria e kësaj ndërmarrje akti i saj i rregullimit të brendshëm, numri i punëtorëve e të ngjashme po kjo nuk i intereson kuvendit. Neve si kuvend na intereson funksionimi i ndërmarrjes, zhvillimi i afarizmit, shpenzimi i buxhetit e gjëra si këto të rëndësishme për zhvillimin e kësaj ndërmarrje. Ky raport voluminoz në faqe, është bërë me qellim që ikin temave kryesore ato të shpenzimit të buxhetit, dhe shtoj se si është blerë kamioni i vjetër 25 vite në kundërshtim me ligjin, duke i përshtatur specifikat saktë dhe duke e blerë kamionin prej të njëjtës kompani që janë blerë lulet, dhe kjo kompani fare nuk ka të bëjë me shitjen e makinerisë, po kjo çështje po dihet se qysh është bërë. Kjo tendencë për kamoflim të situatës, po e detyron grupin kuvendar të LVV-së që të kërkojë qasje në dokumentet zyrtare të Ndërmarrjes “Përparimi”. Në fund tha se ky raport është i pranueshëm dhe nuk do ta votojnë, ndërsa shtoj se i falënderon të gjithë punëtorët e ndërmarrjes për punën që po bëjnë dhe ceku se të njëjtit gjatë punës duhet të kursehen nga fotot dhe ekspozimi i tyre në rrejtët sociale.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-tha se ky raport është i kompletuar dhe mund të thuhet dhe konsiderohet si një punim shkencorë. Komisioni komuna i Aksionarëve të N.P.L. Përparimi, raportin e tij e ka mbështetur në nenin 8 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, në ç’rast e ka zbatuar me përpikëri obligimin ligjor për të raportuar para kuvendit. Tutje ka zbatuar obligimet ligjore që dalin nga neni 16 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike, duke e zgjedhur drejtorët e ndërmarrjes publike, mbikëqyrjen e punës së tyre, caktimin e kompensimit të tyre, caktimin e komisionit të auditimit, caktimin e dy mbikëqyrësve të komisionit të auditimit, aprovimin, plotësimin ndryshimin e rregulloreve të përgatitura nga kryeshefi i ndërmarrjes publike, raportet tremujore, raportet vjetore, raportet për përmbushjen e nevojave të klientëve, vlerësimin e efektshmërisë të bordit të

drejtorëve, zbatimin e detyrave fiduciare, zbatimin e planit të biznesit, zbatimin e planit të shpenzimeve të biznesit si dhe auditorin e jashtëm. Ndërmarrja Lokale “Përparim” këtë tri vite prej se është themeluar falë punës së mirë të kryeshefit ekzekutiv dhe udhëheqjes profesionale, ka zgjeruar dy veprimtari shumë të rëndësishme dhe fitimprurëse siç është njësia për ndriçimin, mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe shërbimet për mbledhjen e mbeturinave. Para realizimit të këtyre veprimtarive, kryeshefi ekzekutiv ka ndërmarr të gjithë hapat ligjor për licencimin e ndërmarrjes sipas rekomandimeve të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës si dhe pajisja me leje mjedisore nga ana DUMM-së. Duke përfshirë ndryshmet dhe hartimin nga komisioni i aksionarëve e më pas nga bordi i drejtorëve ku përfshihet realizimin e të gjitha kontratave për furnizime me mjete të punës, vegla të punës, për pajisje, për materiale të ndryshme, për uniforma me procedura të hapura të pranuar nga komisioni vlerësues dhe të raportuara në E-prokurim, ku secili nga ne mundet të ketë qasje dhe të informohet. Çështja tjetër më rëndësi që duhet të theksohet është se punëtorët përpos pagesë marrin edhe kontributin pensional-trusitn, sigurimin shëndetësor dhe çka është edhe më e rëndësishme, punëtorëve të terrenit iu kompensohen edhe orët shtesë dhe kujdestarinë dhe tani numri i punëtorëve nga 193 është rritur në 295 punëtorë, ku 75 prej tyre janë transferuar nga K.R.M “Uniteti”. Gjëja më e rëndësishme që duhet cekur është se kryeshefi i KRM “Uniteti” në mënyrë të njëanshme e ka bërë shkëputjen e kontratës duke ia ndaluar NPL “Përparimit” zbrazjen e mbeturinave në deponinë e mbeturinave në Germov në fshatin Kushtovë me tendenca për dëmtimin e Komunës së Vushtrrisë, dhe kësaj ka rrezikuar 17,000.00 ekonomi familjare mbi 1300 biznese dhe ka rrezikuar të lërë pa shërbime për pastrimin e mbeturinave për 70,000.00 banorë të Komunës së Vushtrrisë. Kryeshefi ekzekutiv i NPL “Përparimi” ka arritur marrëveshje edhe me 5 deponi tjera të mbeturinave në ç’ rast tani Komuna e Vushtrrisë i zbrazë atje mbeturinat. Marrëveshja e re kontraktuale me deponit tjera financiarisht është më e favorshme ku NPL Përparimi brenda një viti kalendarik i kursen rreth 36,000.00 €. Mandej tek bilanci përfundimtar të hyrat kanë qenë 1,189,114.89 €, shpenzimet 1,100,456.38 €, kurse fitimi 43,384.95 €. Në fund tha se kur diskutojmë dhe kritikojmë nuk duhet të jemi të njëanshëm sepse anëtar i Komisionit të Ndërmarrjes “Uniteti ” që vjen nga radhët LVV-së, ka sjellë para kuvendit një raport skandaloz dhe të cilin ne i kemi refuzuar, për më keq ai ka refuzuar ti përgjigjet kuvendit si organ themelues i atij komisioni, dhe ai nëse nuk e ofron raportin, ai do ti ngritë kallëzim penal.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-pyeti se përse nuk po iu kompensohen shujtat punëtorëve teknik dhe të sigurimit që janë në kuadër të Përparimit e që punojnë nëpër shkolla.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-pasi falënderoj kuvendin për ofrimin e mbështetjes për NPL “Përparimin” sqaroi se kjo ndërmarrje është themeluar në vitin 2021 por që e njëjta në atë kohë nuk ka pasur makineri punuese edhe pse qeverisja e kaluar ka pasur për obligim që këtë ndërmarrje ta bëjë të gatshme për operim. Ai cekur dhe sqaroi se falë mbështetjes nga ana e kryetarit të komunës dhe nga ana e kuvendit, menaxhmenti i ndërmarrjes ka bërë hartimin e planit të biznesit dhe ka zgjeruar gamen e shërbimeve që ofron të cilën e kemi gjetur me vetëm tri shërbime. Si rezultat i këtyre zhvillimeve është bërë ngritja e të hyrave të ndërmarrjes dhe janë ngritur edhe pagat për punëtorët e kësaj ndërmarrje. Aktualisht ndërmarrja është në rrugë të mbarë në zhvillimin e saj të gjithmbarshëm dhe kjo falë edhe mbështetjes nga ana e kryetarit të komunës dhe kuvendit. Ndërmarrja është në drejtim të mbarë që të krijoj një sistem dhe politikë të drejt si dhe stabilitet financiar në zhvillimin e kësaj ndërmarrje.

Qemajl Hasani, anëtar i Komisionit të Aksionarëve- paraqiti sqarimet lidhur me zhvillimin e manaxhimit të Ndërmarrjes Lokale “Përparimi” dhe për politikën e saj zhvillimore, duke shprehur gatishmëri për qasje në dokumentet zyrtare për shpenzimin e parasë publike në këtë kompani.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 12 vota “për” 11 vota “për”, të tjerët nuk morën pjesë në votim, nuk e aprovoj raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. “Përparimi” SH.A, për vitin 2023.

13. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e mbështetjes financiare për Klubin e Hendbollit “Samadrexha” F.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ashtu sikur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, edhe në këtë mbledhje të kuvendit, e përkrahim kërkesën për mbështetje financiare për Klubin e Hendbollit “Samadrexha” F, jemi shumë të kënaqur dhe krenar që ky klub ka korrë rezultate dhe suksese të mira për përfaqësim në gara ndërkombëtare. Prandaj i uroj suksese të mëtejme këtij klubi dhe deklaroi se do ta përkrahin si grup kuvendar këtë kërkesë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se është mirë që po përkrahet ky, klub dhe shtoj se iu uron suksese këtij klubi, po ashtu i vjen shumë mirë që kryetari i komunës e i ka pritur në takim kryesin e klubit. Ai propozon që vlera e mbështetjes financiare për këtë klub të rritet nga 30,000.00 € sa është të bëhet 40,000.00 €, për shkak të kërkesave dhe nevojave të klubi dhe për shkak të rritjes së shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit për klubin që do të ketë në ditë në vijim në gara ndërkombëtare.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se çdo vendim që merret duhet të rishikohet dhe revidohet plani i Drejtorisë së Financave se ku do të merren mjetet financiare.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-deklaroi se nuk merr pjesë në votim sepse konsideron se ka konflikt të interesit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë tri dhjetë mijë euro (30,000.00 €), për Klubin e Hendbollit KHF “Samadrexha” në Vushtrri.

2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit (850) i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Në mungesë të mjeteve në këtë drejtori, do të sigurohen nga njësitë e tjera buxhetore, ku ka mjete të lira.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 17:00

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Datë 19.09.2024

Për: Kuvendin e Komunës

Propozues: z.Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Hartues: z.Isuf Jashari, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Propozim - Vendim: Për aprovimin e Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 1, pika “d” në lidhje me nenin 24, paragrafi 2, nenit 40, paragrafi 2, pika “b” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19.2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 në lidhje me nenin 18 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më _____ **shtator 2024**, merr këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2025 SI DHE PROJEKSIONET PËR VITIN 2025-2027

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2025-2027, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2025 dhe 02/2025 të lëshuara nga MFPT-ja.

2.Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025 është **27,662,762.00 €** prej të cilave për:

2.1 Paga dhe mëditje.....	13,811,153.00 €
2.2 Mallra dhe shërbime.....	6,324,837.00 €
2.3 Shpenzime komunale.....	639,625.00 €
2.4 Subvencione.....	1,855,000.00 €
2.5 Shpenzime kapitale.....	5,032,147.00 €

Gjithsej:..... 27,662,762.00 €

3.Të hyrat vetanake të planifikuara.....3,525,467.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 01/2025 dhe 02/2025 të MFPT-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2025-2027; tabela 4.2 – investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025-2027; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës për vitet 2025-2027, janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesja e kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për zbatim.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke u bazuar në qarkoret buxhetore si dhe standardet dhe instruksionet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka përgatitur draft-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitet 2025-2027, duke i përfillur hapat dhe legjislacionin në fuqi që i referohen financave publike.

Drejtorja ka realizuar dëgjimet buxhetore konform kushteve, duke adresuar nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Nga të cekura më lartë i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që ta aprovoj propozim-vendimin si në dispozitiv.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	19.09.2024
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës  Drejtor Buxhet dhe Financa 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Peropozim buxheti për vitin 2025-2027

Procesi buxhetor 2025-2027 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore të Qeverisë me nevojat ekonomike dhe zhvillimore të Komunës

Gjatë procesit buxhetor së pari i kemi kushtuar kujdes obligimeve kontraktuese dhe nevojave të qytetarëve gjatë ndëgjimeve buxhetore .

Parimet e planifikimit buxhetor për vitin 2025 janë;

1. Burimet e financimit
2. Kategoritë ekonomike
3. Ndarjet buxhetore

Burimet e financimit.- Buxheti i planifikuar për vitin 2025 është 27,662,762.00€ ky buxhet financohet nga grantet qeveritare në shumë 24,137,295.00 € ose 87.26 % si dhe nga të hyrat vetanake në shumë 3,525,467.00 € ose 12.74%

Kategoritë ekonomike.- Me Qarkoren buxhetore 02/2025, shumat e planifikuar për:

Paga dhe mëditje jonë të planifikuara 13,811,153.00 ose 49.93% e shumës së tërësishme .

Mallra dhe shërbime jonë të planifikuara 6,324,837.00 € ose 22.86%

Shpenzimeve komunale e kemi buxhetuar me shumën 639,625.00€ ose 2.31% --

Subvencione dhe transfere për vitin 2025 është 1,855,000.00 € ose 6.70%

Shpenzimet Kapitale për vitin 2025 janë 5,032,147.00€. Këto shpenzime paraqesin pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve dhe marrin pjesë me 18.19% në shpenzimet e tërësishme.

Bashkangjitur kësaj shkrese janë tabelat:

- 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2025-2027,
- 4.2 Investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë dhe
- 4.3 Plani Afatmesem i te hyrave totale

Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2025-2027

		13,811,153	6,324,837	639,625	1,855,000	5,032,147	27,662,762		
Kod.	Kodi i programit /nëprogr amit	Përkrymimi	Stafi 2025	Pagat dhe mëditjet	Malltrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
644		Ndryshimi	1,634	13,811,153.00	6,324,837.00	639,625.00	1,855,000.00	5,032,147.00	27,662,762.00
		TOTAL SHPENZIMET		13,811,153.00	6,324,837.00	639,625.00	1,855,000.00	5,032,147.00	27,662,762.00
		Grantet Qeveritare		13,751,153.00	4,556,165.00	572,750.00	1,375,000.00	3,882,227.00	24,137,295.00
		Të hyrat vetanake		60,000.00	1,768,672.00	66,875.00	480,000.00	1,149,920.00	3,525,467.00
	16024	Zyra e Kryetarit	23	230,000.00	191,000.00	-	50,000.00	-	471,000.00
		Grantet Qeveritare		230,000.00	150,000.00	-	40,000.00	-	420,000.00
		Të hyrat vetanake		-	41,000.00	-	10,000.00	-	51,000.00
	16924	Zyra e Kuvendit Komunal	22	280,000.00	20,000.00	-	-	-	300,000.00
		Grantet Qeveritare	22	280,000.00	5,000.00	-	-	-	285,000.00
		Të hyrat vetanake		-	15,000.00	-	-	-	15,000.00
1.3	163	Administrata dhe personeli	30	240,338.00	303,000.00	-	-	5,000.00	548,338.00
		Grantet Qeveritare		240,338.00	201,000.00	-	-	4,000.00	445,338.00
		Të hyrat vetanake		-	102,000.00	-	-	1,000.00	103,000.00
1.3.1	16324	Administrata	28	225,000.00	300,000.00	-	-	-	530,000.00
		Grantet Qeveritare		225,000.00	200,000.00	-	-	4,000.00	429,000.00
		Të hyrat vetanake		-	100,000.00	-	-	1,000.00	101,000.00
1.3.6	16524	Çështjet gjinore	2	15,338.00	3,000.00	-	-	-	18,338.00
		Grantet Qeveritare		15,338.00	1,000.00	-	-	-	16,338.00
		Të hyrat vetanake		-	2,000.00	-	-	-	2,000.00
	16647	Inspektimet	15	150,000.00	30,440.00	-	-	-	180,440.00
		Grantet Qeveritare		150,000.00	10,440.00	-	-	-	160,440.00
		Të hyrat vetanake		-	20,000.00	-	-	-	20,000.00
	16820	Prokurimi	7	67,000.00	6,000.00	-	-	-	73,000.00
		Grantet Qeveritare		67,000.00	2,000.00	-	-	-	69,000.00
		Të hyrat vetanake		-	4,000.00	-	-	-	4,000.00
	17524	Buxhjetimi	27	205,000.00	20,000.00	-	-	-	225,000.00
		Grantet Qeveritare		205,000.00	10,000.00	-	-	-	215,000.00
		Të hyrat vetanake		-	10,000.00	-	-	-	10,000.00

1.7	180	Shërbimet publike, mbrojtja	48	402,000.00	3,004,009.00	343,975.00	100,000.00	726,000.00	4,575,984.00
		Grantet Qeveritare		402,000.00	2,005,346.00	300,000.00	80,000.00	458,000.00	3,153,550.00
		Të hyrat vetanake		-	998,663.00	43,975.00	20,000.00	268,000.00	1,422,434.00
1.7.1	18184	Infrastruktura Publike	13	100,000.00	2,443,550.00	343,975.00	100,000.00	726,000.00	3,713,525.00
		Grantet Qeveritare		100,000.00	1,543,550.00	300,000.00	80,000.00	458,000.00	2,481,550.00
		Të hyrat vetanake			900,000.00	43,975.00	20,000.00	268,000.00	1,231,975.00
1.7.6	18428	Zjarrfiksat dhe inspektimet	31	260,000.00	70,459.00	-	-	-	330,459.00
		Grantet Qeveritare		260,000.00	30,000.00				290,000.00
		Të hyrat vetanake			40,459.00				40,459.00
1.7.7	18468	Menaxhimi i katastrofave Nat	4	42,000.00	490,000.00	-	-	-	532,000.00
		Grantet Qeveritare		42,000.00	340,000.00				382,000.00
		Të hyrat vetanake			150,000.00				150,000.00
		Zyra komunale për komunitet	9	65,000.00	5,000.00	35,000.00	-	-	105,000.00
		Grantet Qeveritare		65,000.00	1,500.00	30,000.00			96,500.00
		Të hyrat vetanake			3,500.00	5,000.00			8,500.00
		Bujëesia	7	98,000.00	30,000.00	-	805,000.00	1,335,330.00	2,268,330.00
		Grantet Qeveritare		98,000.00	5,000.00		605,000.00	1,094,332.00	1,802,332.00
		Të hyrat vetanake			25,000.00		200,000.00	240,998.00	465,998.00
		Zyra komunale për komunitet	9	65,000.00	5,000.00	35,000.00	-	-	105,000.00
		Grantet Qeveritare		65,000.00	1,500.00	30,000.00			96,500.00
		Të hyrat vetanake			3,500.00	5,000.00			8,500.00
		Shërbimet kadastrale	13	95,000.00	15,000.00	-	-	-	110,000.00
		Grantet Qeveritare		95,000.00	10,000.00				105,000.00
		Të hyrat vetanake			5,000.00				5,000.00
		Planifikimi urban dhe inspeksi	9	99,000.00	400,000.00	-	-	1,834,560.00	2,333,560.00
		Grantet Qeveritare		99,000.00	220,000.00			1,448,779.00	1,767,779.00
		Të hyrat vetanake			180,000.00			385,781.00	565,781.00
1.15	730	Shëndëtesia dhe mirëqenia	244	2,149,786.00	709,348.00	73,750.00	450,000.00	144,858.00	3,357,233.00
		Grantet Qeveritare		2,117,786.00	656,839.00	72,750.00	350,000.00	144,858.00	3,357,233.00
		Të hyrat vetanake		32,000.00	52,509.00	-	100,000.00	-	184,509.00
1.15.1	73033	Administrata	5	49,000.00	3,509.00	-	350,000.00	-	402,509.00
		Grantet Qeveritare		49,000.00	1,000.00		250,000.00		300,000.00
		Të hyrat vetanake			2,509.00		100,000.00		102,509.00
1.15.2	74450	SH.K.P.SHI	215	1,905,786.00	586,214.00	57,750.00	100,000.00	144,858.00	2,794,608.00
		Grantet Qeveritare		1,873,786.00	556,214.00	57,750.00	100,000.00	144,858.00	2,732,608.00
		Të hyrat vetanake		32,000.00	30,000.00				62,000.00

1.15.4	75616	Sherbimet Sociale	13	95,000.00	44,625.00	6,000.00	-	-	145,625.00
		Grantet Qeveritare		95,000.00	24,625.00	5,000.00			124,625.00
		Te hyrat vetanake			20,000.00	1,000.00			21,000.00
1.15.4	75617	Sherbimet Rezidenciale	11	100,000.00	75,000.00	10,000.00	-	15,000.00	200,000.00
		Grantet Qeveritare		100,000.00	75,000.00	10,000.00		15,000.00	200,000.00
		Te hyrat vetanake							
	85024	Sherbimet kulturore	31	246,000.00	70,000.00	-	200,000.00	248,141.00	764,141.00
		Grantet Qeveritare		246,000.00	40,000.00		150,000.00	165,000.00	601,000.00
		Te hyrat vetanake			30,000.00		50,000.00	83,141.00	163,141.00
1.18	920	Arsimi dhe shkenca	1,140	9,484,029.00	1,521,040.00	187,900.00	250,000.00	723,258.00	12,166,227.00
		Grantet Qeveritare		9,456,029.00	1,239,040.00	170,000.00	150,000.00	552,258.00	11,567,327.00
		Te hyrat vetanake		28,000.00	282,000.00	17,900.00	100,000.00	171,000.00	598,900.00
1.18.1	92120	Administrata	12	101,115.00	853,000.00	187,900.00	250,000.00	-	1,392,015.00
		Grantet Qeveritare		101,115.00	653,000.00	170,000.00	150,000.00		1,074,115.00
		Te hyrat vetanake			200,000.00	17,900.00	100,000.00		317,900.00
1.18.2	92670	Arsimi Parashkollor dhe qerdh	67	473,112.00	100,000.00	-	-	-	573,112.00
		Grantet Qeveritare		473,112.00	30,000.00				503,112.00
		Te hyrat vetanake			70,000.00				70,000.00
1.18.3	93690	Arsimi Filior	861	6,966,649.00	336,388.00	-	-	723,258.00	8,026,295.00
		Grantet Qeveritare		6,966,649.00	336,388.00			552,258.00	7,855,295.00
		Te hyrat vetanake						171,000.00	171,000.00
1.18.4	94890	Arsimi i mesëm	200	1,943,153.00	231,652.00	-	-	-	2,174,805.00
		Grantet Qeveritare		1,915,153.00	219,652.00				2,134,805.00
		Te hyrat vetanake		28,000.00	12,000.00				40,000.00

Ferit Idrizi Kryetar i Komunës



Drejtori për Buxhet dhe Financa



Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2025-2027

Nr.	Kodi i Projektit	Emri i projektit	2025				2026	2027	TOTALI 2025-2027
			Granti	THV	TOTALI				
			3,882,227.00	1,149,920.00	5,032,147.00	5,363,202.00	5,645,366.00		
		Administrata dhe personeli	4,000.00	1,000.00	5,000.00	-	-	5,000.00	
		Administrata	4,000.00	1,000.00	5,000.00	-	-	5,000.00	
1		Rehabilitimi i kulmit të Komunës	4,000.00	1,000.00	5,000.00			5,000.00	
		Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	458,000.00	268,000.00	726,000.00	1,250,000.00	1,630,000.00	3,606,000.00	
		Infrastruktura publike	458,000.00	268,000.00	726,000.00	1,250,000.00	1,630,000.00	3,606,000.00	
1	53220	Ndërtimi i kanalizimit në Stanoc të Epërm -Stanoc të Poshtëm	15,000.00	5,000.00	20,000.00	40,000.00		60,000.00	
2	53231	Ndërtimi i kanalizimit në Akrahticë -Balincë	10,000.00	5,000.00	15,000.00	40,000.00		55,000.00	
3		Ndërtimi i kanalizimit Druar	15,000.00	15,000.00	30,000.00	15,000.00		45,000.00	
4	53603	Ndërtimi i kanalizimit në Kollë	10,000.00	5,000.00	15,000.00	10,000.00		25,000.00	
5		Kanalizimi Banjskë	10,000.00	5,000.00	15,000.00	40,000.00		55,000.00	
6	53226	Ndërtimi i kanalizimit në Mihalij	20,000.00	5,000.00	25,000.00	35,000.00		60,000.00	
7		Ndërtimi i kanalizimit Shalle	10,000.00	5,000.00	15,000.00	10,000.00		25,000.00	
8	53259	Ndërtimi i kanalizimit në Panitinë-Oshlan	15,000.00	10,000.00	25,000.00	25,000.00		50,000.00	
9	53193	Ndërtimi i kanalizimit në Gojbulë	10,000.00	5,000.00	15,000.00	15,000.00		30,000.00	
10	53182	Ndërtimi i kanalizimit në Pestovë	10,000.00	10,000.00	20,000.00			20,000.00	
11	51819	Ndërtimi i kanalizimeve në Vushtri, Smadrexhë, Maxhunaj, Stanoc				130,000.00	280,000.00	410,000.00	
12		Ndërtimi urës në Miraqë me murë mbrojtëse	10,000.00	2,000.00	12,000.00			12,000.00	
13		Ndërtimi urës në Akrahticë	7,000.00	2,000.00	9,000.00			9,000.00	
14		Ndërtimi urës në Dobërlukë	2,000.00	3,000.00	5,000.00			5,000.00	
15		Ndërtimi urës në Lummadh,Maxhunaj	7,000.00	8,000.00	15,000.00	150,000.00	250,000.00	415,000.00	
16		Ndërtimi urës në Karaqë	7,000.00	3,000.00	10,000.00			10,000.00	
17		Ndërtimi i shtëpisë për komunitetin-Oshlan	20,000.00	10,000.00	30,000.00			30,000.00	
18		Ndërtimi i parkut rekreativ tek banesat e bardha dhe banesat e reja lagjia"Ura e vjeter e Gurit"	20,000.00	10,000.00	30,000.00			30,000.00	
19		Vazhdimi i vigul Novolan Vigu I shtetiores	20,000.00	20,000.00	40,000.00			40,000.00	
20	54942	Rregullimi i lumit "Tërstena-Silnica" vazhdim	20,000.00	20,000.00	40,000.00	40,000.00		80,000.00	
21		Ndërtimi pikat pritëse-Vushtri	20,000.00	20,000.00	40,000.00			40,000.00	
22	54946	Ndërtimi i stacionit të pompimit, rrjetit primar rezervuareve të ujit, në pjesën lindore të Vushtrrisë	200,000.00	100,000.00	300,000.00	700,000.00	1,100,000.00	2,100,000.00	
		Zjarrëfikësit dhe inspeksioni	-	-	-	-	-	-	
		Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural	1,094,332.00	240,998.00	1,335,330.00	2,842,698.00	2,045,000.00	6,223,028.00	
		Bujqësia	1,094,332.00	240,998.00	1,335,330.00	2,842,698.00	2,045,000.00	6,223,028.00	
1	52290	Rregullimi dhe pastrimi i lumit Lap - Silnica	74,332.00	100,000.00	174,332.00	400,000.00		574,332.00	
2		Rregullimi dhe pastrimi i lumit "Silnica" Vushtri- Sm	20,000.00	20,000.00	40,000.00	600,000.00	1,300,000.00	1,940,000.00	
3	49561	Projektet në bashkëfinancim me donatorë	1,000,000.00	120,998.00	1,120,998.00	1,842,698.00	745,000.00	3,708,696.00	
		Planifikimi urban dhe mjedisi	1,448,779.00	385,781.00	1,834,560.00	905,504.00	1,665,366.00	4,405,430.00	
		Planifikimi mjedisor dhe inspektimet	1,448,779.00	385,781.00	1,834,560.00	905,504.00	1,665,366.00	4,405,430.00	
1	53207	Ndërtimi i rr. "Bekimi Berisha - Abeja"	50,000.00	25,000.00	75,000.00			75,000.00	
2	53262	Ndërtimi i rr. "Avni Saraçi" -Viciana	40,000.00	23,772.00	63,772.00			63,772.00	
3	53276	Ndërtimi i rr. "Lumni Surdull"	40,000.00	20,000.00	60,000.00	15,504.00		75,504.00	
4	53283	Ndërtimi i rr. "2 Maji" me infrastrukturë përcjellëse	70,000.00	30,000.00	100,000.00	400,000.00	800,000.00	1,300,000.00	
5	53344	Rikonstruimi i bulevardit "Ademi Jashari" dhe lidhja me parkun e qytetit	1,024,102.00	96,009.00	1,120,111.00	300,000.00		1,420,111.00	
6	53274	Rregullimi i rr. "Isak Halili" me infrastrukturë përcjellëse	30,000.00	20,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00	250,000.00	
7		Ndërtimi i rrugës Sfaracak të varrezat	30,000.00	30,000.00	60,000.00	14,000.00	113,000.00	187,000.00	
8		Ndërtimi i rrugësVesekoc - Sllakoc segmenti 3	30,000.00	20,000.00	50,000.00			50,000.00	
9	54750	Rehabilitimi i rrugëve në Verrnicë-Shalle, Akrahticë, Bukosh, Dolak,	20,000.00	5,000.00	25,000.00	30,000.00	348,000.00	403,000.00	
10	54775	Rehabilitimi i rrugëve në Bivolak, Zhilivodë, Stroc	5,000.00	20,000.00	25,000.00	30,000.00		55,000.00	
11	54798	Ndërtimi i rrugëve lokale në Dunnicë, Maxhunaj, Stanoc, Lummadh, Vilanc, Ropicë, Pestovë	5,000.00	20,000.00	25,000.00	30,000.00	70,366.00	125,366.00	
12	54799	Ndërtimi i rrugëve lokale në Graçë, Prelluzhë	20,000.00	30,000.00	50,000.00			50,000.00	
13	54801	Ndërtimi i rrugëve lokale në Studime e Ulët, Ceceli, Samadrexhë, Sfaracak	5,000.00	5,000.00	10,000.00			10,000.00	
14	54808	Ndërtimi i rrugëve lokale në Bajnskë, Pasomë, Sllatinë, Begaj, Smrekonicë	50,000.00		50,000.00	36,000.00	181,000.00	270,000.00	
15	54812	Ndërtimi i rrugëve lokale në Shtitaricë, Pantinë, Hereçgovë, Akrahticë	10,677.00	10,000.00	20,677.00			20,677.00	

16	54814	Ndërtimi i rrugëve lokale në Bukosh, Dolak, Novolan	3,000.00	7,000.00	10,000.00			10,000.00
17	54819	Ndërtimi i rrugëve lokale në Druar, Mihalliq, Reznik, Shalle	3,000.00	7,000.00	10,000.00			10,000.00
18	54820	Ndërtimi i rrugëve lokale në Stroc, Beçuk, Gllavotin, Bivolak, Zhilivodë	3,000.00	7,000.00	10,000.00			10,000.00
19	54834	Ndërtimi i rrugëve lokale në Beçiq, Duboc	5,000.00	5,000.00	10,000.00			10,000.00
20	54843	Ndërtimi i rrugëve lokale në Skoqne	5,000.00	5,000.00	10,000.00			10,000.00
		Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	159,858.00	-	159,858.00			159,858.00
		Shërbimet e shëndetësisë primare	144,858.00	-	144,858.00			144,858.00
1		Inventar për Stomatologji	5,000.00		5,000.00			5,000.00
2		Inventar mjekësor	15,000.00		15,000.00			15,000.00
3		Pajisje mjekësore	40,000.00		40,000.00			40,000.00
4		Klima-Inverter	15,000.00		15,000.00			15,000.00
5		Ndërtimi i radiologjisë	69,858.00		69,858.00			69,858.00
		Shërbimet rezidenciale	15,000.00	-	15,000.00			15,000.00
1		Blerja e veturës	15,000.00		15,000.00			15,000.00
		Kultura, rinia dhe sportet	165,000.00	83,141.00	248,141.00	125,000.00	125,000.00	498,141.00
		Shërbimet kulturore	165,000.00	83,141.00	248,141.00	125,000.00	125,000.00	498,141.00
1	52825	Restaurimi dhe konservimi i objektit "Arkivi i vjetër" ish fabrika e vajit	70,000.00	24,141.00	94,141.00			94,141.00
2	54735	Ndërtimi/rikonstruimi i fushave sportive Maxhunaj, Lummadh, Stanoc, Reznik, Pestovë, Doberllukë, Pantinë, Shtitariçë, Novolan, Druar, Samadrexhë, Beçiq dhe Bruznik	30,000.00	20,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00
3	54727	Rregullimi i memorialeve në Gllavotin, Reznik, Beçiq, Duboc, Galicë, Pantinë, Studime, Zhilivodë, Pasomë	50,000.00	29,000.00	79,000.00	50,000.00	50,000.00	179,000.00
4		Memoriali Pasome	15,000.00	10,000.00	25,000.00	25,000.00	25,000.00	75,000.00
		Arsimi dhe shkencë	552,258.00	171,000.00	723,258.00	240,000.00	180,000.00	1,143,258.00
		Arsimi fillor	552,258.00	171,000.00	723,258.00	240,000.00	180,000.00	1,143,258.00
1	53024	Ndërtimi i shkollës fillore "Mustafa Venhari"	438,258.00	100,000.00	538,258.00	100,000.00		638,258.00
		Ndërtimi i qerdhes në SHFMU "Enver Hadri", Smrekonicë	25,000.00	15,000.00	40,000.00	70,000.00	90,000.00	200,000.00
		Ndërtimi i qerdhes në SHFMU "7 Marsi", Bukosh	20,000.00	20,000.00	40,000.00	70,000.00	90,000.00	200,000.00
		Inventar për shkollën "A.Z. Çajupi"	15,000.00	10,000.00	25,000.00			25,000.00
		Inventar për shkollën "Mustafë Venhari"	15,000.00	15,000.00	30,000.00			30,000.00
		Tabela SMART për SHMU - I	10,000.00	6,000.00	16,000.00			16,000.00
		Tabela SMART për SHFMU "A.Z. Çajupi"	7,000.00	5,000.00	12,000.00			12,000.00
		Tabela SMART për gjimnazin "Eqrem Çabej"	22,000.00		22,000.00			22,000.00

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunes



Drejtori për Buxhet dhe Financa




Komuna: Vushtrri	THV - 2025	THV - 2026	THV - 2027
Buxhet dhe Financa	1,233,427.00	1,369,647.00	1,506,957.00
Taksat e firmave	15,000.00	15,000.00	15,000.00
Tatimi në pronë	975,307.00	1,070,296.00	1,147,892.00
Tatimi në toka	243,120.00	284,351.00	344,065.00
Inspektimet	14,000.00	15,000.00	13,000.00
Pranime teknike	8,000.00	8,500.00	6,000.00
Gjjobat e inspektionit	6,000.00	6,500.00	7,000.00
Administrata	120,000.00	130,000.00	135,000.00
Shërbimet administrative	120,000.00	130,000.00	135,000.00
Urbanizmi	782,540.00	836,392.00	887,385.00
Lejet për ndërtim dhe konstruktive	632,540.00	670,392.00	710,885.00
Leje mjedisore	100,000.00	110,000.00	115,000.00
Legalizim	25,000.00	26,000.00	26,500.00
Shfrytëzimi i pronës publike	25,000.00	30,000.00	35,000.00
Gjeodezi dhe kadastër	153,000.00	158,000.00	160,000.00
Hipoteka, RDDP, dalje në terren	100,000.00	100,000.00	100,000.00
Qiraja e pronave publike	53,000.00	58,000.00	60,000.00
Ekonomi dhe bujqësi	50,000.00	50,000.00	55,000.00
Ndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore	50,000.00	50,000.00	55,000.00
Kulturë, rini, sport	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Palestra sportive	500.00	500.00	500.00
Bibliotekat	500.00	500.00	500.00
Shtëpia e kulturës	500.00	500.00	500.00
Shërbimet publike	999,000.00	1,037,500.00	1,085,127.00
Ndalja e veturave në rrugë	3,000.00	3,000.00	4,000.00
Taksat rrugore	150,000.00	152,000.00	155,000.00
Taksa për mbeturina	846,000.00	882,500.00	926,127.00
Totali i Administratës komunale	3,353,467.00	3,598,039.00	3,843,969.00
ARSIMI			
Çerdhet	70,000.00	72,000.00	73,000.00
Mësimi joformal SHMP "Bahri Haxha"	20,000.00	21,000.00	22,000.00
Mësimi joformal SHMT "Lutfi Musiqi"	20,000.00	22,000.00	24,500.00
Totali - Arsimi	110,000.00	115,000.00	119,500.00
TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA			
Shëndetësia primare	60,000.00	62,000.00	70,000.00
Shërbimet sociale	2,000.00	2,000.00	2,000.00
TOTALI SHËNDETËSI	62,000.00	64,000.00	72,000.00
TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I+II+III)	3,525,467.00	3,777,039.00	4,035,469.00

zi, Kryetar i Komunës



Drejtori për Buxhet dhe Financa





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



R A P O R T

**PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE PËR MUAJT JANAR-QERSHOR 2024**

Shtator 2024

Në raportin për situatën ekonomike financiare, realizimin e planeve investuese, për gjashtëmujorin e parë 2024 është paraqitur puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës, përkatësisht ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave, përgjegjësive të tyre të përcaktuara me ligj, akte nënligjore, Statutin e komunës, si dhe planin punës së Kryetarit – ekzekutivit të komunës. Në raport është paraqitur e gjithë puna e cila është bërë në të gjitha fushat përmes drejtorive, përkatësisht sektorëve në kuadër të administratës komunale duke përfshirë edhe fushën e arsimit shëndetësisë etj.

Të arriturat në këtë gjashtëmujor:

Arsimi:

Arsimi e rina, pa dyshim mbeten top prioritetet e qeverisjes sonë, me një arsim cilësor, ku e ardhmja e gjeneratave të reja është e ndritur. Janë organizuar nëpër shkolla gara të diturisë, që do të ndikojnë drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në mësim nxënie. Këto gara tash po mbahen të gjitha në platforma digjitale online.

Është rritur në vazhdimësi çdo vit numri i bursave për studentët, vlera e bursave nga 400 sa ka qenë, e kemi rritur në 600 euro për studentë që studiojnë në Kosovë, 800 për studentë që studiojnë në vendet e rajonit dhe 1000 në vendet e BE-së. Janë ndarë gjithsej 87 bursa për studentët vushtrias.

Arsimi profesional, përben një nga punët me të mëdha që kemi bërë si qeveri, kemi filluar me mësim dual, ku nxënësit nga vendi i punës po marrin Arsim, Aftësim dhe Punësim.

Për të gjithë të rinjtë dhe të rejat, të interesuarit për aftësim profesional, kemi nxjerrë vendim për mbulimin 100% të shpenzimeve në 11 profile profesionale në qendrën Gjermane “Diakonie Training Center” në Mitrovicë në këto profile:

- 1.1 Rrobaqepësi;
- 1.2 Parukeri;
- 1.3 Qeramikë - punues;
- 1.4 Instalues i ngrohjes qendrore;
- 1.5 Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit;
- 1.6 Instalues elektrik;
- 1.7 Knauf, fasadë dhe ngjyrosje;
- 1.8 Make up/grim;
- 1.9 Konstrukcione druri (mobileri);
- 1.10 Berber.
- 1.11 Kuzhinier

(Vitin e kaluar 2023, kemi subvencionuar 37 të rinj në shumën prej 9,100.00 euro që kanë përfunduar me sukses aftësimin profesional në Diakonie Training Center).

Pastaj subvencionimi i shkathtësive të buta dhe mësimi i gjuhëve të huaja - Subvencionimi deri në 100 euro për ata që ndjekin kurset për gjuhë gjermane apo frënge në SPEEEX Education apo edhe në qendra të tjera. (Vitin e kaluar 2023, kemi subvencionuar 1219 të rinj në shumën prej 127,060.00 euro që kanë ndjekur trajnimet në SPEEEX Education dhe qendra tjera).

Është në fazën e ndërtimit objekti i shkollës moderne “Mustafë Venhrari” ku do të krijohen kushte më të mira për nxënësit e mësimdhënësit, në vlerë prej rreth 1.1 milionë euro.

Është nënshkruar marrëveshja me “York University”, për ndarjen e 10 bursave studimi për vitin akademik 2024/2025, e që përfshin drejtime shumë të rëndësishme.

Kemi mbështetur me bileta të udhëtimit nxënëset e Gjinnazit “Eqrem Çabej” për pjesëmarrje në një hulumtim shkencor në SHBA.

Shërbime Publike dhe Urbanizëm

Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, krijimi i hapësirave të gjelbra.

Rëndësi i kemi kushtuar edhe infrastrukturës moderne, ku në qytet e fshatra janë duke u ndërtuar rrugë për lehtësimin e qarkullimit për qytetarët tanë.

Në qytet po i përmendim disa projekte që janë të një rëndësie të veçantë, të gjitha arterie shumë të fuqishme, ku përveç zgjerimit të rrugëve, po ndërtohen hapësira për këmbësor, shtigje për biçikleta, krejt këto me qëllim të krijimit të një infrastrukture moderne, e sigurisë në komunikacion.

Rrugët: “Avni Saraçi”, “Bekim Berisha-Abeja”, “Lumni Surdulli”, rruga “Drenica”, rruga tashme e përfunduar “Pestove- Druar” ku kjo rrugë ka lehtësuar në masë të madhe qarkullimin për qytetarë, dhe ka lidhur pjesën e Artakollit me magjistralen Prishtinë- Mitrovicë.

Ndërtimi i parkut rekreativ “Udha e Gurit”, ku përfshin, rrugën me kubëza, ndërtimin e fushës së basketbollit, dhe ndërtimin e fushave multifunksionale, shteg për vrapim, ku do të jenë në shërbim të të gjithë qytetarëve.

Kryevepra e Vushtrisë, parkingu nëntokësor për 100 vetura, së bashku me Rikonstruimin e Bulevardit “Adem Jashari” ku do të behet një bulevard modern, me amfiteatro, fontana, hapësira të gjelbra, e hapësira të mjaftueshme për qytetarë.

Tregu i gjelbër për prodhuesit vendor, po ashtu me parking nëntokësor për 30 vetura, ku do të krijohen kushte të dinjitetshme për të gjithë prodhuesit vendor, dhe qytetarët do ta kenë një treg modern për ta frekuentuar.

Rregullimi i shëtitores “Enver Zymberi”, me ulëse, shporta për mbeturina, ndriçim.

Rregullimi i shëtitores në lumin Podranqa”, e pajisur me ndriçim modern dhe shteg për ecje e biçikleta.

Ndërtimi i urave në fshatrat Akrashticë, Duboc, Smrekonicë dhe Studime e Epërme.

Rregullimi i Kompleksit në fshatin Studime të Epërme.

Nedakoc-kolektori kryesor, **Studime**-kolektori kryesor, **Reznik**-shtrirja e rrjetit të kanalizimit, **Beçuk**-shtrirja e rrjetit të kanalizimit, **Zhilivodë**-shtrirja e rrjetit të kanalizimit, **Stroc**- shtrirja e rrjetit të kanalizimit, **Mihaliq**-shtrirja e rrjetit të kanalizimit

- 606 kontejnerë në vlerën 35,957.20 euro, si komunë përfituese e Grantit të Performancës për Mjedis të Pastër në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

BUJQËSI:

Në bujqësi kemi bërë ndarjen e subvencioneve në mënyrën më të mirë të mundshme, pa as edhe një vërejtje.

-273 serra

-subvencionimin me 0.5 cent per liter qumesht

-4 euro për koke dele/dhi

-4 euro për koshere blete

-100 euro për koke buallice

Marrëveshje bashkëfinancimi me IADK për realizimin e projektit “Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet

aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit”. Do të ndahen grante të vogla në sektorin e përpunimit të frutave, perimeve, ëmbëlsirave apo produkteve të qumështit.

Marrëveshje bashkëfinancimi me Ibër Lepenc, për subvencionimin me 50% të shpenzimeve për ujitjen e tokave bujqësore.

Shëndetësi:

- Renovimi i tërësishëm i Qendrës së Mjekësisë Familjare-1

Administratë:

Ofrimi pa pagesë i të gjitha llojeve të certifikatave për përdorim brenda Republikës së Kosovës

Ofrimi i lehtësirave administrative për diasporën, kemi punuar të shtunën dhe kemi ofruar parkingje pa pagesë.

Pastrimi dhe zgjerimi i shtretërve të të gjithë lumenjve, përrockave, ku qyteti ynë shpëtoi me dëme minimale nga vërshimet që preken disa qytete të Kosovës, ndër to Mitrovicë e Skenderaj, ku falë punës së vazhdueshme nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim kemi shpëtuar qytetin nga vërshimet.

Po ashtu, është bërë edhe hapja e kanaleve kulluese dhe kanaleve të reshjeve atmosferike.

Në fshatin Smrekonicë, është bërë rregullimi i shtratit të lumit ku është bërë pastrimi, zgjerimi, betonimi dhe murosja e shtratit të lumit.

Në vijim të këtij raporti do të i paraqesim në mënyrë të detajuar punët që janë kryer në secilën drejtori përkatësisht sektorë gjatë këtij gjashtëmujori.

Buxheti dhe Financat

Planifikimi i buxhetit për periudhën Janar-Qershor 2024

• Paga dhe mëditje.....	7,914,880.54€
• Mallra dhe shërbime.....	3,130,791.21€
• Shpenzime Komunale.....	269,351.89€
• Subvencione dhe transfero.....	614,296.00€
• Investime kapitale.....	3,327,204.79€
Totali i buxhetit	15,256,524.43€

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE

PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE			
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti I planifikuar për 2024	Buxheti I mbetur për 2024	Plani I reviduar 2024	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar
		4	5	6=5/4*100	7	8=7-5	9	10=7-9
		€	€	%	€	€	€	€
Paga dhe mëditje	111	7,914,880.54	7,847,067.69	99%	13,242,030.85	5,394,963.16	0.00	13,242,030.85
Mallra dhe shërbime	130	3,130,791.21	2,600,289.77	83%	5,120,737.49	2,520,447.72	0.00	5,120,737.49
Shpenzimet komunale	132	269,351.89	251,849.98	94%	580,268.14	328,418.16	0.00	580,268.14
Subvencionet dhe transfere	200	614,296.00	587,774.87	96%	1,238,679.78	650,904.91	0.00	1,238,679.78
Investimet kapitale	300	3,327,204.79	2,374,908.76	71%	8,176,845.45	5,801,936.69	0.00	8,176,845.45
TOTALI		15,256,524.43	13,661,891.07	90%	28,358,561.71	14,696,670.64	0.00	28,358,561.71

Sqarim: Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive të larta të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike është si vijon:

Kategoria e Pagave dhe mëditje për periudhën Janar-Qershor 2024, planifikimi është 7,914,880.54euro, Realizimi është 7,847,067.69eur, përqindja e realizimit 99%

Kategoria Mallra dhe shërbime për periudhën Janar-Qershor 2024, planifikimi është 3,130,791.21euro, Realizimi I shpenzimit shuma 2,600,289.77euro, shprehur në përqindje realizimi është 83%

Kategoria Shpenzimet komunale për periudhën Janar-Qershor 2024, planifikimi është 269,351.89euro, Realizimi I shpenzimit shuma 251,849.98euro, shprehur në përqindje realizimi është 94%

Kategoria Subvencionet dhe transferet për periudhën Janar-Qershor 2024, planifikimi është 614,296.00euro, Realizimi I shpenzimit shuma 587,774.87euro, shprehur në përqindje realizimi është 96%

Kategoria Investimet kapitale periudhën Janar-Qershor 2024, planifikimi është 3,327,204.79euro, Realizimi I shpenzimit shuma 2,374,908.76euro, shprehur në përqindje realizimi është 71%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE			
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2024	Buxheti i mbetur për 2024	Plani I reviduar 2024	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar
		€	€	%	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	255,880.63	222,522.69	87%	520,980.69	298,458.00	0.00	520,980.69
Administrata dhe personeli	163	229,203.71	212,220.21	93%	553,514.91	341,294.70	0.00	553,514.91
Inspektimet	166	80,137.82	73,533.82	92%	147,671.00	74,137.18	0.00	147,671.00
Prokurimi	167	27,148.02	26,963.02	99%	58,409.99	31,446.97	0.00	58,409.99
Zyra e Kuvendit Komunal	169	133,101.94	128,287.64	96%	261,893.01	133,605.37	0.00	261,893.01
Buxheti dhe financat	175	97,354.46	95,652.81	98%	215,440.65	119,787.84	0.00	215,440.65
Shërbimet rurale, Mbrojtja civile dhe emergjenca	180	2,679,850.03	2,427,494.88	91%	5,430,781.73	3,003,286.85	0.00	5,430,781.73
Zyra lokale e komuniteteve	195	30,567.56	28,485.70	93%	83,750.85	55,265.15	0.00	83,750.85
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	684,424.59	492,782.32	72%	1,030,492.45	537,710.13	0.00	1,030,492.45
Gjeodezi dhe Kadastër	650	43,477.12	42,376.62	97%	95,581.50	53,204.88	0.00	95,581.50
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,612,625.49	1,183,380.70	73%	3,606,268.25	2,422,887.55	0.00	3,606,268.25
Shëndetësia primare	730	1,408,283.25	1,331,705.59	95%	3,533,045.36	2,201,339.77	0.00	3,533,045.36
Shërbimet sociale rezidenciale		145,709.23	133,173.56	91%	341,604.67	208,431.11	0.00	
Kulturë, rinl, sport	850	221,747.70	209,272.16	94%	657,707.40	448,435.24	0.00	657,707.40
Arsimi	920	7,607,012.88	7,054,039.35	93%	11,821,419.25	4,767,379.90	0.00	11,821,419.25
TOTALI		15,256,524.43	13,661,891.07	90%	28,358,561.71	14,696,670.64	0.00	28,358,561.71

Përmbledhja e shpenzimeve buxhetore sipas drejtorive është si vijon:

Buxheti i planifikuar sipas programeve dhe kodeve buxhetore është.....15,256,524.43€

Buxheti i realizuar(Shpenzuar), sipas programeve dhe kodeve buxhetore është.....13,661,891.07€

Periudha raportue Janar - Qershor 2024

KK	VUSHTRI	RAPORTI MUJOR I TE HYRAVE VETANAKE					2024	
		JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
1	Admin.	4,699.00	3,025.00	1,894.00	2,089.00	1,939.00	1,965.00	15,611.00
2	Nrrim emri	289.00	277.00	420.00	200.00	390.00	300.00	1,876.00
4	Taksat e frr	-	5,250.00	4,500.00	5,250.00	1,500.00	1,500.00	18,000.00
5	tatimi ne p	32,734.50	38,924.30	44,633.61	163,679.05	68,579.61	21,797.94	370,349.01
								-
7	Participimi	8,724.00	9,209.00	11,291.00	11,593.00	11,241.00	10,816.00	62,874.00
8	Shkolla SHN	1,707.00	3,400.00	8,000.00	950.00	1,592.00	830.00	16,479.00
9	Shkolla SHN	450.00	800.00	7,315.00	1,500.00	300.00	150.00	10,515.00
10	Shtjja.prod	-	-	-	-	-	-	-
11								-
12	RDPP	7,199.00	8,074.00	8,780.00	6,663.00	7,824.00	8,387.00	46,927.00
16	Qiraj nga of		-	-	1,472.55	-	4,618.00	6,090.55
17	Palestra sp	48.00	-	36.00	12.00	72.00	60.00	228.00
18	Bibloteka M	-	-	-	-	-	-	-
19	Shtepia e K	-	-	-	-	-	-	-
20	Ndalja e ve	-	40.00	860.00	-	-	125.00	1,025.00
21	Regjistrimi	12,870.00	12,370.00	12,640.00	13,020.00	12,530.00	13,795.00	77,225.00
22	Taksat e mt	59,525.75	51,024.10	47,790.44	43,366.25	34,288.80	30,402.70	266,398.04
23	Prokurimi							-
24	Shtjja e dru	-	-	-	-	-	-	-
25	Ndrim tok.	-	-	5,897.00	22,341.25	2,649.00	16,881.25	47,768.50
26	Leje pune	-	-	30.00	-	-	30.00	60.00
27	Particip.D.s	4,530.00	5,013.00	3,857.50	4,770.50	5,088.00	4,210.00	27,469.00
	Qend.per pun.							
28	Sociale	330.00	330.00	355.00	255.00	393.00	275.00	1,938.00
29	Pranimet T	245.00	270.00	4,070.00	420.00	670.00	1,070.00	6,745.00
31	Gjobat e in	550.00	225.00	475.00	750.00	775.00	125.00	2,900.00
32	Leje ndertj	1,067.59	82,229.35	47,348.94	35,728.06	89,622.83	94,150.11	350,146.88
	Leje mjedis	-	8,638.53	22,469.25	-	4,996.12	14,673.94	50,777.84
	Legalizim I	420.94	82.30	301.00	849.20	-	386.15	2,039.59
	Rrenim I ok	-	169.68	184.80	-	-	-	354.48
33	Shf. Prko.p	90.00	90.00	16.00	-	8.00	-	204.00
34	Gjobat e Trafikut							-
35	Denimt e Gjykates							-
36	Gjobat e py	-	50.00	133.00	-	-	-	183.00
37	Donacion	-	-	5,108.00	-	-	-	5,108.00
38	te hyrat tje	-	-	-	-	-	-	-
		135,479.78	229,491.26	238,405.54	314,908.86	244,458.36	226,548.09	1,389,291.89

Planifikimi I të Hyrave Vetanake për periudhen Janar - Qershor 2024 është 1,709,077.00euro

Realizimi është 1,389,291.89euro,shprehur në përqindje 81.29%

Prokurimi Publik

Në periudhën raportuese, Drejtoria, konform dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit publik, ka iniciuar dhe realizuar **107 prokurime**, për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues respektivisht për gjitha Njësitë Kërkuese, si vijon :

- Administratë Komunale
- Arsim duke përfshirë këtu dhe gjitha shkollat e mesme dhe fillore si dhe institucionin parashkollorë.
- Shëndetësi dhe Qendër për Punë Sociale
- Njësia e Zjarrfikësve
- Zyra lokale e komuniteteve
- Zyra për kthim të komuniteteve, dhe
- Shtëpia rezidenciale në fsh. Lum Madh

Në vijim Ju sjellmi në mënyrën tabelare planifikimet/realizimet e aktiviteteve sipas natyrës së fushës.

1) KONTRATAT PËR FURNIZIM				
Nr. prok	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Datae parashikuara e fillimit të prokurimit	Vlerat parashikuara të kontratës
1	36140000-4	Furnizim me inventar	15.03.2024	41,630.00
2	31120000-3	Furnizim me Inventor	15.05.2024	10,000.00
3	28000000-2	Furnizimi me pajisje teknike tjera	01.06.2024	5,000.00
4	36632000-0	Furnizim me kurora dhe lule për homazhe dhe buqeta	16.09.2024	4,000.00
5	33100000-1	Furnizimi me pajisje mjekësore	01.03.2024	50,000.00
6	31120000-3	Furnizimi me gjeneratorë dhe inventar	15.02.2023	
7	33451000-6	Furnizimi dhe montimi i kamerave në rr. Dëshmoret e Kombit, shkolla, SHR-le dhe QMF/AMF-të në fshatra	14.06.2024	10,000.00
8	21000000-3	Furnizimi me material shpenzues për zyre	11.03.2024	16,700.00
9	31682000-0	Furnizim me pajisje digjitale për matje	11.03.2024	500.00
10	28512210-9	Furnizim me enë për kabinetin e profilit kuzhinier	15.04.2024	1,000.00
11	33000000-0	Furnizim me barna dhe materjale shpenzuese mjekësore	15.04.2024	36,000.00
12	24496500-2	Furnizim me material (regensa) për laborator, Teste të shpejta Streptococcal A Rapid Test dhe Hepatiti B	01.05.2024	140,000.00
13	24000000-4	Furnizim me material higjienik	15.02.2024	49,522.00
14	33141800-8	Furnizim me material stomatologjik	15.02.2024	15,000.00

15	02520000-5	Furnizim me pemë dhe Perime	05.05.2024	16,500.00
16	28000000-2	Furnizimi me paisje për praktikë profesionale për SHMP "Bahri Haxha"	01.03.2024	10,104.00
17	28000000-2	Furnizimi me paisje laboratorike për SHMT "Lutfi Musiqi "	01.03.2024	10,000.00
18	02410000-1	Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në oborret e shkollave	01.02.2024	1,950.00
19	21000000-3	Furnizimi me material pedagogjik	14.06.2024	18,000.00
20	29331100-9	Furnizimi me makina për kositjen e barit	20.03.2024	1,949.00
21	36111000-2	Furnizimi dhe montimi i ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave	15.06.2024	2,200.00
22	36415000-3	Furnizimi me mjete konkretizimi dhe topa	15.05.2024	5,750.00
23	31518100-1	Furnizimi me projektor dhe mbajtëse për projektor	20.02.2024	13,950.00
24	32224000-9	Furnizimim me TV për shkolla	20.02.2024	15,340.00
25	11000000-0	Furnizim me gazë natyror	15.03.2024	1,400.00
26	01000000-7	Furnizim me lule për shkolla	01.02.2024	2,733.00
27	31682000-0	Furnizim me pajisje elektrike për amvisëri (Aparat per hekurosje role, dhe pajisje tjera)	15.03.2024	13,000.00
28	17215100-3	Furnizimi me perde dhe tepiha	15.02.2024	7,800.00
29	36520000-2	Furnizim me lodra për femijë	01.02.2024	2,500.00
30	17000000-2	Furnizim me produkte tekstili (Qarqaf, qebe, jastak, tepi)	15.03.2024	2,500.00
31	28000000-2	Furnizimi me paisje laboratorike dhe mjete konkretizimi	15.05.2024	7,500.00
32	30000000-9	Furnizimi me Teknologjia Informative	15.05.2024	100,600.00
33	11000000-0	Furnizimi me antifrizë dhe vajra për ngrohje qendrore dhe gjenerator	01.03.2024	1,300.00
34	29231240-1	Furnizimi dhe montimi i klimave	15.04.2024	44,749.00
35	40330000-4	Furnizimi dhe montimi i kalldasë Qiler në objektin e QMF-1, dhe instalimi I sistemit per ngrohje dhe ftohje	02.04.2024	77,720.00
36	28000000-2	Furnizim me aparat saldimit	02.02.2024	664.00
37	21210000-8	Furnizimi me material për mirëmbajtjes së objekteve	02.02.2024	12,150.00
40	24210000-9	Furnizimi me preparate kimike	15.02.2024	6,063.00
41	15894200-3	Furnizimi me miell dhe artikuj tjerë ushqimorë, pije dhe higjienik	20.02.2024	450,000.00
42	18115000-8	Furnizim me veshmbathje	02.05.2024	41,850.00

43	02190000-2	Furnizim me pelet për ngrohje	22.05.2024	22,600.00
44	02190000-2	Furnizim me dru për ngrohje	22.05.2024	169,027.00
47	28000000-2	Furnizimi dhe montimi i xhamave në objektet shkollore	15.08.2024	1,550.00
48	34133110-2	Blerja e cisternes zjarrfikëse	01.03.2024	110,000.00
49	34100000-8	Automjet Terreni (vizita shtepiake)	02.05.2024	28,000.00
50	34100000-8	Kombi për transportin e pacientëve të hemodializes	09.02.2024	39,000.00
51	34112000-5	Blerja e Veturave per administraten komunale	22.01.2024	50,000.00
52	28000000-2	Furnizim me raket të ujit	31.05.2024	500.00
53	31682000-0	Furnizim me teknik të bardhë	02.04.2024	1,500.00
54	29851000-9	Furnizim me paisje dhe mjete për zjarrfikës	01.03.2024	30,000.00
55	31000000-6	Furnizim me drita për palester	16.04.2024	3,000.00
56	17000000-2	Furnizimi me pelhura dhe ngjyra për atilie	21.02.2024	4,000.00
57	28000000-2	Furnizimi me ngjyra për dysheme në Palestrat Sportive	15.02.2024	1,000.00
58	28000000-2	Furnizimi dhe instalimi i paisjeve zërimi-server për sallën e Kuvendit - Vushtrri	15.03.2024	30,000.00
59	02410000-1	Furnizimi dhe Mbjellja e drunjve dekorativ	04.11.2024	163,517.00
60	29811400-1	Punimi dhe vendosja e shenjzimeve në objektin e Komunës	05.03.2024	3,000.00
61	36140000-4	Paisja per QKMF-ve me orendi dhe inventarizimi i tyre	15.03.2024	410,000.00
62	31623100-0	Furnizimi dhe instalimi I paisjeve sinjalizuese, ndriqese-semafor	15.01.2024	100,000.00
63	30125100-2	Furnizimi me tonera për aparate fotokopjuese dhe printera	25.01.2024	32,000.00

II.2)KONTRATAT PËR SHËRBIME				
Nr. prok	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
64	50413200-5	Furnizimi dhe mirembajtja e aparateve kundër zjarrit	01.02.2024	54,000.00
65	73000000-2	Sherbime mjekesore nga Specialist i Radiologjise	01.02.2024	8,000.00
66	50312620-7	Servisimi dhe mirëmbajtja i TI dhe aparatit fotokopjues	24.04.2024	12,900.00
67	90250000-4	Deratizimi dezinfektimi dhe dezinfektimi 3D.	02.05.2024	11,900.00

68	93000000-8	Mbishkrimi informatave për shërbime	02.05.2024	5,000.00
69	90122210-3	Asgjesimi i mbeturinave medicinale	01.08.2024	5,000.00
70	74740000-8	Pastrimi dhe larja e automjeteve	02.09.2024	7,100.00
71	50532300-6	Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve	19.01.2024	8,000.00
72	50750000-7	Shërbimet për mirëmbajtje të ashensorëve	19.01.2024	3,700.00
73	93000000-8	Shërbimet për vlerësimin e rrezikshmërisë së objekteve	15.04.2024	8,000.00
74	50720000-8	Mirëmbajtja dhe servisimi e kalldave	15.05.2024	8,000.00
75	50000000-5	Mirëmbajtja e mobileve (dyerve dhe inventarit të shkollës)	02.06.2024	1,300.00
76	35000000-4	Marrja me qera e automjeteve per AK	22.01.2024	50,000.00
77	93000000-8	Mirëmbajtja e Objektit të Komunes	03.01.2024	20,000.00
78	93000000-8	Mirëmbajtja e jashtme e objektit	02.04.2024	1,500.00
79	93000000-8	Dekorimi i shesheve për festa	19.01.2024	120,000.00
80	93000000-8	Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal	01.03.2024	60,000.00
81	93000000-8	Shërbime Hoteljere	14.06.2024	18,000.00
82	93000000-8	Shërbime mediale për aktivitete të Komunes	01.03.2024	5,000.00
83	73000000-2	Shërbime konsulente	15.03.2024	10,000.00
84	28000000-2	Punim i dekoratava	10.01.2024	2,000.00
85	28000000-2	Punim i Profilin të Komunes	15.02.2024	10,000.00
86	50720000-8	Servisimi dhe mirëmbajtja i ngrohjeve qendrore	02.04.2024	6,000.00
87	93000000-8	Rregullimi i paisjeve elektrike për amvisri	20.08.2024	600.00
88	50114100-8	Servisimi i automjeteve për zjarrfikës	02.04.2024	12,000.00
89	93000000-8	Kontrolla teknike i automjeteve	01.08.2024	2,800.00
90	93000000-8	Sigurimi i automjeteve	01.08.2024	3,800.00
91	93000000-8	Servisimi i kositseve të barit	17.05.2024	1,600.00
92	93000000-8	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	15.07.2024	500.00
93	93000000-8	Shërbime Rekreacioni në Prevall	01.03.2024	5,000.00
94	50730000-1	Servisimi dhe mbushja e klimave	09.01.2024	3,300.00
95	60113100-4	Transporti i nxënësve	14.05.2024	310,000.00
96	60110000-2	Shërbimet e transportit mbrenda dhe jashtë vendit	15.05.2024	7,000.00
97	93000000-8	Shërbimet e sigurimit shëndetsor të nxënësve gjatë praktikës profesionale	31.05.2024	13,000.00
98	93000000-8	Shtypja e materialeve të ndryshme	07.02.2024	3,000.00
99	22900000-9	Botimi i revistave dhe librave	15.03.2024	2,350.00

100	93000000-8	Shërbimet e internetit	20.06.2024	8,000.00
101	93000000-8	Platforme digjitale per shkolla	15.02.2024	35,000.00
102	73000000-2	Sherbime konsulente profesionale për Fëmijë me nevoja të veqanta	19.01.2024	100,000.00
103	73000000-2	Shërbime Konsulente	19.01.2024	3,000.00
104	73000000-2	Shërbime Konsulente	10.01.2024	6,000.00
105	73000000-2	Shërbime konsulente profesionale në fushën e kulturës	19.01.2024	5,500.00
106	73000000-2	Shërbime Konsulente	19.01.2024	25,000.00
107	74232200-6	Hartimi i Planit Zhvillmor Komunal (PZHK)	19.01.2024	50,000.00
108	93000000-8	Shërbimi me tenda, zërim dhe ndriçim	15.01.2024	20,000.00
109	93000000-8	Lidhja e akteve në form të liberlidhjes	03.01.2024	1,000.00
110	93000000-8	Mostrat e punimeve dhe testimet e analizat e kualitetit te asfaltit	15.01.2024	60,000.00
111	93000000-8	Hartimi i planit komunal i veprimit për energji, klime dhe permiresimi i sherbimeve permes uljes se shpenzimeve	19.01.2024	90,000.00
112	93000000-8	Trajtimi I qenëve endacak	25.03.2024	200,000.00
113	93000000-8	Promovimi I Agroturizmit, turizmit urban dhe trashigimise kulturore	15.04.2024	260,000.00
114	93000000-8	Shërbime të GPS për automjetet e AK-së	26.02.2024	10,000.00
115	93000000-8	Hartimi i Projekteve 2-vjeqar	09.02.2024	750,000.00
116	93000000-8	Mirëmbajtaja e e-kioskut	03.01.2024	2,500.00

II.3) KONTRATAT PËR PUNË

Nr. prok	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
117	45210000-2	Ndërtimi i sallës në objektin e Komunës- rehabilitim	20.02.2024	12,000.00
118	28812310-3	Ndarje fizike -objekti i komunës-Vushtrri	15.02.2024	20,000.00
119	45212120-3	Ndërtimi i shesheve dhe parqeve (Mobileria Urbane) në Vushtrru	04.03.2024	48,744.00
120	45000000-7	Rikonstruimi i rrugeve te asfaltuara	19.04.2024	270,000.00
121	45232410-9	Ndërtimi i kanalizimeve Gracë-Prelluzhë-Stanoc	12.03.2024	20,000.00
122	45232410-9	Ndërtimi i kanalizimeve Maxhunaj Dolak	12.03.2024	30,000.00
123	45000000-7	Ndërtimi me kubëza betoni I rrugëve "Beshir Krasniqi", " Jashar Jashari", "Ferat Hasani", "Gostivari", "Arsim	09.02.2024	65,000.00

		Tahiri "Asllan Xhemajli", "Ali Sfarqa", "Mazhiq" dhe "Zek		
124	45000000-7	Ndërtimi me kubëza betoni i rrugëve "Agim Islami", "Nebih Avdiu", "Sejdi Sahiti", "Demir Halili", "Kërçova" dhe "Selim Ferati"	09.02.2024	55,000.00
125	45000000-7	Ndërtimi i rrugëve "Bahri Kuçi", "Miftar Shaqiri", "17 Shkurti", "Behxhet Aliu", "Fehmi Tërrnava" me kubëza betoni dhe infrastrukturë	09.02.2024	45,000.00
126	45000000-7	Ndërtimi i rrugëve me kubëza guri (kalldërm) "Pandeli Sotiri", "Shemë Nallbani" dhe "Hoxhë Kadri Prishtina"	09.02.2024	150,000.00
127	45000000-7	Ndërtimi i trotuareve në fshatin Sfarraqak rrugët "Lidhaj e Lezhes" dhe "Hamdi Gashi" dhe në fshatin Maxhunaj	15.03.2024	45,000.00
128	45000000-7	Ndërtimi i trotuareve në fshatrat Doberllukë, "Stanoc, Akrashticë, Reznik, Pestovë dhe Stroc	15.03.2024	40,000.00
129	45221110-6	Ndërtimi i urës në fshatin Lummadh në Vushtrri	20.03.2024	100,000.00
130	45000000-7	Regullimi i lumit Tërstena-Silnica vazhdim	11.03.2024	10,000.00
131	45221110-6	Rregullimi i urës së Silnicës në Vushtrri	12.04.2024	153,000.00
132	45247130-0	Ndërtimi i stacionit të pompimit, rrjetit primar dhe rezervuareve të ujit, në pjesën lindore të Vushtrrisë	15.01.2024	350,000.00
133	45000000-7	Ndërtimi i shtigjeve për ecje dhe bicikleta në Vushtrri	10.05.2024	20,000.00
134	45000000-7	Rehabilitimi i rrugëve në fshatrat Dumnicë, Gracë, Lummadh, Stanoc dhe Maxhunaj	15.03.2024	400,000.00
135	45000000-7	Rehabilitimi i rrugëve në fshatrat Verrnicë-Shallc, Akrashticë, Bukosh dhe Dolak	15.03.2024	425,000.00
136	45000000-7	Rehabilitimi i rrugëve në fshatrat Smrekonicë, Doberllukë, Sllatinë dhe Pasome	15.03.2024	385,000.00
137	45000000-7	Rehabilitimi i rrugëve "Dëshmorët e Kombit", "Arsim Tahiri", "Ismail Qemajli" dhe "Ukshin Kovaqica" në Vushtrri	15.03.2024	420,000.00
138	45000000-7	Rehabilitimi i rrugëve në fshatrat Bivolak, Zhilivodë dhe Stroc	15.03.2024	170,000.00
139	45000000-7	Ndërtimi i "Sheshit të lirisë" në Vushtrri	15.03.2024	200,000.00
140	45212200-8	Ndërtimi i shetores dhe fushës sportive te palestra në Vushtrri	15.03.2024	110,000.00

141	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Dunnicë, Maxhunaj, Stanoc, Lummadh, Vilanc, Ropicë dhe Pestovë	15.03.2024	150,000.00
142	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Gracë dhe Prelluzhë	15.03.2024	150,000.00
143	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në Verrnicë	15.03.2024	40,000.00
144	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Studime e Ulët, Ceceli, Samadrexhë dhe Sfaraqak	15.03.2024	65,000.00
145	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Bajnskë, Pasomë, Sllatinë, Begaj dhe Smrekonicë	15.03.2024	90,000.00
146	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Shtitaricë, Pantinë, Hercegovë dhe Akrahtice	15.03.2024	100,000.00
147	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Bukosh, Dolak dhe Novolan	15.03.2024	80,000.00
148	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Druar, Mihaliq, Reznik dhe Shalc	15.03.2024	80,000.00
149	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Stroc, Beqok, Gllavotin, Bivolak dhe Zhilivodë	15.03.2024	90,000.00
150	45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Beçiq dhe Duboc	15.03.2024	50,000.00
151	45233120-6	Ndërtimi i rrug."2 Maji" me infrastrukturë përcjellëse	15.03.2024	2,050,000.00
152	45000000-7	Rregullimi i sportelit në QMF- Pantinë dhe QKMF në objektin e ri	15.04.2024	7,000.00
153	45000000-7	Rehabilitimi i objekteve shëndetësore dhe rrethojave për QKMF, QMF-të dhe AMF-të në Vushtrri	15.04.2024	70,000.00
154	45000000-7	Rehabilitimi i objektit të QPS- Vushtrri	01.03.2024	10,000.00
155	45000000-7	Rehabilitimi i objektit të Qendrës Rrezidenciale në fshatin Lumadh Vushtrri Vushtrr	01.03.2024	15,000.00
156	45454100-5	Restaurimi dhe konservimi i objektit "Arkivi i vjetër" ish fabrika e vajit	15.04.2024	30,000.00
157	45000000-7	Rregullimi i memorialeve në fshatrat Gllavotin, Reznik, Beçiq, Duboc, Galicë, Pantinë, Studime, Zhilivodë dhe Pasomë	01.03.2024	35,000.00
158	45000000-7	Rehabilitimi i platosë në Kalanë e qytetit	08.04.2024	30,000.00
159	45212200-8	Ndërtimi/rikonstruimi i fushave sportive në fshatrat Maxhunaj, Lummadh, Stanoc, Reznik, Pestovë, Doberllukë, Pantinë, Shtitaricë, Novolan, Druar, Samadrexhë, Beçiq dhe Bruznik	09.02.2024	100,000.00

160	45000000-7	Ndërtimi i tribunave, dhe objekteve përcjellëse në sadiumin "Ferki Aliu"	20.02.2024	60,000.00
161	45000000-7	Rehabilitimi i çerdhes „Foleja” në Vushtrrii	04.03.2024	60,000.00
162	45000000-7	Renovimi i SHFMU "Migjeni" në fshatin Stanoc lagja Cakaj	04.03.2024	13,000.00
163	45000000-7	Rehabilitimi i dhomave të parafillorëve Vushtrri	04.03.2024	60,000.00
164	45000000-7	Rehabilitimi i oborrit në shkollën SHMU II	15.04.2024	30,000.00
165	45213221-8	Ndërtimi i depove për shkolla në Pestove, "Rilindja", "Bahri Haxha", "Nadakoc", "Eqrem Çabej", Ip "Foleja"	05.04.2024	70,000.00
166	45000000-7	Rehabilitimi i arkivës në SHF "Ali Kelmendi" në Vushtrri	04.03.2024	15,000.00
167	45000000-7	Rehabilitimi i SHFMU "Mustafë Shyti" në fshatin Oshlan	04.03.2024	50,000.00
168	45000000-7	Rehabilitimi i SHFMU „Enver Hadri" në fshatin Smrekonicë	04.03.2024	80,000.00
169	45214200-2	Ndërtimi i punëtorisë për automekanik dhe metalpunues në SHMT "Lutfi Musiqi"	13.02.2024	45,000.00
170	45000000-7	Rregullimi i platos se lapidarit „Lutfi Musiqi"	05.02.2024	5,000.00
171	45000000-7	Ndërtimi i poligonit në SHMT "Lutfi Musiqi"	05.02.2024	30,000.00
172	45000000-7	Rehabilitimi i tualeteve në SHMP "Bahri Haxha" në Vushtrri	04.03.2024	35,000.00
173	45000000-7	Rehabilitimi i fushës sportive në SHMP "Bahri Haxha"	05.04.2024	20,000.00
174	45000000-7	Rregullimi i shtratit të lumit Podranqa dhe lumenjve të tjerë	20.03.2024	280,000.00
175	45000000-7	Renovimi, Izolimi, Fasadimi dhe rikonstruktivimi i cative dhe i bodrumeve ne te objekteve kolektive dhe komunale	22.01.2024	2,000,000.00
176	45000000-7	Rregullimi i shtratit te lumenjeve ne qytet dhe fshatra	20.02.2024	220,000.00
177	45000000-7	Ndërtimi i klasëve verore në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri	15.03.2024	10,000.00

II.4) KONKURSET E PROJEKTIMIT

Nr. prok	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
178	74232200-6	Konkurs për hartimin e projekteve per dizajnimin e urave	12.02.2024	50,000.00

Duke zbatuar procedurë të përbashkët për disa njësi kërkuese, me theks të veçantë te Kontratat Kornizë, me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit, duke pasur parasysh gjithnjë transparencën dhe trajtimin e barabartë të Operatorëve Ekonomik të interesuar, është arritur në masë të kënaqshme që procedimi i projekteve të planifikuara të raelaizohet në kohë dhe në mënyrë të suksesshme tek kontratat kornizë.

Ekonomi dhe Investime Kapitale

Sektori për biznes

Qendra Komunale e Biznesit vepron në kuadër të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës - Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës

QKB –ja funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare, kërkesa për ndryshim si dhe shërbime të tjera. Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Europian. Po ashtu është punuar në mënyrë sistematike dhe në shërbim maksimal për ofrimin e kushteve bizneseve për kryerjen e shërbimeve të tyre në mënyrë efikase dhe të shpejtë.

Pasqyra tabelare të bizneseve të regjistruara

CODE	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-30.06.2024	%
1	2	3	4
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	25	16.89
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	14	9.45
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë		
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të trjatumit të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria	11	7.43
G	Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	47	31.7
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit		
I	Transporti dhe magazimi Informimi dhe komunikimi	10	6.75
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	8	5.49
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	11	7.43
M	Arsimi	11	7.43

N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	11	7.43
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese		
P	Aktivitetet e ekonomive familjare		
	Gjithsej	148	100

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, si veprimtari dominuese ekonomike është tregtia me 31.7 % apo me 47 biznese prej numrit të përgjithshëm, pastaj industria përpunuese me 14 biznese apo me 9.45 %, ndërtimtaria me 7.43 % apo me 11 biznese,etj

Pasqyra tabelare e bizneseve të shuara sipas veprimtarive ekonomike.

Kodi	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-30.06.2024	%
1	2		
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi		
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	3	1
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë		
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të trjtimit të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria		
G	Treg. me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	12	4
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	3	1
I	Transporti dhe magazimi Informimi dhe komunikimi		
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	2	0.67
	Aktivitetet e patundshmërisë	1	0.33
K	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse		
M	Arsimi	1	0.33
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	1	0.33
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese	7	2.34
P	Aktivitetet e ekonomive familjare		
	Totali	30	100

Siç shihet nga te dhënat e tabelës edhe tek shuarjet dominon tregtia me 12 biznese apo 4% restorantet me 1% etj.

Deri më 30.06.2024 janë kryer gjithsej këto shërbime:

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	Biznese të reja (të regjistruara)	148	
2.	Shuarje të bizneseve	30	
3.	Ndërrime të logove të certifikatave	211	
4.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	88	
5.	Vërtetim	2	
	Gjithsej	479	

Përveç shërbimeve të lartshënuara, Sektori i Bizneseve ka kryer edhe lëndë të tjera si:

- | | |
|---|----|
| - Leje Pune për Auto Taxi - | 1 |
| - vazhdimin e lejeve për transportin autotaxi | 24 |
| - dhënia e certifikatave për kontribute - vitet e '90 | 9 |

Gjithsej **34**

Në këtë periudhë vërehet një interesim më i madh i pronarëve për të hapur biznese bujqësore (prodhuese) për shkak të subvencioneve që përfitojnë nga donatorët e ndryshëm, si dhe nga shoqatat e ndryshme joqeveritare, donacione të Ministrisë së Bujqësisë etj.

Bujqësia

Gjatë periudhës janar – qershor te vitit 2024 në Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural janë zhvilluar aktivitete të bazuara kryesisht në planin e punës për vitin 2024 e te cilat po i paraqesim me poshtë.

1. Subvencioni për litër qumësht për periudhën janar-qershor 2023 me vlere 78,756.60
2. Vendime për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, gjithsejtë vendime të lëshuara 13, me vlerë te përgjithshme 47,768.00€
3. Aplikimi i 1550 fermerëve për subvencione për pagesa direkte nga AZHB .
4. Draftimi i Rregullores se re për përkrahjen e fermerëve ne bujqësi dhe bizneseve ne sektorin privat deri ne miratimin e saj nga Kuvendi i komunës.
5. Organizimi i dy trajnimeve me fermer me temën “Menaxhimi i shëndetit te lopëve qumështore” dhe “prodhimi higjenik i qumështit” me 34 fermer pjesëmarrës.
6. Vlerësimi i dëmeve bujqësore nga fatkeqësitë natyrore për 20 fermer.
7. Përcjellja e fushatës se korrje-shirjeve.

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar edhe vizita te shpeshta tek fermerët e komunës si dhe biznese të komunës sonë me qëllim marrjen e informacioneve lidhur me sfidat që hasin fermerët dhe bizneset tona.

Po ashtu janë organizuar takime me fermerë si dhe me gra fermere që merren me prodhime të produkteve bujqësore.

Gjate vitit ne vazhdim janë të planifikuara projektet si: subvencionimi i fermerëve që mbarështojnë blete , dele, dhi dhe buallica.

Po ashtu janë të planifikuara edhe mbështetjet për subvencionim të fermerëve për litër qumësht (pjesa korrik-dhjetor 2023) dhe ujitja me 50% e sipërfaqeve të mbjella me kultura bujqësore.

Në realizim e sipër është edhe ndërtimi i objektit të kryqit të kuq të Kosovës, ndërtimi i tregut të gjelbër me bashkëfinancim me IRW si dhe projekti udha e gurit me bashkëfinancim me MZHR-në.

Poashtu edhe Projekti për furnizim mekanizëm bujqësor (moto kultivator) me bashkëfinancim me TIKa, i cili është shtyrë për një afat te pacaktuar, si dhe janë dy projekte në përfundim e sipër me IADK, pastaj, fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve në zonat rurale për prodhime vendore.

Arsimi

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor 2023/24. Gjysmë vjetori i dytë ka filluar më 24 janar 2024 ndërsa ka përfunduar për klasën 12 –të (maturantë) me datë: 16.05.2024, për klasat 9, 10, 11, më datë: 6.06.2024, për klasat para fillore dhe 1-8 –të më: 24.06.2024.

Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore;

- 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizikë e cila është në procedurë të pavarësimit;
- 3 shkolla fillore;
- 2 Shkolla të mesme të ulëta;
- 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta;
- 3 shkolla të mesme të larta;
- Numri i punonjësve: 1141;
- Numri i paraleleve: 651;

Numri i nxënësve:

- Niveli 0: (grup moshat 1-6 dhe çerdhet) 1148 fëmijë/nxënës;
- Niveli 1(klasa 1-5): 4882 nxënës;
- Niveli 2 (klasa 6-9): 4002 nxënës;
- Niveli 3 (klasa 10-12): 2265 nxënës;
- Gjithsej nxënës 12297 nxënës;

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/24, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë më qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektivat kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit;
- Takime të rregullta me MASHTI;
- Takime të rregullta me KFORIN slloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsim;
- Pjesëmarrje në konferencën përmbyllëse të projektit ARISE, zyrtarët e DKA-së kanë qenë pjesë e panelit për të folur në për nivelin komunal për pabarazitë në arsim;
- U mbajt aktiviteti "Drejt Malit - HIKING" me nxënësit kampion të garave komunale;
- Projekti KosEd 'Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë (2021-2025)', i financuar nga BE, në partneritet me MASHTI-n dhe Inspektoratin e Arsimit e ka mbështetur vlerësimin e brendshëm të 5 shkollave në dy vitet e fundit bazuar në Modelin kolegial kosovar për sigurim

- të cilësisë. **Komuna e Vushtrrisë ishte komuna e parë** që filloi analizimin e të dhënave të prodhuara nga modeli kolegial për ndërtim të kapaciteteve dhe që t'i përdor ato për të organizuar trajnime në të ardhmen. Raporti nga eksperti anglez Robert Blease;
- U mbajt ligjëratë për klasat e X-ta nga FSK për pjesëmarrje në projektin “Edukimi për Siguri” ;
 - U mbajt program artistik për nderë të 7 marsit- Ditës së mësuesit;
 - Transporti i nxënësve është realizuar në 35 vija udhëtuuese;
 - Për 7 ditë nga data: 10 shkurt deri më 24 shkurt: 49 nx. të SHFMU “Migjeni” Stanoc dhe SHFMU- Nedakoc u përfshin në projektin “Drejt malit” në Brezovicë;
 - SHFMU “Abdyl Frashëri” Druar; Në kuadër të këtij projekti të Kosed shkolla ka realizuar edhe trajnime me bazë në shkollë të cilat i kemi mbajtur dhe përfunduar me sukses ku në fund mësimeve janë certifikuar.
 - SHFMU “A.Z.Çajupi” Vushtrri me nxënësit Olisa Krasniqi dhe Rihana Hyseni, së bashku me drejtorin e shkollës, kanë qenë pjesë e konferencës përmbyllëse të programit IPA FF e cila është mbajtur në Bruksel. IPA FF shpërblen nxënësit, shkollën me mirënjohje për punën e bërë gjatë periudhës 3 mujore;
 - SHFMU “Bahri Kuqi” Shtitaricë; përfituese e një projekti nga “Transformimi shoqëror inovativ” nga organizata Dokufes dhe KEC e quajtur KIST+ I financuar nga Mbretëria e Ambasadës Holandeze në Kosovë dhe me këtë kemi përfituar shumë nga Klubi Medial i shkollës, Gjatë aktivitetëve të tilla nga projekti Klubit ke fituar 180€ më pas nga organizata mbështetje me bashkëpunim me OJQ Shoqërinë Kulturorë “Gjurmët” ka përfituar 500€;
 - Në SHFMU –Pestovë u mbajt trajnim nga Qendra Psiko-Sociale për Traumatëri – Diakonie Kosova;
 - Në SHFMU –Pestovë Zyrën Qendrore të IAP-së në Prishtinë, Departamenti për të Drejtat e Fëmijëve, ka organizuar Fushatë Informuese "Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit;
 - Bashkëpunimi me delegacionin turk nga INSTITUTI YNUS EMRA ku shpalosen planin e tyre dhe mbështetjen e plot financiare për nxënësit të cilët dëshirojnë t'i ndjekin mësimet në shkollimin e mesëm në Turqi;
 - Bashkëpunimi me OSBE tema: “Hartimi i Planit të Veprimit të Mekanizmit Koordinues kundër dhunës në familje” – Vizioni dhe Misioni I OSBE-së në Kosovë;
 - Pjesëmarrje në Forumin e III-të OZHQ-ve të organizuar nga INDEP në bashkëpunim me Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm ku u diskutuan zotimet e marra nga ana e Qeverisë në përmbylljen e IV zotimeve në mbledhjen e fundit të Kombeve të Bashkuara të cilat duhet të përmbyshen deri në vitin 2030;
 - Këshilltarët nga zyra e kryeministrit znj. Elizabeta Goëing, znj.Merita Januzi nga MASHT-I dhe z. Habit Hajredini përfaqësues i zyrës së mire (të gjithë nga NIVELI QËNDROR). Vizituan ekipin e DKA-së kundër braktisje dhe SHMU-2 si shembull i mirë i punës kundër braktisjes;
 - Në SHFMU “Liria” Stroc; Grupi letrar “Zëri ynë” ka zhvilluar takime letrare me anëtarët e Kravanit të Shkrimtarëve për Fëmijë: Xhevat Sylja, Ibrahim Kadriu, Prend Buzhala, Xhemë Karadaku, Erina Rrahmani, Jonuz Fetahaj, Gjon Gjergjaj, Ismet Krasniqi, Fazli Ferati dhe Idriz Berisha;
 - Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri, është nënshkruar marrëveshja me të cilën SHMP “Bahri Haxha” do të jetë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin CultiVeting ndër shkollat e para publike e përfshitë në këtë program (gjate muajt Qershor është realizuar vizita e pare studimore ne Athinë);
 - Marrëveshje bashkëpunim në mes Drejtoria për Arsim ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile “Koralet”, ku do të vazhdohet financimi i tri edukatoreve në tri qendra me bazë në komunitet. Ky bashkëpunim realizohet në tri shkolla, e që janë SHFMU “Migjeni” në Stanoc të Epërm, SHFMU “Nazmi Zhegrova” në Stanoc të Poshtëm dhe në SHFMU “Hajrullah Shala” në Akrashticë;

- Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të QEHT –KONICA dhe DKA –VUSHTRI, ku janë trajnuar: 25 mësimdhënës nga cikli i ultë 25 mësimdhënës nga cikli i mesëm i ultë me trajnimin: "Planifikimi i mësimdhënies produktive", Metodologji interaktive e mësimdhënies;
- Marrëveshje bashkëpunimi, në mes të DKA-së Vushtri dhe SHPIK- Shoqata Profesionale e informaticentëve të Kosovës për trajnimin e gjithë mësimdhënësve për kodim;
- Në SHFMU "A.Z.Çajupi" Organizata "Teach For Kosova" ka organizuar punëtori 4 ditore me 10 mësimdhënës të shkollës .Qëllimi i punëtorisë është krijimi i një katalogu për edukim inkulziv, ka përbajtur aktivitete që kontribuojnë në gjithë përfshirjen në klasa dhe do t'u shërbej të gjithë mësimdhënësve dhe ka realizuar projektin 1 vjeçar "Let Girls Thrive", që ka të bëjë me barazi dhe drejtësi sociale;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet: DKA – Drejtorisë Komunale për Arsim, Komuna e Vushtrrisë dhe FXHK – Federatës së Xhudos së Kosovës me programin "Kosova, Shtet i Xhudos" me shkollën SHMU-1 dhe SHMU-2;
- Në SHMP "Bahri Haxha" Vushtri, ka vazhduar projekti mësimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI dhe XII kanë kryer praktikën në vendin e punës;
- Në SHMP "Bahri Haxha" Vushtri, është pilotuar „Mësimi dual,, për 27 nxënësit e profilit „Tregtarë me pakicë dhe shumicë,, (ka pas vështirësi për shkak të mosgatishmërisë së bizneseve për të përbushur kontratat me nxënës ku parashihet edhe pagesa mujore); Janë pajisur me pajisje bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale kabinetet e kimisë, teknologjisë ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- Në SHMP "Bahri Haxha" Vushtri; 22 nxënës janë trajnuar dhe certifikuar në trajnimin „Zhvillimi i aftësive kreative për film dhe Animacion” tek të rinjtë” nga Instituti për zhvillim dhe integrim;
- Në SHMP "Bahri Haxha" Vushtri, kanë filluar përgatitjet për nënshkrimin e marrëveshjes për financim për grantin e fituar nga RCF (fondi rajonal i sfidave i cili financohet nga Qeveria gjermane dhe Zvicrane) në vlerën 410.000 euro;
- SHMP „Bahri Haxha” është përzgjedhur nga MZHE për digjitalizimin e procesit mësimor (do te kryhet gjatë muajit Korrik);
- Pjesëmarrja në projektin „Ndikimi i rinisë në mjedis” YENI I CARITASIT -,„Ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike”;
- Në Gjinnaz Rregullimi i dyerve të tualeteve të shkollës;
- Në Gjinnaz Mbjellja e luleve në oborrin e shkollës;
- Në SHFMU „MIGJENI,, Stanoc i Epërm është rregulluar kanalizimi në objektin e shkollës dhe jashtë saj deri ne lidhjen e kanalizimi të fshatit;
- U rrënuar shkolla e vjetër në SHFMU – Pestovë;
- Në SHMU-1 u shtrua me zhavor për parkingun e veturave;

I. Bursat dhe shpërblimet për nxënës

- **Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/e për studime brenda vendit;
- **Numri i bursave jashtë vendit - 17 (shtatëmbëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës- 1000.00 € (një mijë) për student/e për vendet e BE-së;
- Përfitues të bursave sipas gjinisë: 59 janë studente, dhe 28 janë studentë;
- Gjithsej përfitues të bursës 87 studentë; me vlerës 56.600.00 euro
- Ndërsa DKA- Vushtri: deri tash gjatë këtij viti ka subvencionuar 12 studentë të cilët i kanë kushtet e rënda ekonomike ose kanë vetëm njërin prind, ose prindërit invalid, me vlerë 4100 euro
- Studentë në Greqi – në York city colge janë 4 studentë 2 baç dhe 2 master dhe janë subvencionuar 24.630 euro

- **Gjithsej përfitues 103 studentë me vlerë 85.330.00 euro.**

Shpërblimet e nxënësve;

- Për vendet e para: 42 nxënës me vlerë 4350€;
- Për vendet e dyta: 18 nxënës me vlerë 1475€;
- Për vendet e treta: 13 nxënës me vlerë 650€;
- Tri vende të para për 8 nxënës 600 €;
- Gjithsej përfitues 81 nxënës;
- 3 nxënës të gjimnazit janë financuar për udhëtime jashtë vendi me vlerë 2500 € Tauna Grabovci dhe Suela Selimi nxënës të Gjimnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri, të cilat do të shkojnë për hulumtime shkencore në fizikë në Universitetin Santakruz - Kaliforni, dhe 1 nxënës Eriti Rushiti pjesëmarrës në gara republikane botërore të Fizikës e cila do të mbahet në Iran);
- 2 nxënës Lorik Rama nx. i Gjimnazit “Eqrem Çabej” marrin pjesë në Olimpiadë STEM në Hagë të Holandë , dhe Jonart Krasniqi nga SHF “Ali Kelmendi” Vushtrri dhe ju jepet ndihmë financiare 1800 €;
- Përmbledhje: Gjithsej janë në proces të shpërblimeve 92 nxënës me vlerë; 18275€

II. Garat, aktivitetet dhe të arriturat

- Eko-klubi i SHMP “Bahri Haxha” ka fituar çmimin parë mjedisor „Dervish Rozhaja,, ne vlerën prej 10.000 euro ne garën me projekte mjedisore të mbajtur në fillim të muajit Qershor;
- Në garat e shahut organizuar nga Innovation Academy dhe Drejtorisë Komunale të Arsimimit (DKA) në Vushtrri nxënës i klasës së IV Ensar Salihu i SHFMU - Pestova, ka zënë vendin e parë në këtë garë;
- “Mozaiku Kulturor i Vushtrisë në Pikturë” është titulluar ekspozita e artit që është organizuar nga Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me OJQ “ORDA”, Në këtë garë individuale morën pjesë gjithsej 15 nxënës, ndërsa u shpërblyen tre prej tyre. Vendi i parë: SHMU-1 Vushtrri me nxënësen Yllka Podvorica, e cila u shpërblye me 100 euro;
- Në garat republikane të programit "SPORTI NË SHKOLLA" NË BASKETBOLL 3x3 në Sheshin Skënderbeu, Prishtinë u zhvilluan Garat Republikane të Programit "Sport në Shkolla", me pjesëmarrjen e 28 ekipeve të klasave 6-9 vajza dhe djem nga 14 shkolla të 7 regjioneve. SHMU-1 ka zënë Vendin e parë nga klasat VI dhe VII (Meshkujt);
- Në garën për esenë më të mirë të mbajtur në shkollën "Mehmet Akif", nxënësja e e SHFMU “Liria” Stroc nx. Rrezartë Aliu, ka zënë vendin e tretë

III. Vlerësimet e jashtme

Testi i maturës 2024

Testi i maturës u mbajt me 22 qershor 2024, në 5 qendra testimi. Në test morën pjesë tre institucione të arsimit të mesëm të lartë: Gjimnazi “Eqrem Çabej”, SH.M.T. "Lutfi Musiqi", dhe SH.M.P. “Bahri Haxha” Vushtrri. Gjatë këtij viti pati në ndryshime në proces të testit maturës si në paraqitje e provimit shtetëror dhe ndarja e nxënësve gjatë testimit. Përmes tabelës dhe grafikeve pasqyrojmë përqindjen e kalueshmërisë dhe krahasimit me vitin paraprak.

SHKOLLA:	2023	2024	Krahasueshmëria
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri	93.28%	88.80%	4.48%
SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri	37.50%	49.80%	-12.30%
SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri	36.50%	58.82%	-22.32%

Testi i Arritshmërisë 2024

Testi i Arritshmërisë u mbajt më 25 qershor pjesa e parë dhe pjesa e dytë më 28 qershor. Në test u përfshin 9 lëndë dhe gjithsej 200 kërkesa (pyetje, detyra). Drejtoria Komunale për Arsim ka digjitalizuar dhe përpunuar të dhënat e testit të arritshmërisë dhe ka nxjerrë analiza statistikore të cilat do të jenë shumë të dobishme për Drejtorinë dhe shkollat e komunës sonë.

Lënda:	Kalushëmira në %, viti 2023	Kalushëmira në %, viti 2024	Krahasimi
GJ. SHQIPE	62.7	55.42	7.28
GJ. ANGL.	60.54	61.67	-1.13
HISTORI	55.38	54.88	0.5
GJEOGRAFI	45.99	53.09	-7.1
MATEMATIKË	44.08	37.25	6.83
INFORMATIKË	51.35	43.3	8.05
FIZIKË	43.3	40.49	2.81
KIMI	43.55	37.96	5.59
BIOLOGJI	51.88	46.09	5.79
Mesatarja në nivel Komune	51.35	47.79	3.56

Nxënësit që kanë arritur më së shumti pikë:

Shkolla:	EMRI	Mbiemri	P1	P2	GJ
SHMU-2	ANISË	KUTLLOVCI	93	91	184
SHMU-1	URTË	THAÇI	96	78	174
SHMU-2	MELIKA	TIRIQI	89	80	169

IV. Donacionet

- Gjumnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka pranuar donacione nga “NB CONSTRUCTION” Vushtrri me pronar z. Kujtim Pllana, me vlerë 500 euro, pajisje sportive, nga kompania Deloitt-Vushtrri , rregullimi i ulëseve në oborrin e shkollës dhe mbjelljen e luleve, si dhe nga Prof.Raif Mehmeti ish mësimdhënës i Gjumnazit përkatësisht nga shoqata Nyrbo-FN-Forening me veprimtari në Suedi, me vlerë 300 euro për tre nxënës;
- SHFMU “12 Qershori” Mihaliq; ka pranuar donacione nga Avni Syla, banor i fshatit, i cili ka bërë një investim në: ndërrimin e dritave në të gjithë hapësirën shkollore, dritat emergjente, ndërprerës në klasën 9, reflektorë në hapësirën e jashtme shkollore, kabllon për përcjelljen e rrymës në shkollë, topa futbollit, volejbollit dhe basketbollit, ka dhuruar një kosh për basketboll;
- SHFMU “Lumni Surdulli “ Samadrexhë ka pranuar donacionet- Nga këshilli i Fshatit Samadrexhë për nevojat e shkollës është dhuruar një zërim dhe disa veshje kombëtare për nxënës;
- SHFMU “Bahri Kuqi” ka pranuar donacione nga Lulishtja Liridoni, i cili ka sjell fidane dhe drunjë dekorative për shkollë. Donacioni tjetër i radhës ka qen nga kompania Venta e cili ka sjell 100€ euro për të blerë pajisje sportive. Nga kompania AMIS ka pranuar një donacion me ndërresa sportive për klubin e futbollit dhe volejbollit. Ndërsa libra kanë dhuruar; Ferdane Pllana Zabërgja, Ibrahim Kuqi Remzije Zekolli dhe Bedri Tahiri, nga ky i fundit ka pranuar mbi 100 cope libra të ndryshëm të botuara dhe të shkuara nga vetë autori;
- SHMU 1; ka pranuar këto donacione:
 1. Rafta për libra. Donacion nga prindërit 300 euro;
 2. Kamera 5 copa, vlera 450 euro, Beni Shop dhe prindërit;
 4. Libra për Bibliotekën e shkollës znj. Ilmije (Jonuzi) Feka, vlera 250 euro;
 5. Kompania Gjoni material për mirembajtje, vlera 90 euro;
 6. Çezme betoni dekoruese për oborr nga kompania Filizi, vlera 150 Euro, pajisje të ujin Bekim Vershevc 40 euro 15.06.2023;
 7. Zile elektrike automatike-digitale Alban Maloku, vlera 60 euro;
 8. Qendra Rinore Hareja, Ngiyra, Brusha, pëlhura për pikturim, vlera 250 euro;
 9. Printer për klasa dhe dollapa prindërit, vlera 200 euro. Data: 25.03.2024;
 10. Benny Shop TV Smart me pajisje përcjellëse, vlera 300 euro, Data: 23.03.2024;
 11. Ariani Comperi beton për rregullimin e rrethojës së fushës sportive, vlera 140 euro;
 - 12 Rregullimi i Bibliotekës, vlera 900 euro - 19.06.2024 donacion nga drejtori i shkollës;
- SHFMU “Liria” Stroc: Forumi për Integrim Social – FIS në bashkëpunim me zyrën e Presidencës së Kosovës – Donacion: ngjyra, pëlhura, brusha për ekspozitë, vlera 200.00 euro

V. Aktivitetet për sigurinë në shkollat e Vushtrrisë

Gjysëmvetori i dytë i vitit shkollor 2023/24 mund të quhet lirisht gjysëmvetori i sigurisë në shkolla. I kemi dhënë prioritet të lartë sigurisë në shkolla. DKA ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës, shkollat, komunitetin, akterët e shoqërisë civile dhe grupet e specializuara për të rritur sigurinë në shkolla.

Zyrtarët e policisë kanë mbajtur ligjëratë për secilën temë në 10 shkolla :

Në muajin janar u mbajtur ligjëratë vetëdijësuese me temë “Ligjëratë për siguri në komunikacionin rrugor”

- Në muajin shkurt u mbajtur ligjëratë me temë “Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm”;
- Në muajin mars u mbajtur ligjëratë me temë “Parandalimi i ngacmimeve seksuale dhe masat ligjore ndëshkimore”
- Në muajin prill u mbajtur ligjëratë me temë “Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit”;

- Në muajin maj u mbajt ligjërata me temë “Dhuna në Familje” në 10 shkolla;
- Në muajin qershor në të gjitha shkollat u mbajtën ligjëratat rreth vetëdijesimi për lojërat e rrezikshme në internet;
- Policia me kërkesën e DKA-së, Me qëllim të sekuestrimit të sendeve të dyshimta/të kundërligjshme, kemi bërë kontrollimin e klasave dhe nxënësve në tri shkollat e mesme, “Lutfi Musiqi”, “Bahri Haxha” dhe Gjimnazin “Eqrem Çabej”, si dhe në ndërrimin e paradites janë kontrolluar edhe klasat e -IX-ta të shkollave të mesme të ulëta SHMU-1, SHMU-2 dhe SHFMU “A.Z.Çajupi. Gjatë kontrollit tek nxënësit janë hasur dhe sekuestruar: Pesë thika, dy armë të shkurta të plastikes (lodra), një kaçavide dhe tek një nxënës kemi hasur një sasi të vogël të substancës narkotike (0.5 gramë marihuanë).;
- Zyrtarët e DKA-së në disa shkolla janë përfshirë në ligjëratat dhe tryeza diskutimi rreth dukurive negative;

VI. Suksesi i gjysmëvjtorit të dytë 2023/24

Suksesi i gjysmëvjtorit të dytë, viti shkollor 2023/24 klasa 1- 5, krahasuar me periudhën e njëjtë							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar	Përcillen me nota negative
2023	66.62%	20.01%	10.24%	2.90%	0.20%	0.00%	0
2024	65.89%	19.40%	11.19%	3.30%	0.17%	0%	0.04%
Krahasueshmëria	0.73%	0.61%	-0.95%	-0.40%	0.03%	0.00%	-0.04%

Suksesi i gjysmëvjtorit të dytë, viti shkollor 2023/24 klasa 6- 9, krahasuar me periudhën e njëjtë							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar	Kanë përsëritur klasën
2023	30.37%	21.50%	26.92%	13.54%	6.95%	0.47%	0.22
2024	28.46%	21.69%	27.96%	15.78%	5.75%	0.05	0.28
Krahasueshmëria	1.91%	-0.19%	-1.04%	-2.24%	1.20%	-4.53%	-6.00%

Suksesi i gjysmëvjtorit të dytë, viti shkollor 2023/24 klasa 10- 12, krahasuar me periudhën e njëjtë							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar	Kanë përsëritur klasën
2023	16.14%	18.94%	12.24%	26.90%	6.78%	0.30%	1.79
2024	14.61%	19.90%	32.32%	21.05%	8.35%	2.69%	1.05%
Krahasueshmëria	1.53%	-0.96%	20.08%	5.85%	-1.57%	-2.39%	177.95%

Raport për notën mesatare të lëndëve për klasa

Klasa	Art figurativ	Biologji	Edukatë fizike dhe sportive	Edukatë muzikore	Edukatë qytetare	Edukim shëndëtsor	Fizikë	Gjeografi	Gjuhë angleze	Gjuhë frënge	Gjuhë gjermane	Gjuhë shqipe	Histori	Jeta dhe puna	Kimi	Matematikë	Ndërmarrësia	Njeriu dhe natyra	Punëdore	Të tjera...	TIK
1	4.86	0	4.92	4.87	4.77	4.77	0	0	4.68	0	0	4.59	0	4.76	0	4.59	0	4.72	4.94	4.78	0
2	4.75	0	4.89	4.75	4.39	4.33	0	0	4.3	5	5	4.19	0	4.54	0	4.2	0	4.34	4.53	4.55	0
3	4.58	0	4.77	4.54	4.18	0	0	0	4.11	0	0	4.1	0	4.31	0	4.08	0	4.06	4.38	4.34	0
4	4.7	0	4.84	4.66	4.13	4.67	0	0	4.05	0	0	4.09	0	4.39	0	4.07	0	4.03	4.5	4.3	0
5	4.57	0	4.76	4.58	4.14	0	0	0	4.02	0	0	4.04	0	4.33	0	3.95	0	4.05	4.56	4.34	0
6	4.17	3.38	4.55	3.92	3.51	4.19	3.25	3.45	3.52	3.88	3.62	3.41	3.52	3.52	3.68	3.32	3.79	0	0	3.68	3.69
7	4.05	3.34	4.36	3.82	3.51	0	3.35	3.32	3.54	3.9	3.34	3.48	3.47	4.4	3.32	3.15	0	0	5	3.76	3.61
8	3.92	3.17	4.36	3.82	3.5	0	3.19	3.39	3.43	3.43	3.44	3.36	3.38	4.1	3.17	3.02	0	0	0	3.55	3.65
9	4.01	3.42	4.41	3.99	3.61	0	3.43	3.5	3.45	3.7	3.42	3.48	3.59	3.48	3.33	3.17	4.35	0	0	3.75	3.67
M	4.40	1.48	4.65	4.33	3.97	2.00	1.47	1.52	3.90	2.21	2.09	3.86	1.55	4.20	1.50	3.73	0.90	2.36	3.1	4.12	1.62

Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve dhe punëve të kryera gjatë periudhës raportuese dhe përqendrohet në përmirësimet dhe arritjet e bëra në kuadër të Qendrës së Mjekësisë Familjare (QKMF), Shtëpisë Reziduale dhe Qendrës për Punë Sociale

DSHPS dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Strategjinë Sektoriale të KPSH në Vushtri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

QKMF-ja është përgjegjëse për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

BASHKËPUNIMI ME DONATOR

Gjatë periudhës raportuese DSHPS dhe QKMF kemi arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

- Bashkëpunimi me donatorin AQH e Zvicrës, është duke vazhduar në kuadër të zhvillimit të edukimit të vazhdueshëm profesional.
- DSHPS Komuna Vushtri dhe Islamic Relief me seli në Prishtinë kemi vazhduar projektin i cili ka pasur nismën dhe funksionalizimin në vitin 2017 në bazë të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në fushën e shëndetësisë për projektin e vizitave shëndetësore në shtëpi, ku kemi përmisuar dhe rritur kapacitetet për funksionalizim më të mirëfillt, për përkujdesjen ndaj qytetarëve të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në krahasim me vitet e kaluara, duke rritur numrin e stafit profesional mjekësor të angazhuar 7 ditë të javës /13 orë, me dy ekupe mjekësore të përbëra nga 1 mjek dhe dy infermier, me dy vetura.
- Në bashkëpunim me UNICEF kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare dhe me të arriturat sipas planprogramit kemi shpërblyer me një automjet terreni për realizimin e vizitave shtëpiake

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës pa dallim etnie, gjinie, religjioni, race etj.

Raporti i shërbimeve shëndetësore janar – qershor 2024

❖ **Participimet**

- Numri i përgjithshëm i pacientëve që kanë participuar është: **20104**
- Pacientët që kanë participuar nëpërmjet marrjes së certifikatave është :**166**

Shërbimet në QKMF/QMF dhe AMF janë :**506053**

- Referimet :
- Personat me allësi të kulizu:**1061**
- Numri i përgjithshëm i vizitave shtëpiake për shtatzëne:**954**
- Fëmijët deri në moshën 3 vjeçare :**235**

❖ **Sëmundjet kronike :**

- Numri i sëmundjeve Malinje : **348 (të raportuar nga mjekët ne raporte mujore)**
- Numri i sëmundjeve kronike: **8932 (të raportuar nga mjekët ne raporte mujore)**

Në vitin 2024 janë kryer vizitat sistematike për nxënës nëpër shkolla: Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike:

	QKMF		1166		644	
	QMF-1	648	362	286	2186	
	QMF-2	171	92	79	505	
	Lumadh	131	69	62	502	
	Smrekonic	58	28	30	207	
	Pantine	54	37	17	179	

Njësia e SISH-it, QKMF në Vushtri është duke funksionuar me sistemin e ri i cili është me versionin e fundit.

Ministria e Shëndetësisë ka bërë shtrirjen e rrjetit për të gjitha QMF dhe AMF, po ashtu ka pajisur KPSH me pajisje kompjuterike dhe pajisje tjera të TI, është duke u punuar në vazhdimësi për implementimin e të gjitha qendrave dhe shpresojmi që gjatë vitit 2024 të funksionalizohet SISH-I në të gjitha institucionet e KPSH-së.

Spektori i Shëndetit Oral Preventiv, Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsejtë 4324 pacient dhe ka dhënë 19254 shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllobbimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora 07^h deri në ora 20^h në QKMF dhe në QMF1, ndërsa dy herë në javë në QMF2 dhe QMF3 nga ora 07^h deri ne ora 14^h, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora 07^h deri ne ora 19^h.

Shërbimi i Urgjencës

- Gjatë Janar – Qershor 2024. Në Urgjencë shërbimet janë 24^h dhe punohet cdo ditë të javës. Në këtë shërbim janë të angazhuar katër ekipe që punojnë me ndërime 12 orësh, janë të angazhuar 5 mjek dhe 17 infermier, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita. Urgjenca transporton pacientet nga vendi i ngjarjes deri në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtri e nëse kërkohet ndihmë nga Emergjencia e spitalit, transportoen pacientët sipas nevojë në SHSKUK Prishtinë. Në disa raste ofrojnë vizita dhe shërbime shëndetësore edhe në shtëpi, kur gjendja e pacientit është e rënd.

Spektori diagnostikues

Laboratori se bashku me Rëntgenin bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës.

Në vijim do gjeni informacionin në formë tabelare lidhur me pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime dhe kanë marrë shërbime shëndetësore në Laboratorin e QKMF-së

Raporti 6 mujor I RTG								
	Gjithësejt	M	F	Participimi	Exp	Filma	CD-ja	SHERBIME
Janar	488	230	258	127	825	131	464	1420
Shkurt	498	218	280	101	978	126	447	1551
Mars	466	234	232	76	834	77	450	1357

Prill	519	225	294	99	1030	82	499	1611
Maj	584	264	320	105	1106	74	586	1767
Qershor	478	227	251	81	889	366	36	1387
Gjithsej;	3033	1398	1635	589	5662	526	2482	9093

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 në shërbimin e RTG puna ka ecur mirë nëpër gjithësi, shërbimet në kabinetin e rentgenit janë kryer me kohe dhe pa termine ndërsa nga data 01.05.2024 puna është organizua me dy ndërrimet 7-13 dhe 13-19^H ku janë të angazhuar 4 puntore, pacientet janë shërbyer me filma dhe CD furnizimi me material harxhues ka qenë i mirë.

Laboratori:

Nr.	Periudha kohore	Totali	Meshkuj	Femra	Pacient që kanë Participu	Shërbim	Përqindja/participim
1	Janar	1420	576	844	342	16691	24.08%
2	Shkurt	1591	647	944	366	18807	23.00%
3	Mars	1285	518	767	278	13577	21.63%
4	Prill	1384	586	798	329	16182	20.93%
5	Maj	1609	669	940	362	19227	20.44%
6	Qershor	1174	480	694	261	12589	22.23%
	Totali	8463	3476	4987	1938	97073	0

Kemi hasur në vështirësi për furnizim me reagensa ku ka pasur vonesa, për të cilat kemi raportuar në DSHPS dhe Drejtorinë e Prokurimit, po ashtu kemi udhëhequr raportet e veçanta me të cilën kemi paraqitur vonesat.

Tani kemi kontratën për servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore dhe që nga themelimi i kësaj kontrate ne jemi në gjendje shumë të mirë sa i përket pajisjeve mjekësore. Por ende mbetet mungese e disa materialeve për shkak anulimit të kontratës ku O.E ka dështuar në furnizim.

Barnatorja Qendrore

Për shkak të mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës përmes kontratës kornizë me furnizuesin "MEDPLUS ShPK":

Nr.	Vlera e blerjesë €
1	10,564.50
2	1787.30
3	998.80
4	15,814.75
5	29,165.35

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë vitit 2024 ka bërë shpërndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrisë, në interval të caktuara kohore, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

Ne kemi inicuar të gjitha projektet kapitale të parapara me planin e prokurimit dhe jemi në fazën e realizimit të projekteve kapitale andaj të gjitha do të paraqiten pas realizimit.

Shtëpia Rezidenciale Lumadh

Në Shtëpinë Rezidenciale janë gjithsej 12 rezident. Janë kryer kontrole të rregullta shëndetësore. Gjendja shëndetësore e Rezidentëve është stabile përjashtimit disa gripa sezonal tek disa prej pacientëve si dhe me disa probleme dentare të cilat janë evidentuar në QKMF-ne e Fshatit Lumadh.

Rezidentët në Shtëpinë Rezidenciale nuk kanë qenë aktivë në aktivitetet e ndryshme ditore dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje stafi është angazhuar çdo ditë të kenë ndonjë aktivitet.

Kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë rreth numrit të rezidentëve i cili duhet të raportohet në baza mujore.

-Nga Qendra për Përkujdesje Sociale këtë periudhë kohore nuk kemi pasur asnjë kërkesë për vendosjen e rezidentëve të ri në institucion. Vizita tek rezidenten nga QPS-te kanë qenë vetëm nga komuna e Skenderajt dhe e Mitrovicës.

Qendra për Punë Sociale

Pranë QPS-së, Vushtri në Asistencë Sociale janë 1169 familje, prej tyre 1119 familje me 4850 anëtarë. Gjatë këtij viti janë parashtruar 35 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 20 janë aprovuar kurse, 15 prej tyre janë refuzuar si familje, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa janë riaktivizuar 6 familje. Asistenca sociale i është ndërprerë 69 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzues të asistencës sociale.

Gjatë kësaj kohe të raportimit janë shpërndarë ndihma në pako për shfrytëzuesit e ndihmës sociale përkrahur nga organizata të ndryshme Organizata Relief Islamic ka shpërndarë 150 pako ushqimore si dhe Ambasada e Shteteve Arabe 100 pako ushqimore.

Administrata

Zyra e Gjendjes Civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-Qershor i ka pranuar mbi 32992 kërkesa të qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme dhe për të gjitha këto ka ofruar përgjigje dhe shërbime në mënyrë efektive dhe efikase duke vendosur për së cilën kërkesë veç e veç.

Trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit, profesionalizmit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesit të digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendjes civile dhe harmonizimit të procedurave në ofrimin e shërbimeve dhe të lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile.

Zyra e gjendjes civile i ka marr të gjitha masat që të zbatojmë vendimin e MAPL-së për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve të lindjes për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

Pasqyra tabelare;

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	2
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	23
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	16
3.	Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ	36
4.	Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik	15
5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	3
6.	Dëshmi të vdekjes	103
7.	Lajmërim dhe ç'lajmërim të adresës së vendbanimit	158
8.	Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes,	15
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes	6
10.	Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës	8
11.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë)	4
12.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	06
13.	Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës	10
14.	Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë	4
15.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë) si pjesëtar i diasporës	10
16.	Regjistrime në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile për herë të parë dhe gjenerimin e numrit personal	47
Gjithsej regjistrime të bëra		466

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	15041
2.	Certifikata të lindjes	6348
3.	Certifikata të martesës	2828
4.	Certifikata të vdekjes	1668
5.	Certifikata të Statusit martesor	299
6.	Certifikata të shtetësisë	129
7.	Certifikata familjare	3104
8.	Certifikata të vendbanimit	2126
9.	Vërtetim nga arkivi	278
Gjithsej		31821

Regjistrime në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	68
2.	Martesa	264
3.	Regjistrime të vdekjes	186
4.	Regjistrime të Shtetësisë	9
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	92

6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	20
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	25
9.	Shkurorëzime	41
Gjithsejtë regjistrime të bëra		705

Ne këtë periudhë janë verifikuar **120** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri me **19.02.2013** janë të verifikuar apo të regjistruar në sistemin e gjendjes civile **101734** qytetar të komunës së Vushtrrisë.

Qendra për Shërbim me qytetarë

Qendra e shërbimeve me qytetarë në komune gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të qytetarëve të Vushtrrisë, duke iu dhënë informacionet e duhura mbi kërkesat e tyre, duke iu ndihmuar në përpilimin e kërkesave dhe duke ju përcjellë përgjigjet në kërkesa nga të gjitha drejtoritë.

Përveç aktiviteteve dhe detyrave të përditshme zyrtarët e qendrës së shërbimeve të qytetarëve kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorëve të tyre siç janë, menaxher të kontratave, komisione për vlerësim, komisione për pranim dhe në komisione të tjera sipas nevojave zyrtare.

Tabela e mëposhtme përshkruan numrin e kërkesave të parashtruara në drejtoritë komunale të cilat janë pranuar nga zyrtarët e QSHQ-se.

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 43977 kërkesa, prej të cilave janë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1	Drejtoria për Administratë	32992
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	3549
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1191
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	715
5	Drejtoria për Shërbime Publike	404
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1313
7	Drejtoria për Arsim	515
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	317
9	Drejtoria për Inspeksion	265
10	Personeli	713
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	232
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	214
13	Zyra Ligjore	1208
14	Kryetari i Komunës	158
15	Drejtoria e Prokurimit	12
16	Kuvendi i Komunës	37
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	5
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	3

19	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	134
20	Zyra për Integritet Evropian	0
		43977

Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Aktiviteti i Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ishte i përkushtuar në këto qëllimet kryesore:

1. Funkcionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës
2. Monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale;
3. Integriteti dhe ruajtja e të dhënave;
4. Mbështetja lidhur me përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të TI;
5. Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta

Përshkrimi i punëve, detyrave dhe intervenime të bëra	
Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e probleme softuerike.	86
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	234
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	131
Postime në ueb faqe dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare	11
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës si dhe konsultime për lekturim.	35
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulantë sipas nevojës të organeve komunale	75
Administrimi i depos, transaksione hyrje-dalje, transfere si dhe përditësimi i të dhënave të e-Pasurisë.	114
Riparime dhe punë të ndryshme për mirëmbajtje të objektit komunal.	170

Shërbime Publike

Furnizimi me ujë Sa i përket furnizimit me ujë të pijes, fabrika për prodhimin e ujit në Balinc ka vazhduar të operojë me orar të plotë 24 h në ditë. Është bërë rifunksionalizimi i pompave për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë për vendbanimet e pjesës lindore të komunës. Kemi vazhduar me implementimin e projektit për kyçjen e ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit dhe funksionalizimin e pompave në fshatin Smrekonicë dhe Sfaraqak, Pestovë, Ropicë për të rregulluar furnizimin e këtyre lokaliteteve me ujë të pijes.

Largimi i ujërave të zeza Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024, janë zhvilluar punimet për implementimin e kontratave dy vjeçare për ndërtimin e kanalizimit në fshatrat; Nadakoc Studime, Maxhunaj, Dumnicë, Beqok, Stroc, Mihaliq, Stanoc i Poshtëm, Akrahticë. Ndërsa është bërë ç'bllokimi i një numri të konsiderueshëm të gypave dhe pusëve të bllokuara, si fsh. Doberllugë, rr.

Adem Ademi në Vushtrri, fsh. Ropicë, Samadrexhë, Maxhunaj dhe një numër të konsiderueshëm të rrjetit të kanalizimit.

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen Përparimi.

Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, patë themeluar grupin teknik për hartimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave brenda regjionit, i cili plan është hartuar dhe pritët miratimi i tij deri në fund të vitit. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh.. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Bajsk dhe aktualisht i kemi vetëm gjashtë deponi të tilla.

Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „Përparimi” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit.

Është ky viti i dytë prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale „Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e luleve dekorative, mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimit publik.

Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2023.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar implementimi i kontratës – marrëveshjes për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik, implementimin e së cilës është duke u bërë nga Ndërmarrja Lokale „Përparimi”

Komunikacioni

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Në fushën e trafikut është hartuar paramasa dhe paralogaria për mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit dhe emërtimet e vendbanimit, me qëllim të krijimit të një rrjeti funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta, ndërsa është formuar grupi teknik që në bashkëfinancim me UN – HABITATIN të bëjmë hartimin e planit të mobilitetit sipas Marrëveshjes së nënshkruar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Vlera e projektit është 100,000.00 € prej të cilave 80% do të financohen nga UN- HABITAT.

Gjithashtu është shpallur konkursi për ndarjen e linjave të transportit urbano-periferik në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Gjatë periudhës së parë të vitit, ka vazhduar mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara përmes kontratës për rikonstruim dhe mirëmbajtje të rrugëve, me ç'rast janë riparuar mjaft segmente rrugore me asfalt dhe me kubza dhe të një numri të konsiderueshëm të pusetave dhe ndërrim të gypave të kanalizimit. Gjithashtu janë hartuar të gjitha paramasat dhe paralogaritë për inicimin e procedurave për ndërtimin e rrugëve me kubza betoni si dhe ndërtimin e trotuareve.

Urbanizmi

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjatë vitit 2024 fokus të posaçëm ka pasur fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024 pasi që të njetit i ka skaduar afati i paraparë ligjor. Tani jemi në fazën fillestare të hartimit të këtij plani, kemi kontraktuar edhe kompaninë konsulente përmes prokurimit publik me të cilën edhe kemi filluar takimet për fillimin e databazes së këtij dokumenti - PZHK-së 2024-2032.

Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e kanë përcjellë angazhime të shumta në shërbim të qytetarëve që kanë rezultuar me përfundimin dhe realizim e shumë projekteve kapitale përkatësisht ndërtimin e objekteve publike: shkollave, objekteve shëndetësore dhe projekteve tjera infrastrukture.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2024, kryesisht janë mbajtur takimet e organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban, pjesëmarrja ne konferenca te organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullim, takimet e rregullta me nivelin qendror rreth Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje i cili është në proces e sipër si dhe rritja e bashkëpunimit në mes të DUMM-së me drejtoritë tjera për qëllim të rritjes së profesionalizimit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta në dobi të Komunës së Vushtrrisë.

Sektori i Urbanizmit

Në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit gjatë këtij viti janë lëshuar këto Kushte Ndërtimore si në vijim:

1. Kushte Ndërtimore	8
2. Hedhur Poshtë	8
3. Refuzuar	1
4. Lëndët në Proces	5

Sektori i Lejeve Ndërtimore

Gjatë kësaj periudhe Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka lëshuar këto Leje Ndërtimore:

1. Leje ndërtimore për kategorinë I –rë janë lëshuar	4
2. Lejen ndërtimore për kategorinë II-të janë lëshuar	7
3. Leje Rrënimi	2
4. Në procedurë	4
5. Leje Mjedisore Komunale (LMK)	8

Taksa e inkasuar për Leje Ndërtimore është në vlerë prej **260524.05€**,

Leje Mjedisore Komunale është në vlerë prej **50777.84€**

Te legalizimi i objekteve inkasimi i të hyrave përfshinë vlerën prej **2039.59€**

Legalizimi i objekteve pa leje ndërtimi:

DUMM edhe pse me një numër mjaft të vogël të stafit është duke i shqyrtuar kërkesat për trajtimin e objekteve pa leje, ka pranuar 30 kërkesa të reja gjatë këtij viti ndërsa ka një numër të madh kërkesave ende të pa shqyrtuara nga vitet paraprake pasi që jemi në mungesë të zyrtareve përgjegjës.

Sistemi i adresave

Në respektim të Ligjit për sistemin e Adresave dhe Udhëzimeve Administrative të gjitha palët që kanë aplikuar për Leje Ndërtimore janë regjistruar edhe në Sistemin e Adresave ARIS.

Janë pranuar 136 kërkesa të parashtruar nga palët për konfirmim të saktë të adresave ku të gjithave ju është dhënë adresa e saktë.

Kulturë Rini Sport

QK "Hasan Prishtina"

Në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" punët kanë rrjedhë sipas planit, duke realizuar në tërësi planin e punës, por duke e plotësuar atë edhe me aktivitete të reja shtesë, të cilat ndonëse nuk janë paraparë në planin e punës, kanë dalë si rezultat i ideve të reja të stafit të drejtorisë sonë, apo edhe qytetarëve që janë marrë me aktivitete kulturore, por edhe institucionet tjera me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë këtij viti.

Stafi i Qendrës për Kulturë "Hasan Prishtina" gjatë këtij viti ka mbështetur apo ka organizuar të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë, qoftë nga organizatat rinore, grupet e intelektualëve apo shkollat e komunës së Vushtrrisë. Ne, në vazhdimësi kemi mbështetur, por edhe kemi marrë pjesë në organizimin e shumë takimeve letrare, si promovime të librave të ndryshëm në territorin e komunës sonë, kryesisht të autorëve vushtrrias. Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre, në Galerinë e Arteve në Qendrën e Kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e Qytetit "Adem Mikullovc".

Ndër aktivitetet kulturore që kemi organizuar apo që kemi marrë pjesë në organizim veçojmë:

Organizimi i ceremonisë për shpalljen e Sportistëve të vitit 2023;

Akademi përkujtimore dhe zbulimi i lapidarit për dëshmorin e kombit Mehdi Haziri;

Mbështetja në organizimin e Akademisë për Mehmet Konjuh;

Përgatitja e kushteve në Qendrën e Kulturës për shfaqje nga Teatri i Mitrovicës (pasi që objekti i teatrit në Mitrovicë ishte në rinovim);

Akademi Solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;

Ekspozitë e piktorit vushtrrias Ismet Bylykemi;

Përrurimi i librit "Rrezet e lirisë", i autorit Gani Lahu;

Organizimi i aktiviteteve për Epopenë e UÇK-së "Nata e zjarreve" me ushtarë të UÇK-së në fshatin Stroc;

Përgatitja e kushteve për organizimin e "Ditës së Mësuesit";

Përrurimi i librit "Aventurat në Mbretërinë Magjike" i autores Vushtrriase Alejna Selimi;

Aktivitet me fëmijët me Sindrom Down mbështetur nga Instituti Younus Emre;

Aktivitet i organizuar nga komuniteti turk dhe i mbështetur nga ana jonë;

Organizimi i një koncerti në Selanik të Greqisë, në bashkëpunim me shoqatën "Jeta" në Greqi;

Akademi përkujtimore dhe film dokumentar për dëshmorin Shemsi Istrefi;

Është shpallur konkursi për pranimin e poezive për Festivalin "Takimet e Poeteshave Shqiptare", janë pranuar poezitë dhe jemi në fazën përgatitore për organizimin e festivalit;

Koncert i përbashkët me austriakë, organizuar përmes mërgimtarëve shqiptarë në Austri;

Përgatitja e kushteve për ceremoninë e nënshkrimit të Kontratës Sociale, organizuar nga USAID;

Akademi Përkujtimore "Studimja '99";

Akademi Përkujtimore për nder të përkujtimit të masakrës së 22 Majit në Vushtrri;

Akademi Përkujtimore për Masakrën mbi Familjes Gërzhaliu;

Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të Ditës së Fëmijëve - 1 Qershori 2022;

Përrurimi i librit “ Monografi për Tafil Morinës”, i autorit Halil Mulaku;
Akademi Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë – 17 qershor 2022;
Ceremonia e diplomimit të gjimnazistëve vushtrrias;
Mbështetje në organizimin e 112 – vjetorit të ngritjes së flamurit në Vesekoc dhe Kuvendit të Kurillovës.

Biblioteka “Naim Frashëri”

Spektori i bibliotekës për periudhën janar-qershor 2024, ka evidentuar këto aktivitete:

Librat më të kërkua për lexim gjatë kësaj periudhe:

Spektori për fëmijë: “Verorja”, autor Rexhep Hoxha

Spektori për të rritur: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, i autorit Ismail Kadare

Libri shkencor i kërkuar gjatë kësaj periudhe: “Viciana – Vushtrria 1”, autor Izet Miftari;

Aktivitetet e punës në spektorin e bibliotekës së qytetit: “Naim Frashëri” Vushtrri:

Gjatë periudhës janar-qershor 2024 në bibliotekën komunale “Naim Frashëri” Vushtrri janë përpunuar 280 libra të ndryshëm, janë signuar 380 libra, janë vulosur 720 libra të tjerë, si dhe janë regjistruar në kompjuter 280 libra.

Në spektorin për fëmijë, gjatë periudhës janar-qershor 2024, janë dhënë 2444 libra për lexim.

Në spektorin e të rriturve, gjatë periudhës janar-qershor 2024 janë dhënë për lexim 1913 libra.

Sallën e leximit në bibliotekën komunale “Naim Frashëri” Vushtrri e shfrytëzuan 330 lexues, ndërsa gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore në bibliotekë janë regjistruar gjithsej 53 lexues të rinj. Gjithashtu janë dhuruar një numër i librave nga autorë dhe lexues të librave.

Muzeu

Në kuadër të punëve hulumtuese në terren janë vizituar shtëpi e familje nga komuna e Vushtrrisë, duke identifikuar dhjetëra eksponate të ndryshme nga fusha e etnologjisë, folklorit, teknologjisë dhe arkeologjisë. Eksponatet që u identifikuan gjatë takimeve dhe vizitave në terren janë të llojeve të ndryshme dhe kanë rëndësi të veçantë, andaj shumica prej tyre kanë premtuar se do ato eksponate do të dhurojnë muzeut, disa edhe janë dorëzuar dhe tashmë janë pasuri e muzeut.

Në kuadër të punëve në terren është vazhduar me punën hulumtuese në deponitë e metalit në Vushtrri, ku shpeshherë dërgohen eksponate shumë të rëndësishme nga metali në këmbim të të hollave minimale. Si rezultat i punës të hulumtimeve të hekurishteve janë identifikuar dhjetëra eksponate të cilat më pastaj u dhuruan në muze nga pronarët të cilët e kuptuar rëndësinë e tyre për muzeun dhe trashëgiminë kulturore.

Spektori i Rinisë

Takime pune dhe informuese me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore ku gjatë takimeve është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera, si dhe takime pune dhe bashkëpunim me OSCE.

Qendra Rinore “Hareja” ka mbajtur trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për të gra dhe vajza të grup moshave të ndryshme, në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrësve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve. Ky projekt është mbështetur nga IOM dhe është asistuar nga spektori i rinisë.

Organizata Rinore “Access” në bashkëpunim me spektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Takime pune me përfaqësuesit e “The Power of Mind” dhe KVRL-së ata kanë hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimt Rinor Lokal, Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhshme.

Takim me përfaqësuesin e OJQ “Lëvizjes Koha” me të u diskutua për projektet që parasheh të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje në fonde të donator të ndryshëm.

Është në realizuar projekti “Komuna për të Rinjtë” ky projekt është realizuar nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore si dhe organizatës facilituese CDF. Ky projekt ka pasur një ndikim të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shuma totale për mbështetjen e të rinjve në total ka arritur vlerën 250’000.00 dollar amerikan.

KVRL në bashkëpunim me organizatën “Domain for Kosovo” kanë mbajtur sesion informues për të rinjtë në shkollat e mesme, ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjve për themelimin dhe punën e KVRL-së si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

Trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore “Hareja” e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar Punë dhe takime të ndryshme me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve rinore.

Sektori i Sportit

Palestra e Sporteve Jeton Tërstena – Tota përdoret nga shumica e klubeve të regjistruara në Komunë dhe Federata gjegjëse si klube sportive, në këtë palestër përveç stërviçjeve, organizohen/luhen ndeshjet kampionale në shumë sporte, përveç shfrytëzimit të terminëve nga klubet palestra ndonjëherë shfrytëzohet edhe me pagës në harmoni me rregulloret e parapara. Po ashtu në këtë palestër zhvillohen edhe garat shkollore të cilat organizohen nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit.

Më datën (25.04.2023) është organizua turneu në basketboll (Streetball). Ekipet pjesëmarrëse kanë qenë katër (4).

Në komunën tonë janë të regjistruara (34 klube ,shoqata). Sukseset e klubeve të Vushtrrisë për edicionin garues 2023/2024 .

KLUBET SUPERLIGES

1. KLUBI FUTBOLLIT “VUSHTRRIA “ ka humbur mundësin që të bëhet anëtar i super ligës për këtë sezon dhe prapë ka mbet në Ligën së Parë të Futbollit.
2. KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka arritur që të jetë në super ligën e Kosovës.
3. KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA”(F) është shpallur nën kampion Super ligës për edicionin 2022/2023 dhe ka të drejtë përfaqësimi në arenën ndërkombëtare.
4. KLUBI HENBOLLIT “SAMADREXHA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë.
5. KLUBI HENBOLLIT “ SAMADREXHA” (F) ka garuar në Super ligë , dhe ka ruajtur statutin e Super ligës duke arritur që të jetë edhe pjesëmarrëse në garat ndërkombëtare.
6. KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë duke u renditur e dytë (2).
7. KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA BASKET” (F) ka garuar në Ligën e Parë dhe ka arritur që të jetë në vendin e tretë, gjatë edicionit garues 2023/2024
- 8.KLUBI VOLEJBOLLIT “ASVUSHTRRIA” (M) ka garuar në Super ligë , dhe ka mbetur në vendin e fundit në edicionin garues 2023/2024.
9. KLUBI VOLEJBOLLIT “AS VUSHTRRIA” (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arritur që të jetë në vendin e parë në Ligen e Parë Lindje, për sezonin 2023/2024.
- 10 . KLUBI VOLEJBOLLIT “VUSHTRRIA” (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arritur të ngjitet në Super ligën B.
11. KLUBI I FUTSALLIT FC “VUSHTRRIA” ka garuar në Ligën e parë, dhe ka arritur që të ruaj statutin në ligën e parë duke u renditur e dyta (2) në edicionin garues 2023/2024.

KLUBET E KATEGORIVE TË REJA

- 1.KLUBI FUTBOLLIT “ VUSHTRRIA “ Kampion U 18 , Liga Regjionale.

2. KLUBI FUTBOLLIT " VUSHTRRIA" Kampion U 17 , Liga Regjionale.
3. KLUBI FUTBOLLIT "EL CLASICO " Fitues i Kupës U 17 , Liga Regjionale .
4. KLUBI FUTBOLLIT " FORCA " Vendi I Dytë (2) , Liga Regjionale.
5. KLUBI VOLEJBOLLIT " AS VUSHTRRIA " Finalist , U 18 Teatri i Qytetit "Adem Mikullovcit"

Në muajin janar kemi filluar me projektin nëpër shkolla ,Teatri, Rinia dhe Edukimi

Në Teatrin e qytetit në Vushtrri ka filluar ligjërata me të rinjtë me temën: "Teatri, Rinia dhe Edukimi". Interesimi i të rinjve ishte shumë në nivel, ata u informuan për ecurinë e punës se si realizohet një shfaqje. Aktori dhe regjisori Fazli Muharremi i informoi të rinjtë se për të filluar një shfaqje në fillim regjisori duhet ta ketë tekstin e dramës për të vazhduar më tutje në ndarjen e roleve të aktorëve. Nga ana teorike interesimi i të rinjve ishte loja . Në vazhdim të rinjtë performuan në skenën e teatrit duke marrë sugjerime nga aktori. Nga ana diksionale të rinjtë mësuuan se si duhet të artikulohet fjalia duke e kuptuar se çfarë thotë aktori në skenë. Të rinjtë pasi morën disa detyra ushtrime arritën ta kuptojnë se si koordinohet loja skenike me tekst. U ndan të kënaqur me punën dhe angazhimin dhe do të vazhdojnë të jenë prapë në teatër.

Në bazë të kalendarit vjetor të aktiviteteve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport po vazhdon vizita në shkolla nga Teatri i Qytetit "Adem Mikullovcit". Ky aktivitet ofron një platformë për shfaqjen e aftësive artistike të nxënësve, duke përfshirë aktrimin, regjinë dhe skenografinë. Për më tepër, kjo ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe aftësive të komunikimit të nxënësve, duke i përgatitur ata për të ardhmen.

Tani me teatrin e të rinjve kemi filluar realizimin e komedisë Burri Burrë dhe presim nga fundi i muajit shtator ose fillimi i muajit tetor të shfaqet premiera e kësaj komedie

Inspektimet

Inspektorati i tregut

Gjatë kësaj periudhe janë inspektuar subjekte ekonomike :

- subjekte afariste ku frekuentimi i konsumatorëve është më i madh
- subjekte afariste me te vogla qe shesin mallra ushqimore
- subjekte afariste qe shesin mallra jo ushqimor (teknik të bardhë)
- Dyqanet e pa varura hoteliere, shërbyese
- Subjektet ekonomike lidhur me respektimin e orarit të punës të përcaktuar me Rregullore Komunale.
- Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve.
- Subjektet ekonomike të cilat merren me transportimin e mallrave, lidhur me dokumentacionin përcjellës për mallrat e tregtuar.

Me kërkesën e subjektit afarist "Proex" SHPK - Njësia "Depo", dhe në bashkëpunim me Inspektoratin e ATK -ës, janë asgjësuar produkte të ndryshme me afat të skaduar dhe të dëmtuar në sasi prej 16930 kg, kurse vlera e mallit arrin shumën 63,699.00 €.

Asgjësimi është kryer në prani të përgjegjësve të subjektit ekonomik në kompartorët e Ndermarrjes Publike "Unitetit" .

SUBJEKTE AFARISTE TE PAJISURA ME PËLQIM MBI PLOTËSIMIN KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE

Bartës i aktivitetit - Inspektorati i Tregut

APLIKUAR	51
TË VENDOSURA	49
TË REFUZUARA	2
Mjete të inkasuara në €	5,790.00 €

Malli i asgjësuar

Bartës i aktiviteit - Inspektorati i Tregut

Sasia e mallit të asgjësuar Kg.	16930 kg.
Të hyra nga malli i asgjësuar	1,200,00 €

Inspektorati i komunikacionit

Duke u bazuar në planin e punës së lartcekur si dhe në mbështetje të legjislacionit aktual në fuqi inspektorati i komunikacionit për këtë periudhë kohore ka lëshuar: procesverbale, vendime për pranime teknike të autotaksive, vendime për gjoba mandatore, ku dhe janë inkasuar mjete bazuar në vendimet. Me qëllim të përmirimit të gjendjes së transportit rrugor në teritorin e Komunës së Vushtrisë janë marrë masa konform dispozitave ligjore si dhe inspektimet janë kryer në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Stacioni në Vushtri:

Qëllimi i inspektimit :

- Mbikëqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarve dhe mallrave, që qarkullojnë në teritorin e Vushtrisë:
 - Inspektimi i Autotaksive;
 - Operatorët “Taksi”;
 - Ndermarrjet të cilat mirren me transport të udhëtarve;
 - Ndalimi i operatorve ilegal, masat e ndermarura ndaj tyre;
 - Kushtet teknike të automjeteve;
 - Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave;
 - Kontrollimin e vijave Komunale urbane dhe urbano-periferike.

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare:

Inspektorati	Nr. i kërkesave	Aktivite Inspektuese	Procesverbale	Urdhëresa	Aktvendime	Gjoha mandatore
Inspektorët e Komunikacionit	31	89	69	41	28	1

Inspektorati i Shërbimeve Publike

Aktivitetet inspektuese janë bërë në të gjitha pjesët e qytetit dhe në fshatra zhvillohen në harmoni Planin e Punës të hartuar nga Drejtoria Për Inspektime për periudhën 2024, sipas detyrës zyrtare dhe duke u bazuar edhe në ankesat e qytetarëve dhe me sygjerimin e Drejtorit të Drejtorisë për Inspektime dhe në bazë të njoftimeve nga institucionet tjera shtetërore.

Në mbështetje të legjislacionit aktual në fuqi. Inspektorati për shërbime publike komunale me qëllim të eliminimit të parregullsive kanë marrë masa administrative duke ndëshkuar qoftë personat fizik apo edhe juridik me qëllim të vetëdijesimit të tyre.

Në vazhdim po i paraqesim aktivitetet inspektuese edhe në formë tabelare:

Paraqitja e aktiviteteve në tabelë:

Procesverbale	86
Urdhëresa	39
Vendime	23
Gjoha	23
Gjoha të realizuara	16
Aktivite inspektuese	108
Shuma e mjeteve nga gjohat e realizuara	1,725.00 €

Inspektorati i ndërtimit

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike, si dhe gjetjeve nga ky hulumtim, Komunës së Vushtrrisë i rekomandohet që të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Sa më shumë përfshirje të punësuarve me aftësi të kufizuar
- Rritjen e sipërfaqeve, shesheve publike në m² për kokë banori;
- Përfshirje të punësuarve nga komunitetet joshumicë sipas përkatësisë gjinore;
- Rritja e % së vendbanimeve me rrjet të kanalizimit;
- Rritjen e % të vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza;
- Rregullimi i numrit të popullatës e cila përfiton nga skema sociale.
- Zbatimi i lejeve mjedisore,
- Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal,
- Sipërfaqja e komunës e mbuluar me plan të hollësishëm rregullativ,
- Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal,
- Përmeshja e standardeve minimale të konsultimeve publike,
- Hartimi i planit të mobilitetit
- Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit,
- Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme),
- Inkasimi i mjeteve për menaxhimin e mbeturinave;
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim marrëse.

Shtojcë: Raporti i Performancës së Komunës së Vushtrrisë, janar-dhjetor 2024 dhe Raporti i performancës së Komunave të Republikës së Kosovës 2023

Raporti përfundimtar i performances për viti 2023

Komuna Vushtrri

Raporti i performancës së komunës së Vushtrrisë përmbledh rezultatet e një procesi i cili ka përfshirë: Raportimin nga zyrtarët komunal: Zyrtarët komunal raportuan për performancën e vitit 2023 në Sistemin elektronik të menaxhimit të performancës komunale nga data 15.02.2024 deri në datën 11.04.2024.

Konsultim Paraprak: Kjo fazë është zhvilluar gjatë periudhës së raportimit nga komunat. Në këtë fazë zyrtarët e divizionit të performancës komunale të MAPL kanë udhëzuar zyrtarët raportues për plotësim/korrigjim të të dhënave të raportuar. Përgjigjet në komentet e ministrit janë vendosur në platformën e konsultimit dhe/ose në platformën e raportimit.

Verifikim me mostër: Pas përfundimit të procesit të raportimit nga komunat, u zhvillua një verifikim i detajuar i të dhënave për 27 treguesit e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale. Ky proces përfshinte analizën e dokumentacionit, të dhënave të raportuara dhe dëshmime të bashkëngjitura.

Verifikim në Terren: Për të siguruar vërtetësinë e të dhënave të raportuara dhe për të verifikuar zbatimin e tyre në terren, një ekip u angazhua për të kryer inspektimin fizik dhe monitorimin e aktiviteteve në vendet konkrete.

Rezultatet e performancës janë përfshirë në këtë raport, i cili ofron një pasqyrë të detajuar e performancës së komunave, përfshirë shënimet e konsultimit paraprak, verifikimit me mostër, verifikimit në terren dhe shqyrtimit të ankesave. Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë finale.

% E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE

SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	85.25
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	99.79
	1.1.3	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	100
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	100
	2.1.2	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	100
	2.1.3	Përbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	100
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	100
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	100
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	40
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	100
	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	100
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	14.88

	3.1.4	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	100
	3.1.5	Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxheti me pjesëmarrje	100
	3.1.6	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	33.33
	3.1.7	Funksionimi i këshillave lokal	50.02
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	100
	3.2.2	Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	100
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	100
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	92.31
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	81.17
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	75.07
	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	23.81
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	100
	3.4.2	Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	100
	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	25.41
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	4.1.2	Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale	69.36
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social	100
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	100
KULTURË, RINI DHE SPORT	5.1.1	Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	99.73
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	100
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	100
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	100
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës.	30
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	100
	7.2.2	Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	66.67
HAPËSIRAT PUBLIKE	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m2 publike për kokë banori	4.29
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	100
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	88.89
INFRASTRUKTURA RRUGORE	9.1.1	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	100
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	100
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	23.39
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	46.06
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzime vertikale dhe horizontale	37.98
	9.3.1	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	2.17
	9.3.2	Rrugë lokale të riasfaltuara	100
TRANSPORTI PUBLIK	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	0
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	81.82

	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	94.44
SHËRBIMET PUBLIKE	11.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	100
	11.1.2	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	100
	11.1.3	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	100
	11.1.4	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	100
	11.1.5	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	51.8
MBROJTJA E MJEDISIT	12.1.1	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	100
	12.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	100
	12.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	0
PËRFAQËSIMI GJINOR	13.1.1	Gratë e punësuar në institucione/administratë komunale	95.17
	13.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	70.73
	13.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	85.71
	13.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	100
	13.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	5.54
	13.2.1	Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjigshëm gjinor	100
	13.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	100
	13.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	49.36
	13.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	100
	13.3.1	Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve	20.09
	13.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	13.23
	14.1.1	Shkolla me masa të efçencë së energjisë	48.65
	14.1.2	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	100
14.1.3	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	85.41	
ARSIMI PARAUNIVERSITAR	14.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	71.89
	14.3.1	Fëmijë që vijnë kopshin - përgjithësi dhe rural	24.01
	14.3.2	Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	51.21
	14.3.3	Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	77.44
	14.3.4	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	99.99
14.3.5	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	97.55	
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR	15.1.1	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	74.08
	15.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	100
	15.2.2	Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	99.37
15.3.1	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	100	
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	16.1.1	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	100

	16.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	100
	16.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	100
	16.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	59.94

Ministria e Administrimit të
Pushtetit Lokal

Departamenti për Performancë dhe
Transparencë Komunale

RAPORTI I PERFORMANCËS SË
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
JANAR-DHJETOR 2023



2

0

2

4

Institucioni:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Mbikëqyrja:

Drin Haraqia, Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale MAPL

Pjesa e përgjithshme hartuar nga:

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;

Pjesa e veçantë nga:

Haxhi Krasniqi & Lazar Mitic

Mbledhja, përpunimi, verifikimi i të dhënave:

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;MAPL

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Shqiponja Vokshi DEMOS

Saranda Husaj, DEMOS

Blerta Sejdiu – Junior Konsulente/DEMOS

Edita Azemi – Praktikante/DEMOS

HYRJE	4
BAZA JURIDIKE PËR RAPORTIN E PERFORMANCËS	4
QËLLIMI	5
METODOLOGJIA	5
Kapitulli I	6
I. Performanca e komunave 2023 – Pjesa e Përgjithshme	6
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MATJES SË PERFORMANCËS KOMUNALE.....	6
2. TRENDET E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE NDËR VITE	7
REZULTATET E VITIT 2023	8
Kapitulli II	13
II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2023	13
1. REZULTATET E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE DHE TREGUESVE	13
Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative	14
Fusha 2 – Transparenca Komunale	14
Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale	16
Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare	19
Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport.....	20
Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive.....	21
Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor	22
Fusha 8 – Hapësinat Publike	23
Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore	24
Fusha 10 – Transporti Publik.....	26
Fusha 11 – Shërbimet Publike.....	27
Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit	28
Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinnor	29
Fusha 14 - Arsimit Parauniversitar	31
Fusha 15 – Kujdesi Primar Shëndetësor	32
Fusha 16 – Zhvillimi Ekonomik Lokal	33
Konkluzione dhe rekomandime	35
Shtojcë: % e treguesve sipas fushave	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Hyrje

Raporti i performancës komunale për vitin 2023 prezanton rezultatet e punës së komunave në 16 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 85 treguesve nga 93 sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale.

Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar treguesit e mundshëm dhe pezulluar 8 prej tyre. Për vitin 2023, raporti përmbledh 26 tregues më pak se për vitin 2022, kjo për shkak të rishikimit të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale i cili është bërë në vitin 2023.

Me kërkesën e zyrës së Kryeministrit dhe me aprovimin e Ministrit të MAPL-së, SMPK –së do t'i shtohet dhe një tregues që ka të bëjë me zvoglimin e Barrës Administrative në komuna. Ky tregues do të raportohet në vitin 2025.

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre është bërë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Qasje në këtë sistem kishin të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjites së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synon të pasqyroj dy aspekte kryesore të punës së komunave:

- 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet e vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Procesi i verifikimit të të dhënave është bërë në tri faza si në vijim:

- procesi i verifikimit peraparak i cili është bërë gjatë fazës së raportimit brenda 45 ditëve
- procesi i verifikimit të rregullt i cili sipas Dokumentit Kryesor përfshin 30% të treguesve e që gjithsej në këtë verifikim janë përfshirë 27 tregues në 12 komuna.
- procesi i verifikimit në teren në të cilin janë përfshirë 11 komuna me 5 tregues

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Për vitin 2023 kanë raportuar 34 komuna të Republikës së Kosovës¹.

Baza juridike për raportin e performancës

Matja e performancës komunale tashmë është ngritur në nivel të rregullimit ligjor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 08/I-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 12.08.2022. Në vitin

¹ Të dhënat nuk janë raportuar nga Komuna e Novobërdës, Zubin Poptokut, Leposaviqit, Zveqanit

2023, ka hyrë në fuqi Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe Skemën e grantit për performancë komunale.

Sipas nenit 19, të ligjit procesi i matjes së performances organizohet në baza të rregullta vjetore nga Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal. Në nenin 19 të Ligjit për SMPK dhe GPK, është i përcaktuar afati i raportimit të të dhënave komunale në SEMPK.

Për më saktë, "Procedurat dhe afatet tjera për matjen e performancës dhe vlerësimin për grant përfundojnë në pajtim me rregullat juridike që janë përcaktuara me Udhëzim Administrativ.

Referuar Ligjit Nr. 08/I-103, SMPK është i ndërtuar mbi bazën e parimeve themelore siç janë: Ligjshmërisë; Transparencës; Subsidiaritetit, meritës; objektivitetit dhe paanshmërsisë; Barazisë dhe mosdiskriminimit;

Udhëzimi përcakton të drejtën e autoritetit mbikëqyrës për të kërkuar informata të cilat i shërbejnë matjes dhe vlerësimin të performancës së komunave. Udhëzimi përcakton strukturat organizative përgjegjëse të komunave për raportim në kuadër të SMPK-së.

Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve të komunave brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.

Metodologjia

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është i ndërtuar nga MAPL në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar. MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

1. Funkcionalizimin e sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të performancës dhe mbajtjen e trajnimeve për të gjithë zyrtarët e komunave;
2. Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
3. Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
4. Mbrenda afatit për raportim është bërë verifikimin paraprak i të dhënave;
5. Adresimi i ndryshimeve eventuale në sistem, pas verifikimit paraprak;
6. Verifikimin e të dhënave me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në teren;
7. Verifikimin e rregullt sipas mostres prej 27 treguesve
8. Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
9. Përmbylljen e periudhës së ankesave;
10. Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së nga komunat, pas udhëzimeve/trajnimeve të organizuara nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

Verifikimi i të dhënave – sigurimi i cilësisë së të dhënave dhe verifikimi i tyre është bërë përmes disa metodave:

- Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;
- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Krahasimit me raportet e tjera zyrtare të MAPL-së;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna

Kapitulli I

I. Performanca e komunave 2023 – Pjesa e Përgjithshme

1. Vështrim i përgjithshëm i matjes së performancës komunale

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt i cili implementohet në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancës dhe kryetarët e komunave, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.

Matja shtrihet brenda kornizës së kompetencave të komunave sipas legjislacionit bazë dhe atij sektorial. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, në mënyrë që nga informacionet e fituara, të ndërtohen strategji për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2023 është realizuar në 16 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 93 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore². Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhmetin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

Edhe në vitin 2023 procesi i matjes së performancës komunale është bërë me anë të Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

2. Trendet e performancës së komunave ndër vite

Në vitin 2023, kërkesës për raportim të performancës janë përgjigjur 34 komuna, nëdërsa 4 komuna tjera nuk i kanë raportuar të dhënat në SMPK. Komuna e Novobërdes ka raportuar vetëm 31% të të dhënave. Rezultatet e tregojnë se niveli i të arriturave të komunave ndër vite varion prej 57.06% deri në 59.38%, në vitin 2022, kurse në vitin 2023 është 58.24%.

Duhet cekur se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht shtimit dhe zvoglimit të treguesve dhe të dhënave të reja. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale. Kjo rritje po ashtu është bërë për faktin se komunat kanë forcuar kapacitetet e tyre për përdorimin e sistemit të performancës, duke rritur kualitetin e të dhënave të raportuara. Analizat e përgjithshme tregojnë se disa tregues tanimë kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, që dëshmojnë për nivel të rregullsisë brenda rezultateve të synuara. Në anën tjetër ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunat akoma qëndrojnë në nivel të ulët të zhvillimit, për të cilët treguesit e matjes duhet të jenë prezent në një periudhë afatgjatë.

Më poshtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2020 deri në vitin 2023, si në vijim:




Fig.1. Performanca e komunave sipas viteve 2020-2023

² Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale

Rezultatet e vitit 2023

Sa i përket të dhënave për vitin 2023, performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha me 85, nga gjithsej 93 tregues të matjes është 58.24%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime më të ulëta se në vitin 2022, për 1.14%, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ndonëse ka një ngritje të lehtë të performancës në vitin 2023 prej 1.18%.

Mesatarja e përgjithshme tregon se komunat duhet të rrisin përpjekjet tyre për të përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen. Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (39.66%), infrastrukturë rrugore (42.45%), transport publik (46.93%), arsim parauniversitar (48.78%) barazia në punësim (49.71%) hapsia publike (51.59%), mbrojtja e mjedisit (52.56%), zhvillim ekonomik lokal (56.75%), dhe shërbime publike (58.05%), i cili shërbim është shumë afër me mesatarën e vendit.

Mbi nivelin mesatar të vendit janë shërbimet si në vijim: Shërbime publike Administrative janë në nivelin më të lartë prej 80.00% në nivelin vendi, e pasuar nga fusha transparenca komunale 73.02%, menaxhimi i fatëkeqësive me (69.30%) fusha kujdesi primar shëndetësor me 68.61% pasuar nga planifikimi hapsinor me 67.90%, fusha përgjegjëshmëria komunale ka vlerën 63.79% dhe Kultura Rina dhe Sporti janë shërbime të cilat janë shumë afër meastares së vendit ku janë ofruar në nivel të kënaqëshmëm që shprehur në përqindje janë 62.70%. Në grafikun Nr.2 shihet se 7 fusha të shërbimeve janë ofruar mbi mesatarën e vendit, ndërsa 9 fusha tjera janë ofruar nënë mesatarën e vendit që shprehur në % 43.75% të fushave janë mbi mesatare dhe 56.25% të fushave janë nënë mesatare.

Më poshtë është paraqitur figura me % e arritur të 16 fushave të matjes:

Fushat e performancës




Fig.2. Performanca sipas fushave

Ndarja e fushave sipas kategorive dhe niveleve të performancës, në kater nivele i kemi ndarë 16 fushat e qeverisjes nga komunat. Sipas grafikut më lartë, në nivel të lartë të performancës janë pesë (2) fusha të radhitura sipas përqindjes, shërbimet Transaparenca komunale dhe 73.02%, përktësisht 80.00% shërbimet publike administrative.




Fig. 3 Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

Ndërsa niveli i dytë përcatkohe sipas përqindjes e që fillon 62.70% deri në 69.30%, sikurse niveli i tretë sipas kategorisë përbën përqindjen 51.59% deri në 58.05% dhe niveli i katër ose i fundit sipas përqindjes fillon në 49.71 deri në 39.66%, sa ka edhe fuisha përfaqësimi gjinor. Nga kjo renditje shihet që nuk ka ndryshime të thjesuara nga viti 2022, edhe pse në vitin 2023 është rishikuar SMPK, edhe në vitin 2022 kanë qenë të renditura njësoj sipas performancës komunale, vetëm se vërehet një ndryshim i vogël specifik sipas përqindjes.

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

- 1) Standardet e qeverisjes së mirë
- 2) Ofrimin e shërbimeve publike

Nga figura 4 vërejmë që në kuadër të treguesve të qeverisjes të dhënat tregojnë se komunat kanë rritur efikasitetin në ofrimin e **Përfaqësimi gjinor**, prej 39.66.% që mund të quhet një arritje mjaft e konsiderueshme e komunave për vitin 2023. Në kuadër të fushës barazia në punësim, shërbime sociale dhe familjare niveli i përgjithshëm i arritjes shprehet me 49.71%³.

1) Standardet e qeverisjes së mirë

Në kuadër të **Shërbimeve publike administrative**, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 80.00%, Fusha Zhvillimi Ekonomik Lokal ka një nivel mjet të lartë që shprehet me 56.75% ku edhe kjo fushë krahasuar me vitin 2022 ka një ngritje të kënaqëshme prej 23.62%. Fusha **Transparenca komunale** për vitin 2023, shprehet me 73.02% në vitin 2023. Në fushën përfaqësimi gjinor për vitin 2023, mund shihet në figurën Nr 4, dhe ka vlerën 39.66%

³ Per me teper: <https://mapl.rks-qov.net/ep-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale- designed-18.02.2021.pdf>, fq. 62




Fig. 4 % e arritur në fushat e qeverisjes

Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e përgjegjshmërisë komunale, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e publicitetit për aktivitetet dhe të dhënave zyrtare, përgjegjshmëria komunale inkorporon të dhëna që tregojnë për nivelin e llogaridhënies së organeve komunale, si dhe aktivitetet e tyre për përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Në vitin 2023 këto dy fusha kanë shënuar rënje, ndoshta për faktin se në vitin 2023 është bërë rishikimin i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe si rrjedhojë janë hequr disa tregues të këtyre fushave. Kjo mund të themi që është një indikacion i rënjes së ofrimit të shërbimeve tek këto dy fusha.

Në kuadër të veprimeve që **ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal** komunat kanë performancë me nivel të përgjithshëm të të arriturave në shkallën 56.75%, edhe kjo fushe ka nivel të njëjet të aritjes së performancës krahasuar me vitin 2022.

Shërbime Publike- Në kuadër të kësaj fushe përfshihen tregues dhe të dhëna për ujë të pijshëm, menaxhim të mbeturianve dhe kanlizimet. Rezultatet e kësaj fushe shprehur në përqindje janë të kënaqëshme dhe kanë vlerën prej 58.05%

Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare - Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cënueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 49.71%, krahasuar me 60.30% në vitin paraprak.

2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: Shërbime publike, mbrojtje të mjedisit, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, mirëmbajtje të rrugëve, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjzim të rrugëve etj.




Fig.5. Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2023

Fusha, **Kulturë, rini dhe sport**, për vitin **2023** ka shkallën më të lartë të ofrimit të këtij shërbimi në nivel të gjitha komunave, e shprehur në përqindje në vlerën prej 62.70%, e pasuar nga sikurse edhe fusha e **Arsimit parauniversitar** si kompetencë vetanake komunale ka një renditje të mirë sa i përket ofrimit të rezultateve në ofrim të shërbimeve komunale me 48.78%. **Planifikimi Hapsinor**, renditet e katërta sa i përket listës së ofrimit të shërbimeve kualitative e cila është shprehur %, ka vlerën 67.90%, dallim të vogël vërejmë edhe në fushën **Infrastruktura rrugore**, e cila në përqindje ka vlerën prej 42.45%, me pas renditet fusha **Menaxhimi i fatkeqësive**, e cila është shprehur në pëqindje në vlerën prej 69.30%. **Mbrojtja e mjedisit** ka nivel mesatar të ofrimit për të gjitha komunat dhe ka vlerën prej 52.26%, e pasuar nga fusha e **Kujdesit parësor shëndetësor**, e cila në përqindje ka vlerën prej 68.61%.

Në nivel pak më të ulët është fusha si në vijim, duke filluar nga fusha **Hapësirat Publike**, 51.59%, fusha e **Transportit Publik** ka vlerën prej 46.93%.

Kapitulli II

II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2023

1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2023 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 34 komuna, megjithëse shkalla e pavlefshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës.

Sqarim: Në vijim të raportit, llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 16 fushat e tjera, në vitin 2023 kjo fushë radhitet e para për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 80.00%. Komuna e Deçanit ka nivelin maksimal më të lartë të realizimit të këtij shërbimi prej 100%.




Fig. 6 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Përmes tre treguesve në SMPK. Treguesi: kërkesa administrative të shqyrtura gjatë vitit shprehur në % janë 87.62% sikurse kërkesa administrative të shqyrtura brenda afateve ligjore janë 84.79%, kurse shërbime administrative të ofruara online janë po ashtu 67.58%




Fig. 7 Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

Fusha 2 – Transparenca Komunale

Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kritereve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.

Performanca e përgjithshme e arritur në këtë fushë është 73.02%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 85.78%. Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në publikimin e dokumenteve të prokurimit publik shprehur me 67.60%.




Figure 8 Treguesit e performancës në fushën e transparencës

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 72.15%, krahasuar me vitin paraprak prej 85.74%, ose 13.59% më pak në vitin 2023. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përbushur në masën 80.59%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 86.11%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 81.64% ose 3.78% më shumë se në vitin 2022.

Po ashtu, komunat kryesisht kanë qenë efikase në publikimin e buxhetit të komunës si dhe raporteve të shpenzimeve, ne nivelin prej 65.29%. Sa i përket publikimit të planit vjetor të




Fig. 9 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës komunale prokurimit publik.

Figura e mësipërme tregon për 16 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 90-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Gjakovë (100%), Glogoc (100.00%),Kaçanik (100%) Lipjan (100%) Rahovec (100%) Skenderaj (100%) Suharekë (100%). Nën nesataren e vendit sa i përketë ofrimit të këtij shërbimi nga komunat vlen të theksohe se 22 komuna janë mbi mesatare, ndërsa 12 komuna nën mesatare, gjë që traspaparenca e organeve komunale është në fokus të komunave.

Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale ka gjithsej 10 tregues, të aplikuar në vitin 2023. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 63.79%. Në kuadër të kësaj fushe, vërejmë performancë të lartë të komunave në ndërmarrjen e veprimeve ligjore. Komunat kanë treguar performancë pozitive edhe në diskutimin e projektbuxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve, që shprehur në përqindje është 84.21%, në këtë tregues komunat janë treguar të suksesshme.

Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në komunë




Figure 10 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2023, mbetet e ulët edhe përkundër standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili është përmbushur në shkallën 26.08% krahasuar me vitin paraprak që ishte 32.47%, apo 6.39 më e ulët se në vitin paraprak. Te ky tregues vërehet një rënie e lehtë në vitin 2023.

Sigurimi i llogaridhënies dhe respektimi i afateve ligjore në proceset e Kuvendit Komunal




Figure 11 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 89.50%. Treguesi i për nivelin e adresimit të rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 46.05%, ky tregues ka nivel mesatar të ofrimit edhe në vitin 2022 ka pas ofrim të përafërt. Treguesi i pagesave brenda afateve ligjore prej 30 ditësh në përqindje i shprehur 73.94%, sikurse, Treguesi për nivelin e zbatimit të planit të prokurimit ka vlerën prej 89.50%.

Performancë të mirë komunitet kanë edhe sa i përket treguesit, pezullimi i zyrtarëve në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre që ka vlerën prej 93.94%, ka dëshmon se komunitet nuk kanë pas suspendime sa i përket aktakuzave eventuale në shërbimin civil komunal. Komunitet ende qendrojnë jo mirë në hartimin e planeve për integritet dhe miratimin nga kuvendi, vlera e treguesit është 52.94%, kjo vlerë mbetet e ulët.




Figure 12 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal




Figure 13 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal




Figure 14 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Performancën më të lartë në indikatorët e kësaj fushe e ka arritur komuna e Rahovecit (94.85%) Glllogoc (93.28%) Lipjanit (92.72%), Suharekës (90.42%) Skenderaj (88.56%) dhe Hani Elezit (87.85%) Ndryshe nga to, më ulët qëndrojnë komunat: Mitrovica e Veriut, Partesh, Mamushë, Graçanicë, Prishtinë dhe Ranillug, Shtërpçë. Në nivelin të performancë në këtë fushë, ka ndikuar edhe mos raportimi i të gjitha të dhënave për tregues nga komunat në fjalë.

Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 49.71%.




Figure 15 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare




Figure 16 Treguesit e performancës në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi, treguesi ka vlerën prej 26.88%. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për të gjitha komunat në kuadër të kësaj fushe: Përqindje me e lartë është shënuar në dy tregues, Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 43.32% dhe fëmijë në nevojë që iu është siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 73.71%. Treguesi sa i përket zyrtarëve publik të punësuar nga komuniteti jo shumicë në institucionet komunale ka vlerën 44.31%.

Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive.

Fusha matë performancën duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 62.70%. Vlenë të theksohet se 11 komuna kanë vlerë maksimale të ofrimit të këtij shërbimi prej 100%, ndërsa 6 komuna mbetën në vlerën 0 për këtë shërbim.




Figure 17 Treguesit e performancës në fushën kulturë, rini dhe sport

Treguesit, aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes është 57.82%, kurse hapësira për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banoreve në komuna është 67.58%.




Figure 18 Treguesit e performancës në fushën e kulturë, rini dhe sport

Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 69.30%. Rezultate maksimale prej 100% në vitin 2023 kanë arritur 14 komuna në menaxhim efikas të faktëkeqësive, ndërsa në nivel minimal mbeten 4 komuna, kurse mbi mesatare të vendit janë 18 komuna.



Fig. 19 Krahasimi i performancës së komunave në fushën menaxhimi i fatkeqësive

Niveli i realizimit të treguesve për këtë fushe është si vijon: Intervenimet e për mbrojtje nga fatkeqësitë ka përqindjen 78.91% ndërsa në nivel mesatar të realizimit mbetet treguesi për realizimin e planit komunal për menaxhimin fatkeqësive prej 59.68%, krahasuar me vitin praparak është më e lartë prej 36.93%. Kjo tregon që komunat në vitin 2023 i kanë kushtuar rëndësi realizimit të planit për reagim emergjent.




Fig. 20 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimi fatkeqësive

Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 67.90%.




Figure 21 Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 50.72%. ose 24.3% më e lartë se në vitin praparak 2022. Sa i përket lejeve ndërtimore nga komunat u shqyrtuan me kohë 92.68%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimi inspektuar në shkallë prej 77.49%.



Figure 22 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor

Nivel maksimal prej 100% për këtë shërbim kanë ofrur 6 komuna, ndërsa 15 komuna janë mbi mesataren e vendit, kurse vetëm Komuna e Mitrovicës së Veriut mbetet në nivelin minimal e vlerësua me 0.

Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 51.59%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike.




Figure 23 Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik. Për nivelin e përbushjes së treguesve referojuni figurës së mësipërme.

Sipas të dhënave rreth 62.78% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 65.84% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik. Siperfaqe të gjelbra për kokë banori në m2 janë 26.15% në nivel vendi.



Figure 24 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike

Sipas të dhënave të raportuara nga Komunitat në nivel maksimal prej 100% janë 4 komuna të cilat e kanë ofruar këtë shërbim për qytetarët e vet, ndërsa për 6 komuna ende mbetet sfida ofrimi i këtij shërbimi dhe si rrjedhojë janë vlerësuar me 0.

Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Fusha është plotësuar me tregues të ri për të nxitur përmirësimin e infrastrukturës rrugore me trotuare, ndriçim, shenjzëmi si dhe shteg të biçikletave. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 42.25%.




Figure 25 Treguesit e performancës në fushën e infrastruktura rrugore




Figure 26 Treguesit e performancës në fushën e infrastruktura rrugore

Ajo çfarë e bënë performancën e përgjithshme të mos jetë aq e lartë, është përfshirja treguesit i ri për rrugët në zonat urbane me shtigje të biçikletave, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik. Nivelin e përmbushje së treguesve të kësaj fushe e kemi në tabelën më lart. Vlen të përmendet treguesi me nivelin më të ulët, rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave 9.24% ose 1.86% më e lartë se në vitin 2022, dhe treguesi me përmbushjen më të lartë prej 61.38% rrugët lokale të riasfaltuara.

Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:




Figure 27 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore

Komuna e Suharekës ka një nivel maksimal të ofrimit të këtij shërbimi për qytetarë, e pasuar nga komuna e Junikut dhe Obiliqit, ndërsa në nivel të ulët mbeten komunat, Mitrovica e Veriut, Shtërpcë, partesh, Klllokot dhe Deçan

Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 46.93 %.




Figure 28 Treguesit e performancës në fushën e transportit publik

Në kuadër të kësaj fushe performanca për tre tregues është pasqyruar në grafikun më lart. Sipas të dhënave vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik 65.23%, kurse vendndalimet e shënjzuara për automjetet e transportit publik qëndrojnë në nivelin 63.01% ose 2.29% më e lartë se në vitin 2022. Në nivel të ulët është përmbushur plani për transport publik i cili në përqindje është 12.54%, ky tregues edhe përkundër përpjekjeve të përbashkëta me komunat, mbetet i ulët po thuaj se në nivel të njëjët. Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 29 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik

Fusha 11 – Shërbime Publike

Kjo fushë është fuzionur me rastin e rishikimit të SMPK-së, dhe në vete përfshinë pesë 5 tregues, të ofrimit të shërbimeve publike si , Mbeturina, Kanalizim, dhe Ujësjellës, që shprehur në tregues janë si në vijim: Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave, realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit, Realizimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, Realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit dhe Realizimin e planit komunal për mbledhjen e mbeturinave. Performanca në nivel të fushës është 58.05%.




Figure 30 Treguesit e performancës në fushën e parkingjeve

Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave 75.87%, Realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit 35.29%, Realizimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 49.12%, Realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit 41.92% dhe Realizimin e planit komunal për mbledhjen e mbeturinave 88.04%.

Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.




Figure 31 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e parkingjeve publike

Komuna Suharekës ka arritur nivel maksimal të ofrimit të shërbimeve publike prej 100%, pasuar nga komuna e Rahovecit me 99.67%, e treta renditet komuna e Lipjanit me 99.45%. Ndërsa në nivel të ulët mbeten komunat si: Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Partesh, Malishevë, kjo mund të shihet në grafikun nr 31.

Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 52.56%.




Figure 32 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

Realizimi i planit të veprimit të mjedis del të jetë arritur në masën prej 48.69%⁴, ose 37.64% më e lartë se në vitin 2022. Kjo tregon për një seriozitet të komunave për trajtimin e planeve të veprimit në mjedis. Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 45.47% ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë mjaftë të ulët prej 63.52%.




Figure 33 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

⁴ Shumica e komunave nuk kanë dëshmuar ta kenë të hartuar Planin Lokal për mbrojtje të Mjedisit

Komunat, Dragash, Istog, Rahovec, Suharekë kanë vlerën maksimale prej 100%. Në grafikun më lartë mund të shihen edhe komunat të cilat kanë rezultate të kënaqshme të ofrimit të këtij shërbimi, ndërsa mesatarja e vendit është 52.56, ku mbi mesatare renditen 21 komuna dhe 13 komuna renditen nënë mesataren e vendit për këtë shërbim.

Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinor

Përfaqësimi gjinor matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktivitetet komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale, trupat e kuvendëve komunale etj. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendëve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar minimizojnë përqindjen në këtë fushë duke e bërë atë mjaft të ulët, 39.66%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinor sipas treguesve:




Figure 34 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor




Figure 35 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor

Përfaqësimi gjinor në procese të rëndësishme shoqërore në komunë

Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive

23.47

Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve

9.97

Figure 36 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor

Sipas të dhënave të raportuara nga 34 komunat, niveli i të punësuarve gra në institucione komunale është 78.20% në raport me kriterin 50x50. Po ashtu, Gratë të emëruara në pozita politike, është arritur 39.13% e kriterit ligjor. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 47.21% të përmbushjes së kriterit ligjor.

Përfaqësimi gjinor tek emrat e rrugëve komunale është tejet i ulët, shprehur në 9.97% po ashtu edhe regjistrimi i pronave në emër të një grua apo dy gjinive (bashkëshortë apo vëllezër dhe motra), është i ulët, 23.47%, ose 15.68% më e lartë se në vitin 2022. Te ky tregues vërehet një ngritje gjë që tregon edhe seriozitetin e Komunave në trajtimin e pronave.

Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor ka vlerën 69.12%. Me që ky tregues ka ende vlerë të ulët të përkrahjes nga komunat, megjithatë, ka nevojë mjaft të madhe për trajnim në këtë drejtim si dhe për vullnet të komunave që të kuptojnë rëndësinë e kësaj çështjeje. Barazia gjinore në programet për punësim, subvencione dhe ndërmarrësi është në shkallë prej 28.76%.



Figure 37 Krahasimet sipas komunave në fushën e barazisë gjinor

Nga grafiku shihet nevoja që Komunitat duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të investuar në programet për barazi gjinore dhe për të pëmbushur obligimet ligjore në aspektin e përfaqesimit institucional dhe politik. Kjo mund të shihet në grafikun më lartë

Fusha 14 - Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efikasitetit të energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësuesve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 48.78%. Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunitat nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlerë relative të saktësisë.




Figure 38 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi




Figure 39 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi

Fusha e arsimit ka me shume tregues por në grafikun me lart do ti paraqesim disa nga treguesit sipas përqindjes. Treguesi, braktisja e shkollës nga nxënësit, ku paraqitet shkalla inverse ka shënuar vlerën në 75.72%, Ndersa shkalla e realizimit te orëve te planifikuara sipas kalendarit vjetor te arsimit është përbushur 79.09%. Kalueshmëria ne testin e maturës kombëtare ka vlerën 61.72. Fëmij që vijojnë kopshtet ne zona rurale dhe urbane 14.22, kjo mbetet e ulet edhe përkundër përpjekjeve nga komunat. Shkolla me masa te efiqences së energjisë 64.38% edhe ky tregues vit pas viti po pëmbushet nga komunat. Sikurse treguesi siguria në institucionet e arsimit parauniversitar 49.21%, ky tregues ende ka nevojë të përbushet nga ana e komunave.




Figure 40 Krahasimet sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

Në grafikun Nr.40 mund të shihni rezultatet përbushjen e treguesve e shprehur në përqindje për secilën komune. Komuna e Fushë Kosovës ka nivel maksimal të përbushjes së treguesve. Mbi mesataren e vendit janë renditur 22 komuna, ndërsa nënë mesataren e vendit janë 12 komuna.

Fusha 15 – Kujdesi Primar Shëndetësor

Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuar për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 68.61%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:




Figure 41 % e treguesve në fushën e shëndetësisë primare

Treguesit nga kjo fushe janë shumë numër, por ne do ti prezantojmë ne paraqitje grafike disa nga këta tregues, sepse janë mjaft specifik dhe me shume interes për komunitat. Treguesi, fëmijë të përfshirë në programin e imunizimit është përbushur 74.62%, kjo është një përqindje e kënaqeshme, por duhet te shkoj në tendencë të rritjes në vitet e ardhshme. Sikurse ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra e fëmijë është përbushur 58.82%. Ndërsa tregues që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit te kushteve infrastrukturore janë si vijon: Objekte te KPS që janë te pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike janë përbushur 65.17%. Kurse niveli i pajtueshmërisë me raportin një mjek familjar edhe dy infermier për 2000 banore, në nivel te komunave është arritur 73.69%, krahasuar me vitin 2022 është më e lartë për 17.12 %.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunitat e Kosovës:




Figure 42 Krahasimet sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare

Fusha 16– Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo fushë mate aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit e tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 56.75% në vitin 2023.




Figure 43 e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Fusha e Zhvillimit Ekonomik Lokal është prezantuar nga 4 tregues ne grafikun me lartë. Plani pe zhvillim ekonomik lokal është përmbushur nga komunat 25.47%. Kurse niveli i mbledhjes se faturës se tatimit ne prone pa borxhe interes dhe ndëshkime është përmbushur në 47.23%. Përgatitja dhe publikimi i listës se pronave komunale ne shfrytëzim është përmbushur ne 82.35%. Kurse niveli i azhurnimit te regjistrimit te tatimit ne prone është përmbushur ne 71.97%.



Figure 44 Krahasimet sipas komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Në paraqitjen grafike në grafikun Nr. 44 janë prezantuar rezultatet e arritura nga komunat për fushën e zhvillimit ekonomik, vlen të thkesohet se mbi mesataren e vendit për vitin 2023 janë 21 komuna, kurse nënë mesatare janë 13 komuna. Komuna e Hani të Elezit ka arritur rezultatit maksimal prej 100% të treguesve për këtë fushë, renditet e dyta komuna e Vushtrrisë me 89.99%. Kurse e fundit ne realizimin e treguesve mbetet komuna e Mitrovicës së Veriut.

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2023, nxjerr të gjetura të shumta për 16 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

1. Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2023 është bërë për 34 komuna⁵. Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale dhe grantit për performancë. Komunat, Novobërdë, Zubin Potok, Leposaviç, dhe Zveçan nuk kanë raportuar për vitin 2023.
2. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë. Vlerësimi i komunave për vitin 2023 është bërë dhe është bazuar në dokumentin e rishikuar të SMPK-së.
3. Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.
4. Performanca është kategorizuar në dy grupe me tregues të cilës pasqyrojnë veprimet e komunave në funksion të qeverisjes së mirë dhe ofrimin të shërbimeve. Në kuadër të grupit të indikatorëve të qeverisjes, Shërbimet Administrative renditet e para, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. 26.08% e komunave kanë filluar me hartimin e këtyre raporteve, por edhe mbetet i ulët ky tregues të realizohet. Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen dhe të publikohen në platformën qeveritare të konsultimeve publike, me qëllim për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë bërje dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.
5. Prezenca e qytetarëve në konsultimet publike ka vazhduar të jetë e ulët. Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrësit, me fjalë tjera komuant duhet të marrin më shumë parasysh kërkesat e qytetarëve dhe që kjo të shërbej si rritje e besimit të qytetarëve në raport me komunat.
6. Performancë e ulët është treguar në fushën e përfaqësimit gjinor edhe në vitin 2023. Komunat duhet të ndërmarrin veprime për ta rritur numrin e grave në pozita vendimmarrëse, politike dhe në këshillat lokale. Po ashtu, duhet të përmirësohen dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor.
7. Një pjesë e komunave kanë filluar aplikimin online të shërbimeve administrative, performanca në këtë segment duhet të përmirësohet, për të ngritur efikasitetin në shërbime dhe me kosto sa më të ulët. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunat dhe për numër më të madh të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale etj.

⁵ Komunat: Novobërdë, Zubin Potok, Leposaviç, Zveçan..

8. Të dhënat për barazinë në punësim dhe shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të bëjnë përpjekje për përfshirje të të gjitha kategorive në nevojë në politikat e punësimin. Gjithashtu efikasiteti duhet të rritet në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;
9. Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësishme ose me harta zonale. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunës;
10. Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Komunitat duhet të rrisin cilësinë e të dhënave për nivelin e asfaltimit të rrugëve, trotuaret, ndriçimin e tyre, e sidomos tek të dhënat për shtigjet e biçiklistëve. Po ashtu, nevojitet planifikim më i mirë në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, në mënyrë që shtrirja me këtë shërbim të jetë e plotë.
11. 7.38% e të dhënave për shtigje të biçikletave në zonat urbane, është vlerë që tregon se komunitat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave.
12. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunitat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kritereve ligjore. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërkohet promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Komunitat duhet të të hartojnë planet për barazi gjinore. Po ashtu kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike, si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.
13. Komunitat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
14. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë eficiente, si dhe të jenë të pajisura me kabinate me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkon trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimin gjithë-ditor. Edhe në fushën e arsimit, është e domosdoshme të rritet cilësia e raportimit dhe saktësisë së të dhënave.
15. Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Komunitat duhet të hartojnë Planet për Zhvillim Ekonomik Lokal. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që të aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të renditen sipas kërkesave të shumicës.
16. Duhet të inkurajohen komunitat që të resepektohen rregullat ligjore, për ta ngritur cilësinë e raportimit dhe ngritjen e cilësisë së referencimit sa i përket dokumenteve adekuate për çeshtje të caktura.
17. Duhet tu bëhet me dije të gjitha komunave të Republikës së Kosovës se, përfromanca si instrument përveç që është mundësi për marrje të fondeve, është edhe obligim ligjor që të aplikohet raportimi i plotë për të gjithë treguesit.
18. Komunitat duhet të kenë parasysh hartimin e raporteve dhe dokumenteve ashtu qysh kërkohet me ligjet në fuqi dhe specifikisht për nevoja të raportimit në SMPK.

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	87.62
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	84.79
	1.1.3	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	67.58
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	72.15
	2.1.2	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	77.44
	2.1.3	Përbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	80.59
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	86.11
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	81.64
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	65.29
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	67.60
	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	55.88
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	26.08
	3.1.4	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	40.69
	3.1.5	Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxheti me pjesëmarrje	84.21
	3.1.6	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	28.91
	3.1.7	Funksionimi i këshillave lokal	19.36
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	75.29
	3.2.2	Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	72.79
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	60.29
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	69.20
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	89.50
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	73.94

	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	46.05
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	52.94
	3.4.2	Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	93.87
	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	26.88
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	4.1.2	Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale	44.31
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social	43.32
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	73.71
KULTURË, RINI DHE SPORT	5.1.1	Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	67.58
	5.2.1	Aktivite të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	57.82
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	59.68
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	78.91
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës.	50.72
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	92.68
	7.2.2	Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	77.49
HAPËSIRAT PUBLIKE	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m2 publike për kokë banori	26.15
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	62.78
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	65.84
INFRASTRUKTURA RRUGORE	9.1.1	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	47.38
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	41.45
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	28.43
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	48.69
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	54.73
	9.3.1	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	9.24

	9.3.2	Rrugë lokale të riasfaltuara	61.38
TRANSPORTI PUBLIK	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	12.54
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	65.23
	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	63.01
	11.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	35.29
SHËRBIMET PUBLIKE	11.1.2	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	49.12
	11.1.3	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	41.92
	11.1.4	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	88.04
	11.1.5	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	75.87
	12.1.1	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	48.69
MBROJTJA E MJEDISIT	12.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	45.47
	12.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	63.52
	13.1.1	Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale	78.20
PËRFAQËSIMI GJINOR	13.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	47.23
	13.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	39.13
	13.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	91.18
	13.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	6.00
	13.2.1	Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor	69.12
	13.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	28.76
	13.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	54.73
	13.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	47.06
	13.3.1	Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve	9.97
	13.3.2	Regjistrimi i pronësive në emër të dy gjinive	23.47

	14.1.1	Shkolla me masa të efçencë së energjisë	34.88
	14.1.2	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	49.21
	14.1.3	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	64.38
ARSIMI PARAUNIVERSITAR	14.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	41.01
	14.3.1	Fëmijë që vijojnë kopshtin - përgjithësi dhe rural	14.22
	14.3.2	Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	48.42
	14.3.3	Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	61.72
	14.3.4	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	75.72
	14.3.5	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	79.09
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR	15.1.1	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	65.17
	15.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	73.96
	15.2.2	Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	74.62
	15.3.1	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	58.82
	16.1.1	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	25.47
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	16.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim	82.35
	16.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	71.97
	16.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	47.23



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE /A:	03.09.2024
REFERENCË:	10 Nr. 96324
PËR:	Anëtarët e KPF-së dhe KK-së
PËRMES:	Kryetarit të Komunës z.Feri Idrizi
NGA:	Drejtori i DKA-së Albanez Tahiraj
TEMA:	Informatë për përfundimin e gjysmëvejtorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-068, për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 5, të Ligjit Nr.04/L-032, për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01.nr.209/2022, Drejtoria Komunale e Arsimit, paraqet këtë Informatë për përfundimin e gjysmëvejtorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024. Drejtoria Komunale e Arsimit, objektivat e veta të planifikuara, i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI-Prishtinë), me Sektorin e Inspektoratit në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit.

Përmbajta:

Për punën e Drejtorisë së Arsimit.....	3
Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat.....	4
Bursat dhe shpërblimet për nxënës.....	7
Garat, aktivitetet dhe të arriturat.....	8
Vlerësimet e jashtme	13
Donacionet	16
Aktivitetet për sigurinë në shkollat e Vushtrrisë.....	17
Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë 2023/24.....	18
Sfidat.....	20

I. Për punën e Drejtorisë së Arsimit

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor 2023/24. Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 24 janar 2024 ndërsa ka përfunduar për klasën 12 –të (maturantë) me datë: 16.05.2024, për klasat 9, 10, 11, më datë: 6.06.2024, për klasat parafillore dhe 1-8 –të më: 24.06.2024.

Informata të përgjithshme:

- Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore;;
- 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizikë e çila është në procedurë të pavarësimit;
- 3 shkolla fillore;
- 2 Shkolla të mesme të ulëta;
- 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta;
- 3 shkolla të mesme të larta;
- Numri i punonjësve: 1141;
- Numri i paraleleve: 651;

Numri i nxënësve:

- Niveli 0: (grup moshat 1-6 dhe çerdhet) 1148 fëmijë/nxënës;
- Niveli 1(klasa 1-5): 4882 nxënës;
- Niveli 2 (klasa 6-9): 4002 nxënës;
- Niveli 3 (klasa 10-12): 2265 nxënës;
- Gjithsej nxënës 12297 nxënës;

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/24, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë më qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

II. Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektin kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit;
- Takime të rregullta me MASHTI;
- Takime të rregullta me KFORIN slloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsimit;
- Në protokollin daljes janë regjistruar 626 shkresa;
- Në intranet janë regjistruara 337 dhe janë shqyrtuar 307;
- Në e-depo u regjistruan 56 hyrje dhe 56 dalje;
- Në të gjitha shkollat u shënua dita e internetit të sigurt;
- Pjesëmarrje në konferencën përmbyllëse të projektit ARISE, zyrtarët e DKA-së kanë qenë pjesë e panelit për të folur në për nivelin komunal për pabarazitë në arsim;
- U mbajtë aktiviteti "Drejt Malit - HIKING" me nxënësit kampion të garave komunale;
- Projekti KosEd 'Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë (2021-2025)', i financuar nga BE, në partneritet me MASHTI-n dhe Inspektoratin e Arsimit e ka mbështetur vlerësimin e brendshëm të 5 shkollave në dy vitet e fundit bazuar në Modelin kolegjial kosovar për sigurim të cilësisë. **Komuna e Vushtrrisë ishte komuna e parë** që filloi analizimin e të dhënave të prodhuara nga modeli kolegjial për ndërtim të kapaciteteve dhe që t'i përdor ato për të organizuar trajnime në të ardhmen. Raporti nga eksperti anglez Robert Blease;
- Është organizuar java e dyerve të hapura, ku nxënësit e klasave të IX-ta janë pritur nga shkollat profesionale. Të gjithë nxënësve ju është siguruar transporti;
- U mbajtë ligjëratë për klasat e X-ta nga FSK për pjesëmarrje në projektin "Edukimi për Siguri";
- U mbajt program artistik për nderë të 7 marsit- Ditës së mësuesit;
- Transporti i nxënësve është realizuar në 35 vija udhëtuese;
- Për 7 ditë nga data: 10 shkurt deri më 24 shkurt: 49 nx. të SHFMU "Migjeni" Stanoc dhe SHFMU- Nedakoc u përfshin në projektin "Drejt malit" në Brezovicë;
- SHFMU "Abdyl Frashëri" Druar; Në kuadër të këtij projekti të KosEd shkolla ka realizuar edhe trajnime me bazë në shkollë të cilat i kemi mbajtur dhe përfunduar me sukses ku në fund mësimeve janë certifikuar.
- Demolimi objektit të vjetër në SHMU-1;
- SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri me nxënësit Olisa Krasniqi dhe Rihana Hyseni, së bashku me drejtorin e shkollës Visar Sadriu, kanë qenë pjesë e konferencës përmbyllëse të programit IPA FF e cila është mbajtur në Bruksel. IPA FF shpërblen nxënësit, shkollën me mirënjohje për punën e bërë gjatë periudhës 3 mujore;
- SHFMU "Bahri Kuqi" Shtitaricë; përfituese e një projekti nga "Transformimi shoqëror inovativ" nga organizata Dokufes dhe KEC e quajtur KIST+ I financuar nga Mbretëria e Ambasadës Holandeze në Kosovë dhe me këtë kemi përfituar shumë nga Klubi Medial i shkollës, Gjatë aktivitetëve të tilla nga projekti Klubit ke fituar 180€ më pas

- nga organizata mbështetje me bashkëpunim me OJQ Shoqërinë Kulturore "Gjurmët" ka përfituar 500€;
- Në SHFMU –Pestovë u mbajt trajnim nga Qendra Psiko-Sociale për Traumatëri – Diakonie Kosova;
 - Në SHFMU –Pestovë Zyrën Qëndrore të IAP-së në Prishtinë, Departamenti për të Drejtat e Fëmijëve, ka organizuar Fushatë Informuese "Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit;
 - Bashkëpunimi me delegacionin turk nga INSTITUTI YNUS EMRA ku shpalosen planin e tyre dhe mbështetjen e plot financiare për nxënësit të cilët dëshirojnë t'i ndjekin mësimet në shkollimin e mesëm në Turqi;
 - Bashkëpunimi me OSBE tema: "Hartimi i Planit të Veprimit të Mekanizmit Koordinues kundër dhunës në familje" – Vizioni dhe Misioni I OSBE-së në Kosovë;
 - Pjesëmarrje në Forumin e III-të OZHQ-ve të organizuar nga INDEP në bashkëpunim me Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm ku u diskutuan zotimet e marra nga ana e Qeverisë në përmbushjen e IV zotimeve në mbledhjen e fundit të Kombeve të Bashkuara të cilat duhet të përmbushen deri në vitin 2030;
 - Këshilltarët nga zyra e kryeministrit, znj. Elizabeta Goëing, znj. Merita Januzi nga MASHT-I dhe z. Habit Hajredini përfaqësues I zyrës së mire (të gjithë nga NIVELI QËNDROR). Vizituan ekipin e DKA-së kundër braktisje dhe SHMU-2 si shembull i mirë i punës kundër braktisjes;
 - Në SHFMU "Liria" Stroc; Grupi letrar "Zëri ynë" ka zhvilluar takime letrare me anëtarët e Kravanit të Shkrimtarëve për Fëmijë: Xhevat Sylja, Ibrahim Kadriu, Prend Buzhala, Xhemë Karadaku, Erina Rrahmani, Jonuz Fetahaj, Gjon Gjergjaj, Ismet Krasniqi, Fazli Ferati dhe Idriz Berisha;
 - Drejtoria Komunale e Arsimit bashkë me SHMU-1 dhe psikologë të shkollave shënoi 1 qershorin "Ditën e fëmijëve";
 - Në SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri, është nënshkruar marrëveshja me të cilën SHMP "Bahri Haxha" do të jetë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin CultuVeting ndër shkollat e para publike e përfshirë në këtë program (gjate muajt Qershor është realizuar vizita e pare studimore ne Athinë);
 - Marrëveshje bashkëpunim në mes Drejtoria për Arsim ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile "Koralet", ku do të vazhdohet financimi i tri edukatoreve në tri qendra me bazë në komunitet. Ky bashkëpunim realizohet në tri shkolla, e që janë SHFMU "Migjeni" në Stanoc të Epërm, SHFMU "Nazmi Zhegrova" në Stanoc të Poshtëm dhe në SHFMU "Hajrullah Shala" në Akrashticë;
 - Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të QEHT –KONICA dhe DKA –VUSHTRI, ku janë trajnuar: 25 mësimdhënës nga cikli i ultë 25 mësimdhënës nga cikli i mesëm i ultë me trajnimin: "Planifikimi i mësimdhënies produktive", Metodologji interaktive e mësimdhënies;
 - Marrëveshje bashkëpunimi, në mes të DKA-së Vushtrri dhe SHPIK- Shoqata Profesionale e informaticentëve të Kosovës për trajnimin e gjithë mësimdhënësve për kodim;

- Në SHFMU “A.Z.Çajupi” Organizata “Teach For Kosova” ka organizuar punëtori 4 ditore me 10 mësues të shkollës. Qëllimi i punëtorisë është krijimi i një katalogu për edukim inkulziv, ka përfshirë aktivitete që kontribuojnë në gjithëpërfshirjen në klasa dhe do t’u shërbejë të gjithë mësuesve dhe ka realizuar projektin 1 vjeçar “Let Girls Thrive”, që ka të bëjë me barazi dhe drejtësi sociale;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet: DKA – Drejtorisë Komunale për Arsim, Komuna e Vushtrisë dhe FXHK – Federatës së Xhudos së Kosovës me programin “Kosova, Shtet i Xhudos” me shkollën SHMU-1 dhe SHMU-2;
- Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri, ka vazhduar projektin mësimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI dhe XII kanë kryer praktikën në vendin e punës;
- Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri, është pilotuar „Mësimi dual,, për 27 nxënësit e profilit „Tregtarë me pakicë dhe shumicë,, (ka pasë vështësi për shkak të mosgatishmërisë së bizneseve për të përbushur kontrat me nxënës ku parashihet edhe pagesa mujore); Janë pajisur me pajisje bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale kabinetet e kimsë, teknologjise ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri; 22 nxënës janë trajnuar dhe certifikuar në trajnimin „Zhvillimi i aftësive kreative për film dhe Animacion” tek të rinjtë” nga Instituti për zhvillim dhe integrim;
- Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri, kanë filluar përgatitjet për nënshkrimin e marrëveshjes për financim për grantin e fituar nga RCF (fondi rajonal i sfidave i cili financohet nga Qeveria gjermane dhe Zvicrane) në vlerën 410.000 euro;
- SHMP „Bahri Haxha” është përzgjedhur nga MZHE për digjitalizimin e procesit mësimor (do të kryhet gjatë muajit Korrik);
- Pjesëmarrja në projektin „Ndikimi i rinisë në mjedis” YENI I CARITASIT - „Ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike”;
- Në Gjimnaz Rregullimi i dyerve të tualeteve të shkollës;
- Në Gjimnaz Mbjellja e luleve në oborrin e shkollës;
- Në SHFMU „MiGJENI,, Stanoc i epërm është rregulluar kanalizimi në objektin e shkollës dhe jashtë saj deri në lidhjen e kanalizimit të fshatit;
- U rënë shkolla e vjetër në SHFMU – Pestovë;
- Në SHMU-1 u shtrua zhavor për parkingun e veturave;

III. Bursat dhe shpërblimet për nxënës

Informata të përgjithshme për bursa :

- Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/e për studime brenda vendit;
- Numri i bursave jashtë vendit - 17 (shtatëmbëdhjetë);
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës- 1000.00 € (një mijë) për student/e për vendet e BE-së;
- Përfitues të bursave sipas gjinisë: 59 janë studente, dhe 28 janë studentë;
- Gjithsej përfitues të bursës 87 studentë; me vlerës 56.600.00 euro
- Ndërsa DKA- Vushtrri: deri tash gjatë këtij viti ka subvencionuar 12 studentë të cilët i kanë kushtet e rënda ekonomike ose kanë vetëm njërin prind, ose prindërit invalid, me vlerë 4100 euro
- Studentë në Greqi – në York city çolge janë 4 studentë 2 baç dhe 2 master dhe janë subvencionuar 24.630 euro
- Gjithsej përfitues 103 studentë më vlerë 85.330.00 euro.

Shpërblimet e nxënësve;

- Më datë: 21.06.2024 DKA ka propozuar shpërblimet për nxënës pikërisht në fundin e gjysmë vjetorit të dytë ndërsa me datë: 24.06.2024 Kryetari i Komunës ka nxjerr vendim për shpërblime për nxënës;
- Për vendet e para: 42 nxënës me vlerë 4350€;
- Për vendet e dyta: 18 nxënës me vlerë 1475€;
- Për vendet e treta: 13 nxënës me vlerë 650€;
- Tri vende të para për 8 nxënës 600 €;
- Gjithsej përfitues 81 nxënës;
- 3 nxënës të gjimnazit janë financuar për udhëtime jashtë vendi me vlerë 2500 € Tauna Grabovci dhe Suela Selimi nxënëse të Gjimnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri, të cilat do të shkojnë për hulumtime shkencore në fizikë në Universitetin Santakruz - Kaliforni, dhe 1 nxënës Eriti Rushiti pjesëmarrës në gara republikane botërore të Fizikës e cila do të mbahet në Iran);
- 2 nxënës Lorik Rama nx. i Gjimnazit “Eqrem Çabej” marrin pjesë në Olimpiadë STEM në Hagë të Holandë , dhe Jonart Krasniqi nga SHF “Ali Kelmendi” Vushtrri dhe ju jepet ndihmë financiare 1800 €;
- Përmbledhje: Gjithsej janë në proces të shpërblimeve 92 nxënës me vlerë; 18275€

IV. Garat, aktivitetet dhe të arriturat

- Eko-klubi i SHMP "Bahri Haxha" ka fituar çmimin parë mjedisor „Dervish Rozhaja,, ne vlerën prej 10.000 euro ne garën me projekte mjedisore të mbajtur në fillim të muajit Qershor;
- Në garat e shahut organizuar nga Innovation Academy dhe Drejtorisë Komunale të Arsimimit (DKA) në Vushtrri nxënës i klasës së IV Ensar Salihu i SHFMU - Pestova, ka zënë vendin e parë në këtë garë;
- "Mozaiku Kulturor i Vushtrrisë në Pikturë" është titulluar ekspozita e artit që është organizuar nga Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me OJQ "ORDA", Në këtë garë individuale morën pjesë gjithsej 15 nxënës, ndërsa u shpërblyen tre prej tyre. Vendi i parë: SHMU-1 Vushtrri me nxënësen Yllka Podvorica, e cila u shpërblye me 100 euro;
- Në garat republikane të programit "SPORTI NË SHKOLLA" NË BASKETBOLL 3x3 në Sheshin Skënderbeu, Prishtinë u zhvilluan Garat Republikane të Programit "Sport në Shkolla", me pjesëmarrjen e 28 ekipeve të klasave 6-9 vajza dhe djem nga 14 shkolla të 7 regjioneve. SHMU-1 ka zënë Vendin e parë nga klasat VI dhe VII (Meshkujt);
- Në garën për esenë më të mirë të mbajtur në shkollën "Mehmet Akif", nxënësja e e SHFMU "Liria" Stroc nx. Rrezartë Aliu, ka zënë vendin e tretë.

Vendët e para:

1. **Edison Muhamet Haliti**, nxënës i klasës së XII, të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë në garat e diturisë lënda Biologjisë, është shpërblyer me 100 €; si dhe Vendi i tretë në garat e diturisë, lënda Kimi është shpërblyer me 50 € gjithsej **150 €**
2. **Rizonë Gani Hyseni**, nxënëse e klasës së XII, të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri vendi i parë në garat e diturisë, lënda Kimi është shpërblyer me 100 €; dhe Vendi i tretë në garat e diturisë, lënda Biologji është shpërblyer me 50€, gjithsej **150 €**;
3. **Erion Blerim Hyseni**, nxënës i klasës së XI, të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri vendi i parë në nivel Republikan me projektin Laviersi Matematik Digjital) është shpërblyer t me 100€;
4. **Abit Ilmi Hyseni**, nxënës i Gjimnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë në nivel Republikan me projektin Laviersi Matematik Digjital), është shpërblyer të shpërblehet me 100 €;
5. **Edon Gazmend Haradinaj**, nxënës i Gjimnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;

6. **Londin Ferki Syla**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
7. **Elvidon Bashkim Islami**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
8. **Arion Isa Muli**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100€;
9. **Eldi Adnan Mehulli**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
10. **Ensar Basri Begu**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
11. **Enkel Sami Ramiqi**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
12. **Erin Kadri Krasniqi**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
13. **Blend Arben Xhema**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
14. **Enes Bastri Caka**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
15. **Emir Xhevdet Muzaqi**, nxënës i Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
16. **Erti Driton Rushiti**; nxënës i klasës së XI/1 të Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, vendi i parë gara komunale të fizikës dhe vendi i tretë në gara republikane dhe merr pjesë në gara Evropiane është shpërblyer me **150€**;
17. **Redon Hashim Hajrizi**, nxënës i klasës së X të Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri vendi i parë nga gara komunale të fizikës është shpërblyer me 100 €;
18. **Endrit Resmi Gërxhaliu**, nxënës i SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri, vendi i parë, për klasa IX, në garat komunale të matematikës është shpërblyer me 100 €;
19. **Florent Fidaim Kelmendi**, nxënës i SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri vendi i parë, për klasa VII, në garat komunale të matematikës është shpërblyer me 100€;
20. **Sara Naim Pllana**, nxënëse e klasës së VI/2 të SHFMU "Bahri Kuqi" Shtitaricë vendin e parë në garën e gjinnastikës Salamunov Memorial që u zhvillua në Slloveni të organizuar nga Federata e Gjinnastikës së Kosovës, është shpërblyer me 100€;
21. **Jon Driton Krasniqi**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
22. **Dion Qamil Sahiti**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
23. **Shkëlqim Nazmi Deliu**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100€;
24. **Albin Afrim Grabanica**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
25. **Arbnor Fisnik Uka**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
26. **Gzim Naser Beqiri** nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;

27. **Dion Besim Fazliu**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
28. **Qamil Fatmir Hasani**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
29. **Mursel Ismet Hyseni**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
30. **Emir Muhmet Musa**, nxënës i SHMU-1, Vushtrri vendi i parë Futsall në garat republikane është shpërblyer me 100 €;
31. **Anisa Adhurim Kutllovci**, nxënës i kl IX të SHMU-2, vendi i parë në garat komunale të diturisë është shpërblyer me 100 €;
32. **Rita Agron Spahiu**, nxënës i kl IX të SHMU-2, vendi i parë në garat komunale të diturisë është shpërblyer me 100€;
33. **Melika Sedat Tiriqi**, nxënës i kl IX të SHMU-2 vendi i parë në garat komunale të diturisë është shpërblyer me 100 €;
34. **Brisilda Bashkim Ferizi**, nxënës i kl IX të SHMU-2, vendi i parë në garat komunale të diturisë është shpërblyer me 100 €;
35. **Aurora Beshir Aliu**, nxënës i kl IX të SHMU-2, vendi i parë në garat komunale të diturisë është shpërblyer me 100 €;
36. **Drijajt Fahri Merovci**, nxënës i kl IX të SHMU-2, vendi i parë në garat komunale të matematikës është shpërblyer 100 €;
37. **Laurent Selim Maxhuni**, nxënës i kl. VIII të SHMU-2, vendi i parë në garat komunale të matematikës është shpërblyer me 100 €;
38. **Ajdesë Kemajl Kadriu**, nxënës e SHMU-2 vendi i parë në garat e fizikës nivel komunal dhe vendi i dytë në nivel shtetëror është shpërblyer me 100€;
39. **RUBINA BEKIM SADIKU**, nxënës i klasës së V-të, SHFMU “ Emin Duraku” Novolan, vendi i parë në gara komunale të diturisë është shpërblyer me 100 €;
40. **ERINA BLERIM ZYMBERI**, nxënës i klasës së V-të SHFMU “ Emin Duraku” Novolan, vendi i parë në gara komunale të diturisë është shpërblyer me 100 €;
41. **ALDIN ADNAN HAJRIZI**, nxënës i klasës së V-të SHFMU “ Emin Duraku” Novolan, vendi i parë është shpërblyer me 100 €;
42. **Rona Nysret Beqiri**, nxënëse klasës VII të SHFMU “Hajrullah Shala” Akrashticë vendi i parë në garat eses është shpërblyer me 100 €;
43. **Siona Mustafa**, nxënëse e Gjinnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri ka arritur vendin e parë me 91 pikë, është shpërblyer me 100 euro;
44. **Anisë Kutllovci**, nxënëse e SHMU-2 Vushtrri ka arritur vendin e parë në testin e arritëshmërisë me 184 pikë, është shpërblyer me 100 euro

Vendet e dyta:

1. **Antigona Fahri Gashi**, nxënëse e klasës së XII të Gjinnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri; vendi i dytë në garat e diturisë lënda Biologjisë, është shpërblyer me 75 € si dhe për vendi i dytë në garat e diturisë, lënda Kimi të është shpërblyer me 75€ gjithsej 150 €;
2. **Aida Nexhmedin Kovaqi**, nxënëse e klasës X të Gjinnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri Vendi i dytë në garat komunale të lënda fizikës, është shpërblyer me 75 €;

3. **Elisa Enver Merovci**, nxënëse e kl.IX të SHFMU “Latif Berisha” Doberllukë, vendi i dytë në garat komunale të diturisë për klasat e IX-ta është shpërblyer me 75 €;
4. **Elira Qemaj Hasani**, nxënëse e kl.IX të SHFMU “Latif Berisha” Doberllukë, vendi i dytë në garat komunale të diturisë për klasat e IX -ta është shpërblyer me 75€
5. **Diona Nexhmedin Abazi**, nxënëse e kl.IX të SHFMU “Latif Berisha” Doberllukë, vendi i dytë në garat komunale të diturisë për klasat e IX -ta është shpërblyer me 75€; si dhe vendi i tretë në garat komunale të fizikës është shpërblyer me 50 , gjithsej 125 €;
6. **Emira Burhan Hasani**, nxënëse e kl.IX të SHFMU “Latif Berisha” Doberllukë, vendi i dytë në garat komunale të diturisë për klasat e IX -ta është shpërblyer me 75 €;
7. **Liza Driton Mustafa**, nxënëse e kl.IX të SHFMU “Latif Berisha” Doberllukë, vendi i dytë në garat komunale të diturisë për klasat,e IX -ta është shpërblyer me 75€ ;
8. **Adrian Baki Kuqi**, nxënësi i klasës së VII/1, të SHFMU “Bahri Kuqi” Shtitaricë, vendin e dytë në garat e matematikës në nivel komunal, është shpërblyer me 75€;
9. **Sara Nevzat Pllana**, nxënëse e klasës së VII/1 të SHFMU “Bahri Kuqi” Shtitaricë vendin e dytë me Esenë më të mire në nivel komunal është shpërblyer me 75 €;
10. **Arbesa Adem Hyseni**, nxënëse e klasës së V-të SHFMU “Bajram Curri” Dumnicë e Llugës vendi i dytë në garat komunale të diturisë , është shpërblyer me 75€;
11. **Erjona Afrim Abazi**, nxënësi i klasës së V-të SHFMU “Bajram Curri” Dumnicë e Llugës, vendi i dytë në garat komunale të diturisë , është shpërblyer me 75€;
12. **Lorisa Besim Abazi**, nxënëse e klasës së V-të SHFMU “Bajram Curri” Dumnicë e Llugës vendi i dytë në garat komunale të diturisë, është shpërblyer me 75€;
13. **Vjosa Sabri Mustafa**, nxënëse e SHFMU “Martiret” Reznik në Olimpiaden në garat e Matematikës, vendi i dytë në nivel komunal, është shpërblyer me 75€;
14. **Eris Safet Sylja**, nxënësi i kl. VIII të SHMU-2 vendi i dytë në garat komunale të matematikës është shpërblyer me 75€;
15. **Erita Suad Kajtazi**, nxënëse e kl.IX të SHFMU “Enver Hadri” Smerkonicë ,vendi i dytë në gara komunale të fizikës (me pikë te njëjta tre kandidatë është shpërblyer me 75€;
16. **Igaballe Qefeser Hajrizi**, nxënëse e klasës së IX të SHFMU “Abdyl Frashëri” Druar vendi i dytë në garat komunale të fizikës (me pikë te njëjta tre kandidatë është shpërblyer me 75€ ;
	<p>- Abeja dhe Vëllezërit Feka" lot 1, është nënshkruar kontrata në vlerë 788,251€, derisa pagesat gjatë vitit 2023 dhe projektionet buxhetore me ligjin e buxhetit të vitit 2024 në total janë 558,252€, duke tejkaluar buxhetin e dedikuar për këtë projekt për 219,999€.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për ndërtimin e rrugës "Lumni Surdull" lot 2, është nënshkruar kontratë në vlerë 685,260€, derisa pagesat gjatë vitit 2023 dhe projektionet buxhetore me ligjin e buxhetit të vitit 2024 në total janë 539,757€, duke tejkaluar buxhetin e dedikuar për këtë projekt për 145,503€. <p>Gjithashtu, në tri (3) raste vlera e kontratave të nënshkruara për mallra dhe shërbime kishin tejkaluar vlerën e planifikuar me planin</p>		<p>Komuna e Vushtrris do të siguroj lëndet djekse per objektet shkollore, ne nje period me te hershme per furnizim.</p>		
--	--	--	---	--	--

		<p>viëtor të prokurimit, si në rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me lëndë djegëse - dru lot1, vlera e planifikuar 141,581€, derisa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 283,420€. • Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, vlera e planifikuar 30,500€, derisa kontrata ishte nënshkruar në vlerë indikative 60,000€. • Furnizim me material pedagogjik, vlera e planifikuar 16,000€, derisa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 21,388€. 				
12.						
13.	<p>Çështja A4 - Mangësi në llogaritetjen e bazës tatimore për tatimin në pronë dhe nivel i ulët i inspektimit të</p>	<p>Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronat e paluajtshme, neni 11 përcakton që personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se nëse e objektit</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se kalkulimi i zbritjeve nga baza tatimore e pronave me vendbanim parësor aplikohet saktë, dhe se veprimtaritë</p>	<p>Menaxhmenti do të ndërmer të gjitha hapat e veprimit lidhur me inspektimin e 20% të të gjitha pronave/objekt</p>	<p>pjesërisht i zbatuar</p>	

pronave të paluajtshme	shërben si vendbanim parësor dhe e deklararon këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Githashtu, nëni 15.2 përcakton që veprimtaritë inspektuese të kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunes dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat. Nga analiza e bazës së të dhënave të tatumit në pronë, kemi identifikuar 1,055 raste për të cilët nuk është llogaritur zbritja e bazës tatumore prej 15,000€, ndërsa në 42 raste kjo zbritje është bërë 2 herë, dhe në një rast tjetër zbritja është aplikuar 3 herë. Githashtu, komuna nuk ka arritë që të bëjë verifikimin e së paku	inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha pronave/objekteve brenda territorit të Komunes.	eve mbrenda territorit te komunes.		

	<p>20% të pronave/objekteve të përgjithshme. Nga 25,098 prona të përgjithshme, gjatë vitit 2023 ishin verifikuar vetëm 15.8% apo 3,966 prona</p>				
<p>14. Gëshitja A5 - Tejkalmimi i vlerës së planifikuar të kontratave me çmime të peshuara</p>	<p>Rregullorja për prokurimin publik, neni 54.15, sqaron se kurdo që AK nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategorie të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo taverani +/-30%. Duke pasur parasysh faktin se peshimi i kategorive duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që vlera e</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që të kontrata me peshim të mos aplikohet rritja prej 30% të vlerës së kontratës bazë. Gjatë realizimit të kontratës, të ruhet e njëjta përqindje apo raport i peshimit të kategorive/pozicioneve siç janë kontraktuar.</p>	<p>Menaxhmenti do i marrë të gjitha hapat e veprimit lidhur me të gjitha kontratat me peshim të mos aplikim të rritjes prej 30% të vlerës së kontratës bazë</p>	<p>pjesërisht i zbatuar</p>	

	<p>realizuar (shpenzuar) nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit. Për kontratën publike me çmim të poentuar për "Mirëmbajtja e Ndrëqimit Publik" në vlerë të parashikuar prej 120,000€, realizimi i pagesave kishte tejkaluar vlerën totale të parashikuar, duke arritur në 156,000€. Për më tepër, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuar të kategorisë dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Kategoria A e peshuar me 70% apo në total në vlerë 84,000 ishte realizuar 164% apo 137,410€.</p>				
--	--	--	--	--	--

realizuar (shpenzuar) nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit. Për kontratën publike me çmim të poentuar për "Mirëmbajtja e Ndrëqimit Publik" në vlerë të parashikuar prej 120,000€, realizimi i pagesave kishte tejkaluar vlerën totale të parashikuar, duke arritur në 156,000€. Për më tepër, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuar të kategorisë dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Kategoria A e peshuar me 70% apo në total në vlerë 84,000 ishte realizuar 164% apo 137,410€.

Kategoria A kishte çmime më të larta për njësi.

15.	<p>Çështja B9 - Dobësi në procesin e subvencionimit të fermerëve dhe OIQ-ve</p>	<p>Sipas thirrjes publike 09 nr.83-23 për aplikim nga fermerët për pagesa direkte (bletë, dele, eji), dhe thirrjes publike nr. 04922/23 për subvencionim të prodhimitarisë së qumështit, aplikuesit duhet të dorëzojnë vërtetimet për kryerjen e obligimeve komunale për tatinin në pronë dhe mbeturinat. Gjithashtu, me thirrjen publike caktohet periudha kohore e aplikimit prej 15 ditëve. Gjatë testimit të procedurave të subvencionimit janë identifikuar këto mangësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në dy (2) raste të subvencionimit të fermerëve në vlerë 4,751€, përfutjesit nuk i kishin plotësuar kriteret e kërkuar me thirrjen publike, pasi nuk kishin ofruar dëshmi se kanë paguar obligimet ndaj 	<p>Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që procesi i vlerësimit për subvencione të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrje publike për subvencione.</p>	<p>Menaxhmenti do i ndermerrte gjitha masat nevojshme që procesi i vlerësimit për subvencione të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrje publike për subvencione..</p>	I zbatuar	
-----	---	---	--	---	-----------	--

		<p>komunës për taksën në mbeturina dhe tatimin në pronë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në katër (4) raste të subvencionimit të projekteve në fushën e DKRSë në vlerë 18,000€, komisioni i vlerësimit të kërkesave nuk ka përdorur formularët standard të vlerësimit siç kërkohet me rregulloren bazë, dhe • Te projekti "Ndërtimë vetëdijen zgjohemi kundër drogave" në vlerë 2,500€, përveç mungesës së formularëve të vlerësimit dhe deklaratës për financimin e dyfishhtë, përfituesi i subvencionit kishite aplikuar dy ditë pas mbylljes së afatit për aplikim dhe komisioni kishite pranuar aplikacionin për subvencionim. 			
--	--	---	--	--	--

16.	Çështja B10 - Vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve	LMFPP, neni 39, përcakton që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për punët, mallra dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Gjatë auditimit kemi identifikuar se pesë (5) lëndë për investime kapitale në vlerë totale 230,689€, dhe gjashtë (6) lëndë për mallra dhe shërbime në vlerë totale 30,988€, nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave. Vonesat ishin nga 10 deri 120 ditë.	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave	Menaxhmenti do siguroj se çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për punët, mallra dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.	E pa zbatuar	
17.	Çështja B11 - Mangësi në menaxhimin e të dhënave për tatimpaguesit në ProTa	UA nr. 03/2021 për mbledhjen dhe regjistrimin e informative mbi bronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1, kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik.	Kryetari duhet të shtojë kontrollat e brendshme për të siguruar plotësimin dhe përditësimin e të dhënave për tatimpaguesit në sistemin ProTax.	Menaxhmenti do përpiqet që do i siguroj përditësimin e të dhënave për tatimpaguesit në sistemin ProTax.	Pjesërisht i zbatuar	

		<p>Ndërlidhur me këtë edhe MFPT, përkatesisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunitat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme me qëllim të shmangies së dyfishimeve apo parregullsive eventuale. Nga analizimi i bazës së tatimit në pronë kemi identifikuar se janë 2,246 tatimpagues të cilët në shënimet e bazës ProTax janë pa numër personal ose me numër personal gabim.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se procedurat e rekrutimit të punonjësve zhvillohen sipas kërkesave ligjore dhe kritereve të përcaktuara me</p>	<p>Menaxhmenti do të përkujdeset që vlersimi i punonjesve të bëhet sipas ligjeve dhe kritereve të</p>	<p>I zbatuar</p>	
18.	<p>Çështja A6 - Dobësi në procedurat e rekrutimit për nëpunësit publik</p>	<p>Ligji për zyrarët publik, neni 7, përcakton që pranimi në detyrë i zyrarëve publik bazohet në parimin e meritës, mundësi të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit,</p>				

		<p>mosdiskriminimit, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese. Me konkursin publik përcaktohen kushtet dhe kriteret e kualifikimit që duhet të plotësojë kandidati/ja. Nga auditimi i procedurave të rekrutimit të nëpunësve publik / mësimdhënësve, kemi identifikuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për pozitën e punës "Edukatore për parashkollor" testi me shkrim nuk ishte nënshkruar nga kandidatja fituese. Gjithashtu, përgjigjet e pyetjeve teorike në testin me shkrim të kandidatës, ishin të identike me përgjigjet në shabllonin e testit me shkrim që kishite përgatitur komisioni për pranim, dhe kjo le të kuptojë që përgjigjet 	konkursin publik. Të përmirësohen kontrollet e brendshme në organizimin e testit me shkrim, dhe se në kontratat me afat të caktuar të përcaktohet saktë afati kohor i angazhimit.	percaktuara me konkurs.		
--	--	---	---	-------------------------	--	--

19.	Gëshitja A7 - Faturimi i shpenzimeve të	<p>e testit me shkrim të jenë kopjuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për pozitën e punës "Mësimdhënëse për lëndën e tekstit" me konkurs ishte kërkuar që kandidati/ja të ketë kualifikimin Master i tekstit, Inxhinier i diplomuar i tekstit - drejtimi i konfeksionit, përderisa kandidati e punësuar kishte kualifikimin bachelor i arteve në dizajn të modës; dhe • Për pozitën e punës "Mësuese klase", me konkurs ishte përcaktuar që kohëzgjatja e kontratës të jetë me kohë të caktuar, derisa në kontratën e punës nuk është përcaktuar kohëzgjatja apo data se kur do të përfundojë afati i kontratës. 	Kryetari dëhet të sigurojë se procesimi i pagesave bëhet vetëm pasi të jetë	Menaxhmenti deklaroi se qmimet e verdhzes i	I zbatuar	
-----	---	--	---	---	-----------	--

<p>derivateve me çmim jo të saktë</p>	<p>006-111, për furnizim me karburante, lot 6-niveli lokal, kalkulimi i çmimit bëhet duke u bazuar në çmimin mesatar mujor të berzës, kursit valutor mesatar mujor të bankës qendrore evropiane, dhe elementeve tjera fikse dhe variabile. AQP ka qasje në berzë dhe bënë kalkulimin e çmimit në baza mujore, ky çmim i dërgohet kontraktuesit dhe të njëjtin çmim e publikon në web faqen e AQP-së. Në faturën për furnizim me derivate për ngrohje qendrore nuk është aplikuar çmimi i duhur. Për furnizimin e muajit dhjetor, është përdorur çmimi i berzhës së muajit nëntor, çmim ky më lartë se çmimi i muajit dhjetor, duke rezultuar me mbi-pagesë për 998€.</p>	<p>konstatuar se faturat përmbajnë çmimet e sakta ashtu siç janë kontraktuar.</p>	<p>siguron permes AQP-se dhe tash e tutje thekson se do të ndermerr të gjitha veprimet ne menyra qe faturimi te jet konform te kalkulimit te çmimit mesatar mujor te verdhzes.</p>		
---------------------------------------	--	---	--	--	--

20.	Gëshjtja B12 - Mos përcaktimi i qartë i specifikimeve teknike në marrëveshjen për shërbimet e pastrimit dhe sigurimit të objekteve komunale	Kryetari duhet të sigurojë që në Marrëveshje të përcaktohen saktë specifikimet teknike që kanë të bëjnë me lokacionet, hapësirat punuese, orarin ku do të kryhen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, si dhe numrin e punonjësve që do të angazhohen në ofrimin e atyre shërbimeve.	Menaxhmenti do hartoj planin lidhur me specifikimet teknike që kanë të bëjnë me lokacionet, hapësirat punuese, orarin ku do të kryhen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, si dhe numrin e punonjësve që do të angazhohen në ofrimin e atyre shërbimeve.	Menaxhmenti do bëj perpjekte se te gjitha specifikimet teknike që kanë të bëjnë me lokacionet, hapësirat punuese, orarin ku do të kryhen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, si dhe numrin e punonjësve	pjesërisht i zbatuar	
21.	Gëshjtja B13 - Parregullsi në monitorim dhe raportim nga OJQ-të përfituese të subvencioneve	Neni 23 i Rregullores nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, përcakton që për secilin kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Përfituesi raporton te zyrtari	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas	Menaxhmenti do siguroj dhe përcaktoj kriteret dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve,	Pjestrisht i zbatuar	

	<p>monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare. Për tre (3) projekte të subvencionuara në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në vlerë totale 10,500€, përfituesit kishin sjelle raporte financiare, por që raportet nuk ishin mbështetur me dëshmi (fatura, pagesa, kontrata etj), derisa për projektin në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në vlerë 13,500€, përfituesi nuk kishte dorëzuar fare raport financiar dhe narrativ.</p>	<p>kërkesës së rregullores përkatëse</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të duhura për forcimin e kontrollit</p>	<p>Drejtorja do aplikoj kriteret sipas nenit 25 të Rregullores</p>	<p>pjesërisht i zbatuar</p>	
<p>22.</p>	<p>Çështja B14 - Thirrjet publike për subvencionim të fermerëve jo në</p>	<p>Sipas nenit 25 të Rregullores se brendshme të komunës nr. 03/2020 për</p>				

<p>pajtim me kërkesat e Rregullores komunale për subvencionim</p>	<p>përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante për fermerë të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen të subvencioneve dhe granteve në tëmin e bujqësisë, për personat fizikë përfshijnë, duke mos u kufizuar janë: projektin ideor, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit ne pronë, deklaratë se nuk është përfitues i një granti të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë brenda vitit fiskal. Në thirrjen publike nr. 83.23 për subvencionimin e fermerëve në bujqësi (pagesa direkte për bletë, deleve, etj.) me vlerë të përkrahjes</p>	<p>të brendshme në mënyrë që kërkesat për dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme për subvencione.</p>	<p>se brendshme të komunës nr. 03/2020 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve dhe do zbatohet në përpikni kriteret e dhena</p>		
--	--	--	---	--	--

	55,944€, dhe në thirrjen publike nr. 04922/23 për subvencionimin e prodhimitarisë së qumështit në vlera e përkrahjes 73,534€, mungonin kërkesat e përcaktuara		Menaxhmenti do zbatoj kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe do hartoj planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.		Dhjetor 2024-Janar 20205
23.	B15 - Mos përgatitja e Planit vjetor për subvencionimin e OJQ-ve dhe Raportit vjetor për subvencionet e dhëna	Rregullorja 04/2017- mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës. Komuna nuk e ka hartuar planin vjetor për mbështetje financiare publike për OJQ-të, dhe as Raportin vjetor për subvencionet e dhëna.	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planit vjetor për subvencionim dhe i njëjti të dërgohet te zyra e qeverisjes së mirë në ZKM, si dhe përgatitjen dhe publikimin e raportit vjetor për përfutjesit e subvencioneve sipas kërkesës rregullative.	Menaxhmenti do zbatoj kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe do hartoj planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës	
24.	Çështja B16 - Vonesa në realizim të projekteve kapitale dhe mos	Ligji nr. 08/L-193 për ndarjet buxhetore, neni 4, përcakton se OB-të	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike të realizohen sipas afateve kohore	Menaxhmenti do merr të gjitha hapat e veprimtimit të duhur	I zbatuar Qdo tremujor të viteve fiskale.

<p>raportim tremujor i progresit fizik dhe financiar i projekteve në departamentin e buxhetit</p>	<p>përmes sistemit PIP duhet të raportojnë në MF / departamentin e buxhetit, nga mbyllja e secilit tremujor, për progresin fizik dhe financiar për projektet kapitale mbi 1,000,000€. Në secilën kontratë publike përcaktohet afati kohor i fillimit dhe përfundimit të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve. Ndërlidhur me këtë, neni 70.5, i Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, specifikon se pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari Kryesor Administrativ do ta emërojë MK përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikëqyrës të drejtëpërdrejtë të MK. Për më tepër, neni 70.10, përcakton që pas pranimit të njoftimit për emërimin si</p>	<p>dhe kushteve tjera kontraktuale. MK për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave, dhe në rastet kur ato janë të paarsyetuara, të aplikohen penalet. Githashtu, drejtorja e financave përmes sistemi PIP, në baza tremujore, të raportoj për progresin fizik dhe financiar në departamentin e buxhetit.</p>	<p>me raportimet në sistemin PIP, në qdo tremujor.</p>		
---	---	---	--	--	--

		<p>menaxher i kontratës (MK), i njëjti duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Nga testimet kemi identifikuar se nëntë (9) kontrata publike për punë nuk ishin realizuar sipas afatit kohor të përcaktuar me kontratë dhe as nuk ishin aplikuar penalet për vonesat, në këto raste:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrata për Ndërtimin e objektit të zyrave të administratës në QKMF në vlerë 174,933, duhej të përfundonin jo më vonë se 30.09.2023, deri në kohën e auditimit (mars 2024), punimet nuk kishin përfunduar. • Kontrata për Ndërtimin e rrugëve lokale në 7 fshatra lot 2 në vlerë 108,157€, e nënshkruar 			
--	--	--	--	--	--

		<p>më datë 24.10.2022, duhej të realizohej brenda 50 ditëve.</p> <p>Kontrata nuk ishte realizuar deri në fund të vitit 2023. • Kontrata për Ndërtimin e parqeve dhe hapësirave publike në fshatin Stanoc në vlerë 65,184€, është nënshkruar më datë 26.10.2022, dhe duhej të përfundonte brenda 35 ditëve. Punimet janë kryer me 7 muaj vonesë. • Kontrata për Sinjalizim ndriçues me monitor digital informues në katër hyrje të qytetit të Vushtrrisë në vlerë 49,498€, e nënshkruar me datë 06.10.2023, duhej të përfundonte brenda 30 ditëve kalendarike nga data e fillimit të implementimit.</p> <p>Kontrata nuk kishte përfunduar as deri në mars 2024. • Punimet për kontratën Renovimi</p>			
--	--	---	--	--	--

		<p>i palestres sportive "Jeton Terstena" në vlerë 114,900€, ish-in përfunduar me 7 muaj vonesë. • Kontrata për Sinjalizimin horizontal dhe vertikal në vlerë 69,821€, duhej të përfundonte brenda 40 ditëve kalendarike, derisa punimet janë realizuar me vonesë prej 190 ditëve. •</p> <p>Kontrata për Ndërtimin e rrethojave në SHFMU "Bajram Curri dhe në Qerdhën 2" në vlerë 28,611€, ishte realizuar me 35 ditë vonesë. •</p> <p>Kontrata për Renovimin e shkollave sipas lot 1 deri lot 4 në vlerë 59,873€, duhej të përfundonte deri në fillim të muajit gusht 2023. Punimet kishin përfunduar nga gjysma e muajit dhjetor, apo gati me 5 muaj vonesë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrata për Ndërtimin e rrethojave të fushave sportive dhe oborreve në shkollat në 			

						<p>vlerë 31,498€, ishte realizuar me 45 ditë vonesë, derisa pranimiti teknik i punimeve nga komisioni ishte bërë me 85 ditë vonesë. • Kontrata për Asfaltimin e rrugës Vesekovac-Sllakoc në vlerë 110,000€, e nënshkruar më datë 08.11.2022 dhe duhej të përfundonte brenda 60 ditëve, përderisa projekti kishte përfunduar në qershor 2023, • Kontrata për Ndërtimin e rrugës me kubëza betoni Rr. "Fehmi Tahir Istrefi", lot 1 deri 3 në vlerë 91,387€, e nënshkruar më datë 06.07.2023, duhej të përfundonte brenda 65 ditëve. Punimet nuk janë përfunduar brenda afatit për shkak të planifikimeve joadekuate dhe nevojës për aneks kontratë shtesë, • Kontrata për Rregullimin e oborrit të</p>
--	--	--	--	--	--	--

		<p>QKMF-së në vlerë 30,654€, e nënshkruar më 22.08.2022 duhej të përfundonte brenda 45 ditëve, situacioni i parë ishte përfunduar në prill 2023, derisa pagesa e dytë në fund të vitit 2023. • Për kontratën Projektimi i projekteve të infrastrukturës Lot 1 në vlerë indikative të kontratës 220,000€, vendimi për caktimin e MK dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit ishte marrë 42 ditë pas nënshkrimit, derisa Plani për Menaxhimin e Kontratës është përgatitur dhe nënshkruar nga MK 2 muaj pas datës së nënshkrimit të kontratës.</p>				
25.	Çështja A8 - Blerja e makinerisë së përdorur	Opinionimi i KRPP-së i datës 22.11.2022, shpjegon që prokurimi i mallrave të përdorura nuk rekomandohet, ngase specifikimet	Kryetari duhet të sigurojë që fondet publike për blerje të përdoren në mënyrën më ekonomike duke mundësuar që të	Menaxhmenti duke pasur parasysh statutin e pazgjedhur të njisis se	pjesërisht i zbatuar	

	<p>teknike që përcaktohen nga autoriteti kontraktues nuk garantojnë domosdoshmërisht se dy apo më shumë mallra që kanë të njëjtat specifitime teknike kanë edhe kapacitetet e njëjta në kushtet performancës dhe funksionalitetit. Kjo është për shkak të faktit të paparashikueshëm dhe të pa kontrollueshëm sepe një produkt mund të jetë në gjendje më të mirë se tjetri, apo thjesht njëri më pak i prishur se tjetri. Arsyet e tilla në të vërtetë mund të ndikojnë në cilësinë, performancën dhe funksionalitetin e mallrave dhe mund të bëjnë blerje krejtësisht jo efektive për autoritetin kontraktues. Pamundësia për të krahasuar dy tenderë identik do të përbëjë</p>	<p>merret vlera për para. Automjetet e dedikuara për njësinë e zjarrfikëse të jenë në përputhje me kërkesat e UA (MPB) nr. 08/02.19.</p>	<p>zjarrfikëse ne nivel vendi dhe nevojave emergjente per ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarve,duke pasur perbaz nivelin e buxhetit komunal per kit kategori është detyruar të zhvilloj aktivitetin e prokurimit per kit destinim</p>		
--	---	--	--	--	--

		<p>një shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të konkurrentëve.</p> <p>Sidoqoftë, prokurimi i mallrave të përdorura mbetet në përgjegjësi të autoritetit kontraktues. UA (MPB) nr. 08/20219 për përcaktimin e paisjeve mbrojtëse, teknike dhe mjeteve për zjarrfikje dhe shpëtim, me nenin 15, pika 1.2 përcakton që afati i përdorimit të automjeteve zjarrfikëse në gjendje të rregulltë teknike është deri në 15 vite nga viti i prodhimit. Komuna ka blerë një autocisternë zjarrfikëse të vjetër të vitit 1995 në vlerë 69,468€. Me dosjen e tenderit ishte përcaktuar që viti i prodhimit të mos jetë më i vjetër se 1993. Komuna duke blerë automjetet 28 vite të vjetër, nuk ka respektuar UA (MPB) nr. 08/2019, që lejon</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		përdorimin e automjeteve zjarrefikse të vjetra deri në 15 vite.				
26.	Çështja A9 - Paguesa e situacioneve të punimeve jo në pajtim me kushtet e veçanta të kontratës	Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK), neni 27.1, përcakton se për çdo pagesë të ndalet 10% e vlerës, dhe kjo shumë e mbajtur e parasë do të paguhet brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në neni 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar. Në gjashtë (6) pagesa për projekte kapitale në vlerë 161,359€, menaxherët e kontratave nuk kishin mbajtur 10% të vlerës nga çdo pagesë / situacion të punimeve, dhe as nuk kishin zëvendësuar mbajtjen e parasë me garancion bankar.	Kryetari duhet të sigurojë së menaxherët e kontratave zbatojnë në tërësi kushtet e veçanta të kontratës, dhe nga secila pagesë e situacioneve të aplikojnë mbajtjen e parasë në 10% të vlerës në rastet kur nuk ofrohet garanci bankare nga kontraktuesit.	Menaxhmenti deklaroi se konform LPPrë, qdo her do të mbaje parën në vlerën 10%, në rastet kur nuk afrohet garanci bankare nga kontraktuesit që në rastin të rasteve kontratat kanë garancion bankar të validitetit.	I zbatuar	
27.	Çështja B17 - Rritje e llogarive të arkëtueshme	Regulla Financiare 03/2010 për të hyrat,	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të	Menaxhmenti do të ndermarr hapat e	Pjesërisht i zbatuar	

		<p>rregullon kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.</p> <p>Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje, derisa në fund të vitit 2022 të arkëtueshmet ishin 5,796,928€, në fund të vitit 2023 ato ishin 6,460,793€, përkatësisht janë rritur për 667,166€ apo 11.5% në krahasim me vitin paraprak. Rritja më e theksuar është te taksat për mbeturina dhe taksat për leje ndërtimore. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.</p>	<p>menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes se veprimeve të nevojshme me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.</p>	<p>veprimi lidhur me ngritjen dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.</p> <p>Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje</p>		
28.	<p>Çështja B18 - Nivel jo i duhur i adresimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm, dhe mos plotësim i</p>	<p>Në planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve jepen afatet dhe veprimet që do të ndërmerren nga menaxhmenti për zbatimin e tyre.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë zbatimin në tërësi të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe që NJAB-në ta plotësojë</p>	<p>Menaxhmenti do i ndermerrte gjitha masat me qëllim te permbushjes se kriterit sipas Rregullojta</p>	Pjesrisht i zbatuar	

<p>NjAB-së me numrin e duhur të auditorëve të brendshëm</p>	<p>Rregullorja 01/2019 për themelimin e NjAB-së, neni 5.1.1, përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 7mil € duhet të ketë së paku tre auditorë të brendshëm. Në raportin vjetor të punës, NjAB ka vlerësuar se nga 21 rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit të brendshëm, vetëm 9 rekomandime janë adresuar plotësisht nga menaxhmenti. Githashtu, menaxhmenti nuk ka adresuar rekomandimin e vitit të kaluar që NjAB-në ta plotësojë me së paku tre (3) auditorë të brendshëm.</p>	<p>me numrin e mjaftueshëm të auditorëve</p>	<p>01/2019 për themelimin e NjAB-së, neni 5.1.1, përcakton</p>		
<p>29.</p>					

Hartimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve (PVZR) është përgatitur konform afatit të parapare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ky PVZR është trajtuar në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve është dërguar në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

- Me datën __/__/24, Raporti i Auditimit për Komunën e Vushtrisë për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2023,
- Po ashtu edhe Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit është prezentuar në seancën e __ Shtatorit 2024, pika __ e rendit të ditës të seancës të rregullit të Kuvendit të Komunës.
- Deri në fund të muajit shkurt 2025, do të diskutohet në Asambleen Komunale për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF-të të vitit 2023 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Përditësimi i të dhënave në Raportin Periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit është kryer nga z. Abit Abiti, Kryesues i Grupit Punues për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Vushtrri,

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës

Date __.__.2024







Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

09.Nr. 44/24

Datë:	09.09.2024
Për:	Kuvendin e Komunës
Përmes:	z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës 
Nga:	z. Ergin Sunguri drejtor në Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 
Tema:	Akt përcjellës

Përmes këtij akti ju përcjellim raportin për fushatën e korrje shirjeve në komunën e Vushtrrisë të cilat janë paraqitur në raportin e drejtorisë dërguar MBPZHR te datës 22.08.2024 me nr. protokolli 41606/2024.

Bazuar në raportin e përgatitur nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, shihet qartë se rendimentet gjatë këtij viti kane arritur një nivel të lartë të prodhimitarisë gjë që nuk ka ndodhur më herët. Këto rendimente të larta-rekorde, janë arritur sepse të reshurat e shiut, kanë qenë të mjaftueshme dhe të renditura në kohë të përshtatshme, kur gruri ka pasur nevojë për lagështirë.

Po ashtu vlen të ceket se edhe procesi i korrje-shirjeve ka filluar me kohë dhe se gjatë gjithë fushatës nuk janë paraqitur vështirësi në përfundim me sukses të fushatës së korrje-shirjeve.

Me respekt;

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
 KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRIN

Nr. / No: 41606 / 24
 - 1 -
 Data: / Datum: 22.08.2024

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

DATE/A	22.08.2024
REFERENC/Ë	09 Nr 42
PËR/ZA/TO:	MBPZHR
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Avdyl Feka
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korrje-shirje 2024



Komuna	Vushtrri
Data e fillimit te korrje-shirjeve	02.07.2024
Numri i autokombajnave	66
Sipërfaqet e korrura më grurë (ha)	3500
Sipërfaqet e korrura me elb (ha)	135
Rendimenti mesatar i grurit (kg/ha)	6000 kg/ha
Rendimenti mesatar i elbit (kg/ha)	3600 kg/ha
Çmimi I korrje -shirjeve	130 Euro
Vështersit gjate korrje -shirjeve	S'ka



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Informatë
lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
për gjashtmujojin e parë të vitit 2024

Shtator 2024

Këshilli komunal për siguri në bashkësi i themeluar me Udhëzimin Administrativ të MPB-së dhe MAPL-së është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve. Ky këshill ka për qëllim rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me sjelljet e dhunshme në komunitet, si dhe ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.

KKSB, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të tij, bashkëpunon me Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore, të cilat merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi, si dhe ndërtimin e besimit për jetë të qetë e të sigurt të të gjitha komuniteteve në meset ku ata jetojnë.

Në vitin 2024, në gjashtmuorin e parë janë mbajtur gjithsej 2 mbledhje, mbledhja e tretë nuk është mbajtur për shkak të mungesës së kuorumit, andaj nuk kemi mundur ti permbahemi Udhëzimit Administrativ. Nuk ka pasur kuorum si pasojë e mospagesës së mëditjeve të anëtarëve të KKSB-së. Mbledhjet në këtë këshill janë mbajtur në gjuhët zyrtare në komunë, duke qenë se përbërja e tij është shumë etnike. Mbledhjet e KKSB-së kanë qenë të hapura, ato i kanë përcjell përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, etj. Në këto mbledhje pjesëmarrja e anëtarëve të KKSB-së ka qenë e kënaqshme, dhe secili nga anëtarët e këshillit kanë diskutuar për çështjet dhe problemet për të cilat ka përfaqësuar në këtë këshill, si dhe ka dhënë kontributin në zgjidhjen e problemeve të caktuara. gjithashtu kemi pasur pothuajse çdoherë prezent organizatat ndërkombëtare KFOR-in, OSBE-në, UNMIK etj.

Në këto mbledhje janë shqyrtuar problemet e ndryshme që i preokupojnë qytetarët e Vushtrrisë dhe masat që duhen të merren për parandalimin dhe evitimin e tyre.

Vlen të theksohet se në aspektin e sigurisë - janë shtuar masat e sigurisë në trafik në periudha të caktuara kohore gjatë kohës kurë fëmijët shkonin në shkolle ku duhet ta kalojnë rrugën dhe gjatë sezonit veror kurë ka ekzistuar fluksi i madh i bashkatdhetarëve

Gjithashtu ka bere kontrollimin e armëmbajtjeve, ku si rezultat i këtij kontrolli janë konfiskuar një numër i armëve. Policia është angazhuar në parandalimin e gjuajtjeve me armë zjarri në ahengje të ndryshme, por fatmirësisht numri i tyre është në zvogëlim e sipër, pasi që njerëzit po vetëdijesohen.

Sipas raporteve të policisë numri më i madh i veprave penale është kundër pasurisë, pra vjedhjet dhe vjedhjet e rënda por me angazhimin e shtuar të Policisë, ky numër është dukshëm më i vogël se vitin e kaluar, por në këtë vit është rritur numri i veprave penale të narkotikëve.

Anëtarët e KKSB-së nga radhët e komunitetit serb, turk, rom, dhe ashkali, kanë raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë brenda komuniteteve të cilat i kanë përfaqësuar, kanë prezentuar problemet dhe kërkesat e tyre para anëtarëve të këshillit, me të cilat është njoftuar këshilli, me ç'rast janë nxjerr rekomandime për zgjidhjen e problemeve.

Komandanti i Stacionit Policor, përveç raportimit të rregullt për gjendjen e sigurisë, njëkohësisht ka raportuar për bashkëpunimin e mirë me KFOR-in, me përfaqësues të komuniteteve gjatë punës në terren, ku janë njoftuar më për së afërmi për raportet ndëretnike në vendbanimet multi etnike.

Përveç KKSB-së, edhe Këshillat lokale për siguri në bashkësi si KLSP që përfshin fshatrat: Gojbulë dhe fshatrat Karaçë, Begaj, Sllatinë, Banjskë, Tërllabuq dhe Bashkësia lokale "Kalaja" në Vushtrri si dhe KLSP – Prelluzhë, ku përfshihen fshatrat (Gllavatin, Bivolak, Beçuk, Stroc, Zhilivodë, kanë funksionuar në mënyrë të rregullt. Kurse në qershor të këtij viti është formuar edhe KLSP që përfshin qytetin e Vushtrrisë.

Këto këshilla lokale, kanë mbajtur takime në të cilat janë shqyrtuar çështje me rëndësi dhe interes për komunitetin, si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës- Vushtri

Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues: kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, 

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, si dhe nenin 41 paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT LIDHUR ME FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIM TË PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit të komunës me nr. protokollit 63/24 i datës 28.03.2024 lidhur me formimin e Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ashtu që z. Kushtrim Hyseni, duhet të zëvendësohet me një tjetër anëtar të kuvendit pasi që i njëjti ka dhënë dorëheqje nga ky komision.
2. Pjesët tjera të vendimet me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 mbeten të pa ndryshuara.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtari i Komisionit Vlerësues.
4. Ky vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij vendimi, bëhet si rezultat sepse z.Kushtrim Hyseni anëtarë i kuvendit nga radhët e PDK-së, ka dhënë dorëheqje nga Komisioni për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme, sepse i njëjti është edhe anëtar i Komisionit për shqyrtim të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, dhe kjo gjë bie në konflikt interesi. Me qellim të respektimit të kuadrit ligjor, dhe shmangien e konfliktit të interesit, i propozojmë kuvendit që aprovoj këtë propozim-vendim duke e zëvendësuar këtë anëtar të këtij komisioni.

Compose

Find messages, documents, photos or people Advanced


Back
 Archive
 Move
 Delete
 Spam


- Inbox** 1
- Unread
- Starred
- Drafts
- Sent
- Archive
- Spam
- Trash
- < Less
- Views Hide
- Photos
- Documents
- Emails to myself
- Subscriptions
- Receipts
- Credits
- Travel
- Folders Hide
- + New Folder
- untitled

Dorëheqje nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronave në shfrytëzim afatshkurtër

Kushtrim Hyseni

Kushtrim Hyseni@yahoo.com
- Add to contacts



 **kushtrim hyseni**
From: kushtrimhyseni@yahoo.com
To: Melihate Basholli Latifi
Cc: Kuvendi Komunal

Përsëherdëftje,

Meqenëse jam anëtar në komisionin për ankesa për dhënien e pronave në shfrytëzim dhe njëkohësisht jam anëtar në komisionin vlerësues për dhënien e pronave në shfrytëzim afatshkurtër, jap dorëheqjen time nga komisioni vlerësues pasi është identifikuar shkelje ligjore


Falënderoj për mundësinë për të kontribuar!

Me respekt,
Kushtrim Hyseni

Sent from Yahoo Mail for iPhone

Wed, Jun 19 at 2:34 PM

Reply, Reply All or Forward



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, si dhe nenin 41 paragrafi 2 pika “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIM TË PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, në këtë përbërje:

- 1.1.Kushtrim Hyseni, anëtar i Kuvendit;
- 1.2.Shkelzen Xhaferi, anëtar i Kuvendit;
- 1.3.Remzi Ahmeti, nga ekzekutivi i komunës;
- 1.4.Benjamin Shala, nga ekzekutivi i komunës;
- 1.5.Isak Hyseni, nga shoqëria civile.

2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për pronën/at e përfshira në vetëm një vendim paraprak të kuvendit të komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

4.1 Komisionit Vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për pronën e paluajtshme të komunës e cila jepet në shfrytëzim që nënkupton:

4.1.1 Njoftimin publik i cili zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit,

4.1.2 Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, në vendin ku gjendet prona e komunës e cila jepet në shfrytëzim dhe së paku në njërën nga mediat e shkruara dhe elektronike.

4.1.3 Njoftimi duhet të përmbaj të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e pronës, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit,

arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave.

4.2 Pas pranimit të ofertave Komisioni Vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.

4.3 Komisioni Vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, ndërsa brenda 15 ditësh për rastet e dhënies në shfrytëzim afatgjatë.

4.4 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës si dhe të njëjtin ju dërgon palëve të përfshira në proces.

4.5 Komisioni Vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon te kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin, për rastet me periudhë shfrytëzimi afatshkurtër. Për rastet me periudhë të shfrytëzimit afatgjatë ofertën e përzgjedhur e procedon në kuvendin e komunës për aprovim.

4.6 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

4.7 Komisioni, për punën e tij mbanë procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit Vlerësues.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	06.09.2024
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendit Komunal Vushtrri
NGA/OD/FROM:	Qemajl Hasani -Udhëheqës I Sektorit të Tatimit në Pronë
PËRMES	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë

I / E nderuar,

Lidhur me pikat që janë planifikuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për muajin shtator 2024, e një ndër pikat e rendit të ditës e planifikuar për drejtorinë për Buxhet e Financa- Zyrën e Tatimit në Pronë, është edhe Propozim – Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2025.

Ju njoftojmë se për shkak se Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë është në procesin e vlerësimit të përgjithshëm për **pronat bujqësore, pyjore dhe industriale** dhe një përfundim i këtyre vlerësime nuk është bërë akoma, andaj kjo pikë të rendit të ditës duhet ta shtyhet për një nga seancat tjera pasi ta kemi këtë vlerësim nga Ministria e Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë.

Me respekt,